

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PËRMBARIMIN

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë, 2018

ISBN: 978-9928-01-095-7

Adresa:

Rruga “Nikolla Jorga”

Tel/fax: +355 42 427005, 04 2427006

E-mail: info@qbz.gov.al,

Web: www.botimezyrtare.gov.al

PËRMBAJTJA

Faqe

PJESA E PARË SHËRBIMI PËRMBARIMI SHTETËROR

Ligj nr. 8730 datë 18.1.2001	Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor <i>- Ndryshuar me ligjin nr. 108/2016, datë 27.10.2016</i>	5
Vendim i KM nr. 563, datë 14.7.2010	Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të hollësishme të bashkëpunimit të shërbimit përmbarimor me Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, si dhe pagesën përkatëse për shërbimin e përmbarimit <i>- Ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 626, datë 7.9.2011</i>	13
Vendim i KM nr. 443, datë 16.6.2011	Për përcaktimin e mënyrës së funksionimit, të administrimit dhe të ndërveprimit të sistemit të menaxhimit elektronik të çështjeve të përmbarimit gjyqësor (ALBIS), si regjistri qendror i kërkesave për vënie në ekzekutim të urdhrave të ekzekutimit <i>- Ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 416, datë 4.7.2018</i>	15
Udhëzim i MD, MB nr.3880/3, datë 3.6.2011	Për procedurat e bashkëpunimit të Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror me Policinë e Shtetit	23
Udhëzim i KM nr. 5, datë 12.12.2012	Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për zhvillimin e ankandit nga përmbaruesi gjyqësor	24
Udhëzim i KM nr. 1, datë 4.6.2014	Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit	29
Udhëzim i MD, MF nr. 33, datë 29.12.2014	Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, prokurorisë dhe noterisë	30
Udhëzim i MD dhe MF nr. 1276/5, datë 27.7.2017	Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror <i>- Ndryshuar me udhëzimin nr. 32, datë 30.8.2018</i>	33
Udhëzim i MD dhe i MF nr. 1276/6, datë 27.7.2017	Për përcaktimin e nivelit minimal dhe maksimal të zbatimit të vlerës së tarifës së suksesit për veprimet përmbarimore të ofruara nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror <i>- Ndryshuar me udhëzimin nr. 33, datë 30.8.2018</i>	38

Urdhër i MD nr. 367, datë 6.9.2013	Për përcaktimin e rregullave mbi veprimet e kancelarit në rastin e konfirmimit apo arkivimit të urdhrat të ekzekutimit	41
---------------------------------------	--	----

PJESA E DYTË
**SHËRBIMI PËRMBARIMOR GJYQËSOR
PRIVAT**

Ligj nr. 10 031 datë 11.12.2008	Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat <i>Ndryshuar me ligjet:</i> - nr. 10137, datë 11.5.2009; - nr. 36/2012, datë 29.3.2012; - nr. 80/2013, datë 14.2.2013; - nr. 109/2016, datë 27.10.2016.	43
Udhëzim i MD nr.4846/33, datë 3.11.2010	Për procedurën dhe afatet e dorëzimit të dokumentacionit pas çregjistrimit të përmbaruesit gjyqësor privat	55
Udhëzim i MD, MF nr. 1665/1, datë 5.3.2014	Për caktimin e tarifave përmbarimore për shërbimet e ofruara nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Privat	56
Udhëzim i MD, MB nr. 289, datë 19.5.2017	Për procedurat e bashkëpunimit të përmbaruesve gjyqësorë privatë me Policinë e Shtetit	62
Udhëzim i MD, MF nr. 385/6, datë 26.6.2017	Për përcaktimin e nivelit minimal dhe maksimal të zbatimit të vlerës së tarifës së suksesit për veprimet përmbarimore të ofruara nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Privat - <i>Ndryshuar me udhëzimin nr. 31, datë 30.8.2018</i>	66
Udhëzim i MD, MF nr. 385/7, datë 28.6.2017	Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Privat - <i>Ndryshuar me udhëzimin nr. 30, datë 30.8.2018</i>	68
Urdhër i MD nr. 6915, datë 17.10.2016	Për formën, përmbajtjen dhe rregullat e pajisjes e administrimit të vulave të përmbaruesve gjyqësorë privatë	73
Urdhër i MD nr. 4321/4, datë 18.7.2017	Për miratimin e modelit të kontratës që lidhet midis shoqërisë përmbarimore/përmbaruesit gjyqësor privat dhe palës së interesuar përpara fillimit të procedurave të ekzekutimit	75

PJESA E PARË
SHËRBIMI PËRMBARIMOR GJYQËSOR SHTETËROR

LIGJ
Nr. 8730, datë 18.1.2001

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT TË PËRMBARIMIT
GJYQËSOR¹

(Ndryshuar me ligjin nr. 108/2016, datë 27.10.2016)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton:

- a) rregullat e organizimit dhe të funksionimit të Shërbimit të Përmbaarimit Gjyqësor;
- b) kriteret që duhet të përmbushin shtetasit që të emërohen përmbaarues gjyqësorë;
- c) statusin dhe procedimin disiplinor të përmbaaruesit gjyqësor;
- ç) marrëdhëniet me institucionet shtetërore dhe me subjektet e tjera publike dhe private.

Neni 2

Objekti i veprimtarisë

1. Shërbimi i Përmbaarimit Gjyqësor ka për mision ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, në rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile.
2. Shërbimi i Përmbaarimit Gjyqësor i ushtron funksionet nëpërmjet përmbaaruesve gjyqësorë.

Neni 3

Organizimi

Shërbimi i Përmbaarimit Gjyqësor ka organizim unik dhe të centralizuar, me shtrirje në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Parimet e veprimtarisë

Ligjshmëria dhe objektiviteti, si dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me ligj subjekteve që marrin pjesë në ekzekutim, janë parimet bazë të punës së Shërbimit të Përmbaarimit Gjyqësor.

Neni 5

Përmbaaruesi gjyqësor

1. Përmbaaruesi gjyqësor është personi i ngarkuar me ligj për kryerjen e veprimtarisë së vënies në ekzekutim të titujve ekzekutivë, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

¹ Ligji nr.8730, datë 18.1.2001 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 1, datë 5 shkurt 2001.

Ligji nr. 108/2016, datë 27.10.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 229, datë 24 nëntor 2016.

2. Në ushtrimin e veprimtarisë së tij përmbaruesi gjyqësor duhet të karakterizohet nga ndershmëria, paanësia dhe profesionalizmi.

3. Përmbaruesi gjyqësor në ushtrimin e veprimtarisë së tij përfaqëson autoritetin shtetëror.

KREU II

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I SHËRBIMIT TË PËRMBARIMIT GJYQËSOR

Neni 6

Nivelet e organizimit

Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor varet nga ministri i Drejtësisë dhe organizohet në nivel qendror dhe vendor, si vijon:

- a) Drejtoria e Përgjithshme përbën nivelin qendror të organizimit.
- b) Zyrat përmbarimore, brenda juridiksionit të çdo rrethi gjyqësor të shkallës së parë, përbëjnë nivelin vendor të organizimit dhe varen administrativisht nga Drejtoria e Përgjithshme.

Neni 7

Drejtori i Përgjithshëm

1. Drejtori i përgjithshëm përgjigjet për drejtimin, bashkërendimin dhe kontrollin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor.

2. Drejtori i përgjithshëm emërohet dhe shkarkohet nga Kryeministri, me propozimin e ministrit të Drejtësisë.

Neni 8

Përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm

Drejtori i përgjithshëm ka këto përgjegjësi:

- a) Drejton dhe kontrollon veprimtarinë e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor.
- b) Siguron zbatimin e njëjtë të akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe të praktikave në fushën e veprimtarisë procedurale të ekzekutimit.
- c) Përgatit dhe nxjerr urdhra, udhëzime të brendshme dhe metodika për trajtimin në përgjithësi të çështjeve në ekzekutim.
- ç) I propozon ministrit të Drejtësisë emërimin dhe shkarkimin e kryetarëve të zyrave përmbarimore.
- d) Kontrollon dokumentimin e veprimtarisë përmbarimore.
- dh) Organizon dhe ndjek edukimin profesional dhe trajnimin e përmbaruesve gjyqësorë.
- e) Ndjek zbatimin e etikës profesionale gjatë veprimtarisë përmbarimore.
- ë) Përfaqëson Shërbimin e Përmbarimit Gjyqësor në marrëdhënie me të tretët.
- f) Ushtron përgjegjësi të tjera të përcaktuara me ligj.

Neni 9

Organizimi i zyrave përmbarimore

1. Zyrat përmbarimore pranë çdo rrethi gjyqësor përbëhen nga:

- a) kryetari i zyrës;
- b) përmbaruesit gjyqësorë;
- c) personeli administrativ dhe teknik.

2. Çdo zyrë përmbarimore është person juridik dhe ka vulën e vet.

Neni 10

Organika

1. Numri i përgjithshëm i përmbaruesve gjyqësorë të Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor caktohet nga kryeministri, me propozimin e ministrit të Drejtësisë.

2. Struktura e Drejtorisë së Përgjithshme dhe e zyrave përmbartimore, organikat e tyre, si dhe rregullat e hollësishme për funksionimin e Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor përcaktohen nga ministri i Drejtësisë, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm.

Neni 11

Burimet financiare

1. Për realizimin e detyrave, Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor ka buxhetin e vet, si pjesë të veçantë brenda buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë.

2. Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor ka të drejtë të përdorë të ardhura të tjera që lejohen me ligj.

Neni 12

Sigurimi i të ardhurave nga veprimtaria përmbartimore

(shfuqizuar pika 2 me ligjin nr. 108/2016, datë 27.10.2016)

1. Çdo veprim përmbartimor kryhet vetëm kundrejt pagimit të tarifave përkatëse.

2. Shfuqizuar.

3. Ndarja e të ardhurave, kriteret e procedurat e administrimit dhe të shpërndarjes së të ardhurave përcaktohen me urdhër të përbashkët të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave.

Neni 12/a

Tarifat fikse të veprimeve përmbartimore

(shtuar me ligjin nr. 108/2016, datë 27.10.2016)

Për fillimin e procedurave të ekzekutimit dhe kryerjen e veprimeve procedurale nga Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile, paguhet tarifa fikse. Masa e tarifës fikse caktohet duke mbajtur në konsideratë vlerën dhe llojin e detyrimit, si dhe kompleksitetin e veprimit procedural përmbartimor.

Masa e tarifës fikse të veprimit përmbartimor, llojet e veprimeve përmbartimore të tarifuara dhe rastet e përjashtimit nga parapagimi i tarifës për kategori të caktuara përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave, pasi merret dhe mendimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit.

Neni 12/b

Tarifa e suksesit

(shtuar me ligjin nr. 108/2016, datë 27.10.2016)

Përmbartuesi gjyqësor shtetëror përfiton një tarifë suksesi, e cila mund të jetë në formën e një shume të caktuar, një përqindjeje të caktuar mbi vlerën e detyrimit të vjelë ose titullit të ekzekutuar, ose nëpërmjet kombinimit të të dyjave mbi vlerën e detyrimit të ekzekutuar. Masa e tarifës së suksesit caktohet në marrëveshjen mes kreditorit dhe përmbartuesit gjyqësor, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj.

Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave përcaktojnë me udhëzim të përbashkët nivelin minimal dhe maksimal të zbatimit të vlerës së tarifës së suksesit për veprimet përmbartimore. Tarifa e suksesit nuk parapaguhet dhe nuk i ngarkohet debitorit.

Marrëveshja tip për mbledhjen e tarifës së suksesit nga Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror miratohet me urdhër nga Ministri i Drejtësisë.

KREU III

KËSHILLI I PËRMBARTIMIT

Neni 13

Përbërja

1. Këshilli i Përmbartimit përbëhet nga sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, drejtori i përgjithshëm i Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor, drejtori i Drejtësisë së Personelit, Organizimit dhe

Shërbimeve në Ministri, kryetari i Zyrës Përmbartimore të Tiranës dhe një këshilltar i ministrit të Drejtësisë.

2. Rregullat për funksionimin e Këshillit të Përmbartimit dhe procedurat që ndjek ai përcaktohen nga ministri i Drejtësisë, pasi të ketë marrë mendimin e këtij Këshilli.

Neni 14

Përgjegjësitë e Këshillit të Përmbartimit

1. Këshilli i Përmbartimit zhvillon konkurs për emërimin e përmbartuesve gjyqësorë dhe shqyrton shkeljet disiplinore të kryera prej tyre.

2. Këshilli i Përmbartimit bën çdo vit vlerësimin e aftësive profesionale të përmbartuesve gjyqësorë, bazuar në kriteret e cilësisë, të vëllimit të punës, të shpejtësisë dhe të figurës së tyre morale, si më poshtë:

- a) shumë mirë,
- b) mirë,
- c) pranueshëm,
- ç) i paaftë.

Sistemi i vlerësimit të punës së përmbartuesve gjyqësorë përcaktohet nga ministri i Drejtësisë, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor, pasi të jetë marrë mendimi i Këshillit të Përmbartimit.

3. Këshilli i Përmbartimit ka funksion këshillimor dhe ia paraqet, në çdo rast, mendimin e vet ministrit të Drejtësisë, i cili duhet të shprehet brenda 30 ditëve nga kjo paraqitje.

KREU IV

STATUSI I PËRMBARTUESIT GJYQËSOR

Neni 15

Emërimi i përmbartuesit gjyqësor

1. Emërohet përmbartues gjyqësor shtetasi shqiptar që plotëson këto kushte:

- a) Ka zotësi të plotë për të vepruar.
- b) Ka kryer arsimin e lartë juridik.
- c) Gëzon figurë të pastër morale.
- ç) Nuk është i dënuar për kryerjen e një veprë penale me vendim gjyqësor të formës së prerë.

d) Nuk është larguar nga administrata publike për shkelje disiplinore brenda një afati prej 3 vjetësh nga data e depozitimit të kërkesës; kur shkelja disiplinore është kryer gjatë ushtrimit të funksionit si gjyqtar, prokuror, oficer i policisë gjyqësore, noter ose avokat, afati është 5 vjet.

2. Pranimi në Shërbimin e Përmbartimit Gjyqësor bëhet me konkurs. Këshilli i Përmbartimit ndjek procedurat e paraqitjes, të përzgjedhjes dhe të vlerësimit të kandidaturave dhe mendimin e vet ia paraqet ministrit të Drejtësisë brenda 15 ditëve.

3. Konkurruesi fitues emërohet përkohësisht përmbartues gjyqësor nga ministri i Drejtësisë, për një periudhë prove 3-mujore.

Neni 16

Periudha e provës

1. Gjatë periudhës së provës, përmbartuesi gjyqësor është nën kujdesin e një përmbartuesi të vjetër në detyrë dhe vlerësohet nga eprori i tij. Veprimtaritë e trajnimit janë të detyrueshme për përmbartuesin gjyqësor në periudhën e provës.

2. Në fund të periudhës së provës, ministri i Drejtësisë, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm, vendos:

- a) emërimin përfundimtar si përmbartues gjyqësor;
- b) largimin nga Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor.

3. Në rastin e pikës 2 shkronja “b” të këtij neni, personi përkatës gëzon të drejtat e përmbauesit gjyqësor vetëm për periudhën e kohës së provës.

Neni 17

Papajtueshmëritë

1. Përmbauesi gjyqësor nuk mund të ushtrojë asnjë detyrë ose veprimtari tjetër publike, me përjashtim të atyre edukative e të mësimdhënies.

2. Ai nuk duhet të jetë në marrëdhënie pune ose të kryejë veprimtari të tjera, të cilat paraqesin konflikt interesash me detyrën që ka ose pengojnë përmbushjen e saj.

3. Përmbauesi gjyqësor nuk duhet të jetë anëtar i organeve qendrore ose ekzekutive të partive politike.

Neni 18

Përjashtimi i përmbauesit gjyqësor

1. Përmbauesi gjyqësor është i detyruar të heqë dorë nga ekzekutimi i çështjes kur:

a) ka interes në çështje ose në një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me atë në ekzekutim;

b) ai vetë ose bashkëshortja është i afërt deri në shkallë të katërt, ose ka krushqi, deri në shkallë të dytë, ose është i lidhur me detyrime birësimi ose bashkëjeton, në mënyrë të përhershme me njërin nga palët ose nga mbrojtësit;

c) ai vetë ose bashkëshortja është në konflikt gjyqësor ose në armiqësi, ose në marrëdhënie kredie ose huaje me njërin prej palëve, ose me njërin prej përfaqësuesve;

ç) është kujdestar, punëdhënës i njërit prej palëve, administrator ose ka një detyrë tjetër në një ent, shoqatë, shoqëri ose institucion tjetër, që kanë interesa për çështjen në ekzekutim;

d) vërtetohen, në çdo rast tjetër, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie.

2. Kërkesa për heqjen dorë i paraqitet për vendim kryetarit të zyrës përkatëse përmbaimore. Në rastin e heqjes dorë nga kryetari i zyrës përmbaimore, kërkesa i paraqitet për vendim drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit të Përmbaimit Gjyqësor. Përmbajtja e kërkesës u njoftohet palëve.

Neni 19

Heqja dorë e përmbauesit gjyqësor

1. Përmbauesi gjyqësor, i cili vlerëson me ndërgjegje se ka arsye për të mos marrë pjesë në ekzekutimin e një çështjeje, i kërkon të zëvendësohet kryetarit të zyrës përmbaimore. Kryetari i zyrës përmbaimore, kur e sheh me vend kërkesën, urdhëron zëvendësimin e tij me një tjetër përmbaues gjyqësor të asaj zyre.

2. Për kryetarin e zyrës përmbaimore zëvendësimi urdhërohet nga drejtori i përgjithshëm.

Neni 20

Të drejtat

Përmbauesit gjyqësorë gëzojnë edhe këto të drejta:

a) Marrin pjesë në sindikata ose shoqata profesionale.

b) Përfitojnë trajtim shëndetësor dhe sigurime shoqërore për vete dhe për pjesëtarët e familjes që kanë në ngarkim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

c) U paguhen shpenzimet për udhëtime pune, sipas kriterëve dhe masës së parashikuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

ç) Trajtohen nga shteti për ngritjen e nivelit të tyre profesional.

Neni 21

Detyrat

Përmbauesit gjyqësorë janë të detyruar:

a) të njohin, të respektojnë dhe të zbatojnë Kushtetutën, Kodin e Procedurës Civile, Kodin Civil dhe akte të tjera ligjore e nënligjore, që lidhen me veprimtarinë përmbaimore, si dhe

urdhrat, udhëzimet dhe metodikat e drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor;

b) të përsosin aftësitë profesionale dhe të marrin pjesë në veprimtaritë trajnuese të organizuara për këtë qëllim.

Neni 22

Paga dhe shpërblimet

1. Paga e përmbarruesit gjyqësor përbëhet nga paga bazë, shtesa mbi pagë dhe shpërblimi i posaçëm.

2. Pagat e punonjësve të përmbarrimit gjyqësor përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Përmbarruesi gjyqësor, në varësi të rezultateve të punës, mund të përfitojë një shpërblim, i cili përballohet nga të ardhurat që realizohen, administrohen dhe shpërndahen sipas pikës 3 të nenit 12 të këtij ligji.

4. Përmbarruesi gjyqësor, në varësi të rezultateve në punë, mund të përfitojë një shpërblim, i cili përballohet nga të ardhurat që i mbeten Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor, në përputhje me nenin 12 të këtij ligji. Shpërblimi i posaçëm caktohet, në çdo rast, me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

Neni 23

Koha e punës

1. Kohëzgjatja javore e punës dhe orari, si rregull, janë të njëjta me ato të administratës publike.

2. Për nevoja pune, me urdhër të eprorit të drejtpërdrejtë, përmbarruesi gjyqësor është i detyruar të punojë edhe jashtë orarit të punës, në ditët e pushimit javor, në ditët e festave ose edhe kur është me lejen vjetore.

3. Kriteret dhe masa e pagesës për punën jashtë kohëzgjatjes javore dhe orarit të zakonshëm caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 24

Lejet

1. Përmbarruesit gjyqësorë gëzojnë të drejtën e një lejeje vjetore të pagueshme prej 4 javësh kalendarike. Leja vjetore bëhet në muajt korrik-gusht. Në rastet kur përmbarruesi gjyqësor në periudhën korrik-gusht ngarkohet me kryerjen e detyrave të ngutshme ose kur ndërpret lejen për nevoja pune, përveç ditëve të pushimit të mbetura, përmbarruesi gjyqësor përfiton deri në 5 ditë pushimi shtesë.

2. Për nevoja të veçanta vetjake ose familjare, përmbarruesi gjyqësor ka të drejtë të përfitojë leje të papaguar deri në 20 ditë në muaj, por jo më tepër se 30 ditë në vit.

3. Në raste martesash ose vdekjesh brenda familjes, kur është konsumuar koha e parashikuar në pikën 2 të këtij neni, përmbarruesi gjyqësor ka të drejtë të përfitojë deri në 10 ditë leje.

Neni 25

Identifikimi

1. Përmbarruesi gjyqësor ka dokument identifikues, të cilin e paraqet në çdo rast të kryerjes së detyrës. Dokumenti përdoret vetëm gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të saj.

2. Përcaktimi i dokumentit identifikues bëhet me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

Neni 26

Mbledhja dhe administrimi i të dhënave

1. Përmbarruesi gjyqësor ka të drejtë dhe merr masa për mbledhjen, administrimin dhe ruajtjen e të dhënave që lidhen ngushtë me nevojat e ushtrimit të funksioneve e të detyrave të ngarkuara, duke respektuar garancitë kushtetuese dhe ligjore për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

2. Organet e administratës publike dhe të sistemit të drejtësisë, entet publike, si dhe personat fizikë e juridikë që kanë dokumente dhe të dhëna që lidhen me ekzekutimin, janë të detyruar t'i paraqesin kur u kërkohen nga përmbaruesit gjyqësorë.

3. Të dhënat e marra në përputhje me këtë nen grumbullohen, administrohen, ruhen dhe/ose asgjësohen, në përputhje me dispozitat përkatëse në fuqi.

Neni 27

Mbrojtja e veçantë e përmbaruesit gjyqësor

Kur përmbaruesit gjyqësor, gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të saj, i rrezikohet jeta, familja ose i dëmtohet prona, shteti i garanton mbrojtje të veçantë, kushtet dhe mënyrat e përfitimit të së cilës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 28

Komandimi

1. Për nevoja të punës, pranë një zyre përmbarimore, mund të caktohet një përmbarues gjyqësor i zyrës përmbarimore më të afërt me të për ekzekutimin e një numri titujsh ekzekutivë.

2. Përmbaruesit gjyqësor mund t'i kërkohet të lëvizë në një zyrë tjetër të afërt përmbarimore jo më shumë se 2 periudha në vit, deri në 3 muaj secila. Në fund të këtij afati, përmbaruesi gjyqësor kthehet përsëri në vendin e tij të mëparshëm.

3. Caktimi dhe lëvizja urdhërohen nga drejtori i përgjithshëm i Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor, pasi të ketë dëgjuar përmbaruesin gjyqësor.

Neni 29

Pezullimi dhe ruajtja e vendit të punës

1. Përmbaruesi gjyqësor mund të pezullohet nga detyra me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor, kur ndaj tij fillon ndjekje penale, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar.

2. Përmbaruesit gjyqësor i ruhet vendi i punës:

a) gjatë periudhës së thirrjes nën armë;

b) për periudha studimi, kur drejtori i përgjithshëm jep miratimin.

3. Përmbaruesi gjyqësor nuk paguhet gjatë periudhës së parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni. Në rastin e parashikuar në pikën 1, kur çështja penale pushohet ose kur me vendim gjykate të formës së prerë deklarohet i pafajshëm, përmbaruesit gjyqësor i jepet paga bazë që nga çasti i pezullimit.

4. Periudha e parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni mbahet parasysh për llogaritjen e vjetërsisë në shërbim.

Neni 30

Bashkëpunimi me organet e tjera

1. Përmbaruesi gjyqësor, për kryerjen e detyrave të ngarkuara, bashkëpunon me Policinë e Shtetit, me Policinë Ndërtimore dhe policitë e tjera, me organet e pushtetit vendor dhe prefekturat.

2. Organet shtetërore ose publike janë të detyruara të ndihmojnë përmbaruesin gjyqësor në ushtrimin e funksioneve, sipas ligjit, sa herë që kërkohet ndihma e tyre.

3. Policia e Shtetit dhe ajo Ndërtimore vë në dispozicion të përmbaruesit gjyqësor mjete dhe forca të mjaftueshme për ushtrimin e funksioneve të tij, sipas ligjit. Rregulla të hollësishme për përmbushjen e detyrave sipas kësaj pike caktohen me akte të përbashkëta të ministrit të Drejtësisë me titullarët e institucioneve përkatëse.

4. Kërkesa për dhënien e ndihmës pranë këtyre organeve bëhet nga kryetari i zyrës përmbarimore në rrethin gjyqësor dhe shpenzimet e kryera trajtohen sipas procedurave ligjore për ekzekutimin e detyrueshëm.

KREU V DISIPLINA DHE LARGIMI

Neni 31

Masat disiplinore

1. Përmbartuesi gjyqësor, që shkel rregullat e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore që lidhen me detyrën e tij ose nuk i zbaton ato, kur nuk ka vend për përgjegjësi penale, ndëshkohet me njërin nga këto masa disiplinore:

- a) Vërejtje me shkrim
- b) Vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra
- c) Shkarkim nga detyra.

2. Procedimi disiplinor fillon jo më vonë se 30 ditë nga çasti i vënies re të shkeljes dhe jo më vonë se 1 vit nga çasti i kryerjes së saj.

3. Nismën për fillimin e procedimit disiplinor e ndërmerret drejtori i përgjithshëm i Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor. Këshilli i Përmbartimit jep mendimin e tij brenda 15 ditëve nga fillimi i procedimit.

Neni 32

Dhënia e masës disiplinore dhe shlyerja e saj

1. Masat disiplinore jepen me urdhër të ministrit të Drejtësisë dhe shënohen në dosjen vetjake. Masat disiplinore jepen në mënyrë të shkallëzuar ose në bazë të rëndësisë së shkeljes dhe të pasojave. Për çdo shkelje jepet vetëm një masë disiplinore.

2. Përmbartuesi gjyqësor detyrohet të zhdëmtojë dëmin e shkaktuar, sipas dispozitave në fuqi.

3. Masat e mësipërme jepen sipas një procedure administrative që garanton të drejtën për të marrë të dhëna, për t'u dëgjuar, për t'u mbrojtur dhe për t'u ankuar. Vendimi për marrjen e masës disiplinore i komunikohet me shkrim të interesuarit.

4. Masat e përcaktuara në nenin 31, me përjashtim të shkronjës "c", mund të shlyhen nëse brenda një viti nga data e dhënies së tyre, ndaj përmbartuesit gjyqësor nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore. Masat disiplinore të shlyera hiqen nga dosja vetjake.

Neni 33

Ankimi

Kundër dhënies së masave disiplinore të parashikuara në pikën 1 të nenit 31 mund të bëhet ankim në gjykatë, sipas rregullave të parashikuara në nenin 328 të Kodit të Procedurës Civile.

Neni 34

Largimi

1. Përmbartuesi gjyqësor largohet nga detyra në këto raste:

kur mbush moshën për pension;

b) kur bëhet i paafte nga ana shëndetësore për një periudhë kohe mbi një vit;

c) kur humbet zotësinë për të vepruar;

ç) kur kërkon ai vetë;

d) kur shkurtohet funksioni organik;

dh) kur është pranuar në kundërshtim me kriteret e vendosura në këtë ligj.

2. Largimi i përmbartuesit gjyqësor bëhet nga ministri i Drejtësisë.

Neni 35

Shkarkimi

1. Përmbartuesi gjyqësor shkarkohet nga detyra në këto raste:

kur dënohet për kryerjen e një vepre penale;

kur kryen shkelje të rënda të disiplinës në punë;

c) kur kryen në mënyrë të përsëritur thyerje të disiplinës dhe nuk i është hequr masa e dhënë më parë;

ç) kur provohet se ka përdorur funksionin e tij në shërbim të interesave vetjake ose të personave me të cilët ka lidhje familjare;

d) kur provohet se me veprimet ose mosveprimet e tij ka krijuar favore të padrejta për persona të tjerë;

dh) kur nuk përmbush veprimet përmbarimore të parashikuara në ligj;

e) kur është vlerësuar “i paaftë” në përputhje me pikën 2 të nenit 14 të këtij ligji.

2. Shkarkimi i përmbaruesit gjyqësor bëhet nga ministri i Drejtësisë.

KREU VI

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 36

Riorganizimi i Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor

Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji duhet të përfundojë riorganizimi i Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor, në përputhje me rregullat e caktuara në këtë ligj.

Neni 37

Dispozitë kalimtare

Për përmbaruesin gjyqësor, që në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji është duke vazhduar studimet në fakultetin juridik, kriteret e vendosura në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 15 dhe në shkronjën “dh” të pikës 1 të nenit 34 të këtij ligji zbatohen pas mbarimit të periudhës kohore që përfshin vitet që i kanë mbetur për përfundimin e studimeve në fakultetin juridik, plus një vit. Deri në përfundim të kësaj periudhe ai është përmbarues gjyqësor në periudhë prove dhe për të zbatohen rregullat e nenit 16 të këtij ligji.

Neni 38

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.2877, datë 30.1.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

VENDIM

Nr.563, datë 14.7.2010

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE TË HOLLËSISHME TË BASHKËPUNIMIT TË SHËRBIMIT PËRMBARIMOR ME AGJENCINË E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA, SI DHE PAGESËN PËRKATËSE PËR SHËRBIMIN E PËRMBARIMIT²

(Ndrysbuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.626, datë 7.9.2011)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 14 pika 4 e 28 pika 4 të ligjit nr.10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” dhe të ligjit nr.8730, datë 18.1.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përmbarimit gjyqësor”, me propozimin e Ministrit të Financave dhe Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

² Vendimi nr.563, datë 14.7.2010 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.147, datë 6 nëntor 2010.

Vendimi nr.626, datë 7.9.2011 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.139, datë 12 tetor 2011.

VENDOSI:

KREU I

EKZEKUTIMI I VENDIMIT TË GJYKATËS PËR SEKUESTRIMIN E PASURIVE

1. Administratori, i caktuar në vendimin e gjykatës, i dorëzon kërkesën për ekzekutimin e vendimit përmbaruesit gjyqësor, ku ndodhet pasuria që sekuestron.
2. Vendimi i gjykatës për sekuestrimin e pasurive vihet në ekzekutim menjëherë, me paraqitjen e kërkesës, dhe duhet të ekzekutohet brenda 5 (pesë) ditëve.
3. Përmbaruesi gjyqësor detyrohet të bashkërendojë me administratorin veprimet procedurale që lidhen me vendin, datën dhe orën e ekzekutimit të vendimit, brenda afateve të parashikuara në pikën 2 të këtij kreu.
4. Njoftimi i vendimit të gjykatës për personin zotërues të pasurisë, mbi të cilën është marrë masa e sekuestrimit, është i vlefshëm edhe për procedurën e ekzekutimit.

KREU II

MARRJA NË DORËZIM E PASURISË SË SEKUESTRUAR

1. Inventarizimi dhe dorëzimi i pasurive të sekuestruara, nga përmbaruesi gjyqësor tek administratori, dokumentohet me procesverbal, sipas nenit 524 të Kodit të Procedurës Civile, i cili nënshkruhet nga të pranishmit.
2. Procesverbali hartohet nga përmbaruesi gjyqësor në atë kopje sa janë të pranishmit në çastin e inventarizimit dhe dorëzimit të pasurive të sekuestruara.
3. Dorëzimi i pasurisë së sekuestruar tek administratori i pasurisë shoqërohet me dokumentacionin përkatës ligjor, nëse ka përfshirë dhe librat e llogarisë për shoqëritë tregtare, të cilat përmbaruesi gjyqësor ia kërkon personit zotërues të pasurisë.
4. Për qëllime administrimi, në mungesë të dokumentacionit të lartpërmendur, Agjencia mbledh të dhëna në rrugë zyrtare dhe ia vë në dispozicion ekspertit kontabël, të caktuar prej saj, i cili ia paraqet raportin përkatës kësaj Agjencie.

KREU III

EKZEKUTIMI I VENDIMIT TË GJYKATËS PËR KONFISKIM TË PASURIVE

1. Administratori i pasurisë ia dorëzon kërkesën për ekzekutimin e vendimit të konfiskimit përmbaruesit gjyqësor, të caktuar në vendimin e gjykatës.
2. Për ekzekutimin e vendimit për konfiskimin e pasurive zbatohen rregullat parashikuara në pikat 2 dhe 3 të kreut I të këtij vendimi.
3. Përmbaruesi gjyqësor urdhëron institucionet përgjegjëse për kalimin e pasurisë në pronësi të shtetit dhe në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, menjëherë pas marrjes së njoftimit të vendimit të konfiskimit.
4. Pasuritë e konfiskuara regjistrohen në zyrën vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, sipas dispozitave të Kodit Civil.

KREU III/1

EKZEKUTIMI I AKTIT TË REVOKIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA/TË KONFISKUARA

1. Agjencia njofton përmbaruesin gjyqësor dhe, nëpërmjet tij, pronarin e pasurisë së sekuestruar/konfiskuar për aktin e revokimit të pasurisë së sekuestruar/konfiskuar.
2. Dorëzimi i pasurisë së revokuar te pronari i pasurisë bëhet sipas procedurave të Kodit të Procedurës Civile dhe shoqërohet me dokumentacionin përkatës, të cilin përmbaruesi gjyqësor e merr nga administratori i pasurisë.
3. Në rastin e mosmarrjes në dorëzim të pasurisë nga pronari i saj, me kalimin e afatit 30 - ditor nga data e marrjes së njoftimit të aktit të revokimit të pasurisë së sekuestruar/konfiskuar, agjencia i kërkon gjykatës, që ka vendosur revokimin e aktit, heqjen nga administrimi i saj të pasurisë së sekuestruar/konfiskuar.

KREU IV
PAGESAT PËR SHËRBIMIN PËRMBARIMOR

1. Pagesat e shërbimit përmbarimor për ekzekutimin e aktit të sekuestrimit/konfiskimit përcaktohen sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Agjencia përjashtohet nga pagesa paraprake e shërbimit për ekzekutimin e vendimit të sekuestrimit/konfiskimit.
3. Tarifat e përcaktuara në këtë vendim aplikohen dhe për pagesat e shërbimeve përmbarimore, të cilat nuk janë kryer nga agjencia deri në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

KREU V
DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe Shërbimi Përmbarimor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela 1

	Tarifa për veprime që kryhen nga përmbaruesi gjyqësor	Tarifa në lekë
1	Për vënien dhe ekzekutim të aktit të sekuestrimit të pasurive	5 000
2	Për lajmërimet dhe veprimet e tjera të përmbaruesit gjyqësor	500
3	Për lëshime nga përmbaruesi gjyqësor të çdo lloj akti ose dokumenti të kërkuar nga të interesuarit	500

VENDIM
Nr.443, datë 16.6.2011

PËR PËRCAKTIMIN E MËNYRËS SË FUNKSIONIMIT, TË ADMINISTRIMIT DHE TË NDËRVEPRIMIT TË SISTEMIT TË MENAXHIMIT ELEKTRONIK TË ÇËSHTJEVE TË PËRMBARIMIT GJYQËSOR (ALBIS), SI REGJISTRI QENDROR I KËRKESAVE PËR VËNIE NË EKZEKUTIM TË URDHRAVE TË EKZEKUTIMIT³

(Ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.416, datë 4.7.2018)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr.10 325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”, të nenit 26 të ligjit nr.8730, datë 18.1.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor” dhe të ligjit nr.10 031 datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objekt i këtij vendimi është krijimi i bazës së të dhënave “Sistemi i menaxhimit elektronik të çështjeve të përmbarimit gjyqësor” (ALBIS), që shërben edhe si regjistri qendror i kërkesave për vënie në ekzekutim të titujve ekzekutivë, sipas nenit 516/a, të Kodit të Procedurës Civile, si dhe përcaktimi i përmbajtjes së informacionit, parimeve dhe rregullave për funksionimin e këtij sistemi.

1/1. Regjistri qendror i kërkesave për vënie në ekzekutim të urdhrave të ekzekutimit mbahet vetëm në format elektronik. Format i elektronik konsiderohet baza e të dhënave të Sistemit të Menaxhimit Elektronik të Çështjeve të Përmbarimit Gjyqësor (ALBIS).

³ VKM nr. 443, datë 16.6.2011 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 94, datë 15 korrik 2011.
VKM nr. 416, datë 4.7.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 201, datë 11 korrik 2018.

1/2. Parimi bazë i funksionimit të sistemit ALBIS është përpunimi dhe mbrojtja e të dhënave/informacionit të tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të dhënat personale.

1/3. Të drejtat për aksesin dhe përpunimin e të dhënave në sistemin ALBIS, sipas rolit të përdoruesit, duhet të jenë të autorizuar, si më poshtë vijon:

- për Ministrinë e Drejtësisë, me autorizim me shkrim të ministrit të Drejtësisë;
- për përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë, me autorizim me shkrim të drejtorit të Përgjithshëm të Përmbarimit;
- për përmbaruesit gjyqësorë privatë, me autorizim me shkrim të kryetarit të Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë.

1/4. Ministria e Drejtësisë nuk mban përgjegjësi për mënyrën e përdorimit të informacionit të raportuar në sistemin ALBIS, kur ky i fundit është i pasaktë ose i paplotë, si rrjedhojë e raportimit të pasaktë e të paplotë, dhe/ose për gabime në përpunimin e informacionit nga përdoruesit e saj të autorizuar.

1/5. Lëshimi i vërtetimeve për gjendjen për ekzekutim të një titulli ekzekutiv pranë përmbarimit gjyqësor lëshohet, përkatësisht, nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit, për përmbarimin gjyqësor shtetëror, dhe Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, për përmbaruesit gjyqësorë privatë. Vërtetimi lëshohet pas paraqitjes së kërkesës, shoqëruar me kopje të mjetit të identifikimit. Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit dhe Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë evidentojnë në një regjister të posaçëm të gjitha kërkesat e këtij lloji. Format i regjistrit, formati i vërtetimit, procedura dhe kërkesat për lëshimin e tij detajohen prej tyre dhe miratohen me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

1/6. Baza e të dhënave ALBIS përmban:

a) Të dhënat e regjistrave të çështjeve përmbarimore aktive dhe/ose të pezulluara, të regjistruara deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, si dhe të çështjeve përmbarimore të reja, që paraqiten për ekzekutim pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi;

b) Të dhënat e regjistrave të çështjeve përmbarimore të pushuara, të arkivuara ose të transferuara, të regjistruara nga përmbaruesit gjyqësorë deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi;

c) Të dhënat e regjistruara në sistem nga përmbaruesit gjyqësorë, sipas numrit të protokollit të librit të përmbaruesit gjyqësorë ose zyrës/shoqërisë përmbarimore për dokumentet procedurale, vendimet, urdhrat e ekzekutimit apo të dhënave që lidhen me çështjen dhe palët në procesin e ekzekutimit;

ç) Elemente të sigurisë;

d) Informacion për procesin ekzekutues të çështjes përmbarimore të përmbaruesit, i cili paraqitet kur kërkohet nga strukturat që kanë të drejtën e aksesit në sistem;

dh) Materiale për instruktim, në ndihmë për përdoruesin e sistemit;

e) Ndërfaqe të bazuar në teknologjinë portal;

ë) Funksione kërkimi;

f) Raportim të statistikave dhe analizave (në dimensione të ndryshme dhe në kohë reale).

2. Përbërësit e arkitekturës software dhe hardware të sistemit parashikohen në aneksin nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Të dhënat që përmban sistemi ndahen në të dhëna parësore e të dhëna dytësore, si më poshtë vijon:

a) Të dhëna parësore konsiderohen të dhënat e mbledhura në kohë reale dhe që kanë të bëjnë me:

i. të dhëna për çështjet përmbarimore dhe përshkrime për ekzekutimin e tyre;

ii. fazën procedurale të procesit përmbarimor, referuar dokumenteve të përmbaruesit gjyqësor gjatë veprimtarisë së tij, të regjistruara në sistem sipas aneksit nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Të dhëna dytësore konsiderohen të dhënat e siguruar nga ndërveprimi me baza të tjera të të dhënave shtetërore dhe kanë të bëjnë me:

i. palët;

ii. të tretët;

iii. të dhëna të vendimeve gjyqësore;

iv. ndërveprimin me institucionet e tjera.

4. Modeli i paraqitjes së të dhënave parësore dhe atyre dytësore parashikohet në aneksin nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Subjektet përgjegjëse të sistemit ALBIS janë, si më poshtë vijon:

a) Institucioni administrues është Ministria e Drejtësisë.

b) Dhënës të informacionit janë:

i) Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit;

ii) zyrtarë vendore të përmbartimit gjyqësor shtetëror nëpërmjet përmbartuesve gjyqësorë shtetërorë;

iii) Dhoma Kombëtare e Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë;

iv) përmbartuesit gjyqësorë privatë.

c) *Shfaqur.*

6. Ndërveprimi me bazat e tjera të të dhënave shtetërore dhe procedurat e realizimit të ndërveprimit përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, në përputhje me rregullat e miratuara në zbatim të ligjit nr.10 325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

7. Ngarkohet Ministri i Drejtësisë të nxjerrë aktet nënligjore të parashikuara në pikat 5, shkronja “c”, dhe 6, të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit dhe Dhoma Kombëtare e Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

ANEKS 1

KOMPONENTËT E ARKITEKTURËS SOFTWARE DHE HARDWARE TË ALBIS-it


(Ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 416, datë 4.7.2018)

Përshkrim teknik i ALBIS-it


Arkitektura teknike dhe funksionale e “Sistemit të menaxhimit elektronik të çështjeve të përmbartimit gjyqësor” është e orientuar 100% kundrejt shërbimeve (*SOA-Service Oriented Architecture*) dhe mundëson menaxhimin me sukses të çështjeve, dokumenteve dhe proceseve të punës së përmbartimit shtetëror dhe atij privat.

Arkitektura funksionale

Arkitektura funksionale e Sistemit është dizenuar në mënyrë që të plotësojë maksimalisht të gjitha nevojat për menaxhimin e çështjeve të shërbimit të përmbartimit gjyqësor shtetëror dhe privat, si nga ana operative, gjithashtu, dhe nga ajo organizative. Për sa i përket anës operative, ajo u siguron përmbartuesve gjyqësorë, shtetërorë dhe privatë, një sistem fleksibël me një shkallë të lartë automatizimi, duke i dhënë mundësinë e rritjes së eficiencës së tyre në maksimum. Efienca e lartë do të sigurojë si përfundim rritjen e cilësisë së shërbimit të përmbartimit gjyqësor ndaj qytetarëve shqiptarë. Për sa i përket anës organizative, arkitektura funksionale nëpërmjet raporteve, analizave, dhe statistikave u jep mundësinë organeve përkatëse të kenë në kohë reale dhe në mënyrë të saktë të gjithë informacionin e duhur për të kontrolluar dhe për të përmirësuar strukturën dhe funksionimin e këtij shërbimi.



Elementet themelore të arkitekturës funksionale janë: çështjet, dokumentet dhe palët. Këto elemente janë të ndërlidhura midis tyre dhe çdo element apo objekt tjetër në sistem është i lidhur me këto:



Sistemi i menaxhimit elektronik të çështjeve i ndërtuar në bazë të kërkesave të Ministrisë së Drejtësisë përbën një sistem të plotë dhe të avancuar duke plotësuar tërësisht kërkesat e shkallëzuara dhe të sofistikuara të shërbimit përmbartimor gjyqësor. Karakteristikat ose funksionet e tij kryesore mund të përmbledhen si më poshtë:

- Menaxhimi i çështjeve:

- regjistrimi i çështjeve;
- shpërndarja e çështjeve;
- monitorimi dhe ndjekja e çështjeve;
- alarme për çështjet.

- Menaxhimi i dokumenteve:

- regjistrimi i dokumenteve;
- integrimi me *Microsoft Office*;
- prodhimi i dokumenteve të çështjeve;
- kategorizimi i dokumenteve;


- integrimi me *Windows Explorer*.
- **Menaxhimi i kontakteve:**
 - regjistri i kontakteve;
 - struktura e dosjeve;
 - historiku i komunikimi.
- **Siguria:**
 - siguri në nivel objekti apo dokumenti;
 - klasifikim i sigurisë.
- **Rrjedha pune të strukturuar dhe të veçanta:**
 - automatizim i proceseve;
 - rishikim i cikleve të çështjeve;
 - menaxhim i rregullave.
- **Instruktimi dhe ndihma:**
 - ndihmë dhe instruktim proaktiv i përdoruesit;
 - ndihmë në përputhje me kontekstin.
- **Ndërfaqe e bazuar në teknologjinë portal:**
 - vetëshërbim;
 - ndërfaqe e bazuar sipas roleve.
- **Navigim/kërkim**
- **Raportim:**
 - statistika dhe analiza në dimensione të ndryshme;
 - statistika dhe analiza në kohë reale;
 - fleksibilitet në krijimin e raporteve.

Arkitektura teknike

Arkitektura teknike e sistemit ALBIS është e bazuar në teknologjitë më të avancuara *hardware* dhe *software*, të cilat janë të testuara dhe sigurojnë një menaxhim dhe kontroll të plotë të proceseve dhe dokumenteve të sistemit të përmbarimit. Sistemi përmban opsionin përkatës që përmbaruesit gjyqësorë privatë të mund të logojnë vetëm përmes sistemit SIAIP, që përdoret prej tyre, në sistemin ALBIS. Ky opsion bën të mundur që përmbaruesit privatë të mos logohen dy herë, por mjafton të jenë të loguar 1 herë në SIAIP dhe me të njëjtat kredenciale, nëse duan, vijojnë punën në sistemin ALBIS.

Arkitektura software


Arkitektura *software* e ALBIS-it është e bazuar në platformën e IBM FileNet P8, e cila në bashkëpunim me komponentët e tjerë mundëson menaxhimin e çështjeve dhe të dokumenteve, në mënyrë të pajtueshme me të gjitha llojet e rregullave institucionale apo ligjore të shërbimit përmbarimor shtetëror apo privat. Gjithashtu, ajo bën të mundur kontrollin dhe menaxhimin nga Ministria e Drejtësisë, e të gjitha proceseve, informacionit dhe sigurisë.



Hierarkia e përdoruesve

Sistemi do të ketë këto role përdoruesish:

- **Administratori** do të ketë të drejtat e administrimit të sistemit.
- **Specialistët me detyra monitoruese** të Ministrisë së Drejtësisë ose të DPP-së do të kenë të drejta leximi në ato çështje që ata do të kontrollojnë.
- **Drejtori i përgjithshëm i DPP-së dhe drejtori i Përgjithshëm i Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë** do të ketë të drejta leximi të të gjitha çështjet e përmbarimit shtetëror.
- **Drejtori i Përgjithshëm i Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë** do të ketë të drejta leximi të të gjitha çështjet e përmbarimit privat.
- **Kryetari i Zyrës Rajonale** do të ketë të drejta të regjistrojë një çështje në sistem, të hedhë shortin, të zëvendësojë përmbaruesin (e zyrës përkatëse), të transferojë çështjen në një zyrë tjetër. Do të ketë të drejta leximi në të gjitha çështjet e zyrës së tij. Gjithashtu, do të ketë të njëjtat të drejta me një përmbarues kur ai/a jo është përgjegjës për çështjen.
- **Përmbaruesi shtetëror** do të ketë të gjitha të drejtat e nevojshme për përpunimin e çështjeve që i janë përcaktuar. Do të ketë mundësi të shikojë vetëm çështjet që i takojnë.
- **Përmbaruesi privat** do të ketë të gjitha të drejtat e nevojshme për regjistrimin dhe procesimin e çështjeve që ai ka marrë përsipër.




Arkitektura *hardware* (*Data-Center* në Ministrinë e Drejtësisë)

Arkitektura teknike *hardware* e AIBIS-it është një arkitekturë e dizenuar duke përdorur pajisje të teknologjisë së fundit që bëjnë të mundur funksionimin me performacë maksimale të sistemit.

Pajisjet e njësive qendrore (*Data Center*) përshijnë infrastrukturën e mëposhtme:

1. Fujitsu PY BX900 S1 System Unit me 8 server-a: PY BX920 S2 Dual Server Blade;
2. Firewall Cisco ASA5510-AIP10-K9;
3. UPS e instaluar në një Rack Fujitsu;
4. 46 HU Fujitsu Primergy Primecenter Rack.



ANEKS 2
MODELI I PARAQITJES SË TË DHËNAVE TË SISTEMIT ALBIS
(Ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.416, datë 4.7.2018)

1. Të dhëna parësore

ALBIS-i regjistron këto të dhëna parësore:

Fushat	Përshkrimi
Nr. i çështjes	Nr. i çështjes/i dosjes përbarimore që regjistrohet. Vendoset nga ALBIS.
Nr. i vjetër i çështjeve	Numri i vjetër i çështjeve të regjistruara. Do të përdoret për çështjet aktive të cilat janë hapur përpara kalimit <i>online</i> të sistemit.
Zyra e përbarimit/ përbaruesi privat	Zyra e përbarimit shtetëror ose përbaruesi privat: vendoset nga ALBIS profili i përdoruesit.
Nr. i protokollit	Numri i protokollit me të cilin është regjistruar kërkesa për hapjen e çështjes përbarimore në zyrën shtetërore.
Data/nr. i prot. të kërkesës	Data e regjistrimit të kërkesës për vënie në ekzekutim të kreditorit nga përbaruesi gjyqësor privat ose shoqëria përbarimore/nr. prot.
Nr./datë e urdhrit ekzekutiv/vendimit	Numër/datë e urdhrimit të ekzekutimit ose numër/datë e vendimit të gjykatës kur nuk ka urdhër ekzekutimi të veçantë.
Gjykata	Gjykata që ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit/vendimin.
Titulli ekzekutiv	Lloji i titullit ekzekutiv (numër, datë, të dhëna, original apo i noterizuar)
Objekti	Përshkrimi i shkurtër i objektit të ekzekutimit.
Data e regjistrimit	Data e regjistrimit të çështjes (dd.mm.vvvv).
Statusi i çështjes:	Vendoset statusi i çështjes (aktiv, pezulluar, pushuar).
Transferimet e çështjeve përbarimore	Vendoset nr. datë vendimi, autorizimi për transferimin e çështjes përbarimore (emri i transferuesit dhe i marrësit).
Data e fillimit të ekzekutimit	Data në të cilën përbaruesi fillon ekzekutimin e çështjes (dokumenti i parë procedural i përbaruesit, nr. /datë).
Kreditori	Kreditori, bashkëkreditorët, përfaqësuesit ligjorë.
Debitori	Debitor, debitorët, dorëzanësit, hipotekuesit, palët e lidhura.

Lloji i detyrimit (monetar ose jomonetar)	Vendoset shuma e detyrimit të debitorit ose lloji i detyrimit jomonetar.
Lloji i taksës Lloji i tarifës	Vendoset lloji i taksës përmbartimore: E vlerësueshme (%) ose e pavlerësueshme (3.800) dhe lloji i tarifës.
Komunikimi	Jepen të dhëna në lidhje me komunikimin ndërinstitucional shkresor të çdo çështjeje përmbartimore.
Informacion mbi procesin ekzekutues nga përmbartuesi gjyqësor	Jepet një informacion i kërkuar nga ministri i Drejtësisë apo struktura e autorizuar prej tij në lidhje me procesin ekzekutues të çështjes përmbartimore.
Komente	Mund të shkruhen komente nga më të ndryshmet.

2. Të dhëna dytësore

ALBIS-i regjistron këto të dhëna dytësore:

Person juridik (kompanitë/institucionet)	Regjistri tregtar i QKB-së
Emri	Emërtimi i kompanisë apo i institucionit
E-mail	Adresa e postës elektronike
Numrat e telefonit	Vendosen numrat e telefonit. Mund të shtohen sipas nevojës
Adresa	Vendoset adresa e personit juridik
Kodi postar	Vendoset kodi postar
Qyteti	Qyteti (<i>list</i>)
Shteti	Shteti
NIPT	NIPT-i i kompanisë
Lloji i palës	Përzgjidhet nga lista lloji i kompanisë apo i institucionit
Person fizik (individ)	Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile
Emri	Vendoset emri i plotë i individit së bashku me atësinë
E-mail	Adresa e postës elektronike
Numrat e telefonit	Vendosen numrat e telefonit. Mund të shtohen sipas nevojës
Adresa	Vendoset adresa e personit
Kodi postar	Kodi postar
Qyteti	Qyteti
Shteti	Shteti
ID	Vendoset numri personal i kartës së identitetit
Të dhëna automjeti	Regjistri Kombëtar i Mjeteve
Targa e mjetit	Vendoset targa e mjetit të debitorit
Nr. i shasisë	Numri i shasisë së mjetit
Të dhëna të mjetit (lloji, marka, modeli, tipi, karrocëria, ngjyra, nr. i dyerve, lënda djegëse, fuqia, cilindrata, viti i prodhimit, nr. i vendeve)	Të dhëna të skedës teknike të mjetit

Lloji i përdorimit	Lloji i përdorimit
Pronari i mjetit (ID, emër mbiemër, adresa)	Të dhëna të pronarit (debitorit)
Të dhëna të pasurive të paluajtshme	Regjistri elektronik i pasurive të paluajtshme
Nr. i pasurisë	Vendoset nr. i pasurisë
Zona kadastrale	Vendoset nr. i zonës kadastrale
Volum, faqe	Të dhëna të volumit dhe të faqes të shënuara në kartelë
Lloji i pasurisë	Lloji i pasurisë
Të dhëna të pronarëve (ID, emër mbiemër, adresa)	Të dhëna të pronarit/pronarëve të pasurisë
Gjendja juridike e pasurisë	Vendoset gjendja juridike e pasurisë

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr.3880/3, datë 3.6.2011

PËR PROCEDURAT E BASHKËPUNIMIT TË SHËRBIMIT TË PËRMBARIMIT
GJYQËSOR SHTETËROR ME POLICINË E SHTETIT⁴

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 523 të Kodit të Procedurës Civile, të nenit 30 të ligjit nr.8730, datë 18.1.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përmbarimit gjyqësor”,

UDHËZOJMË:

1. Policia e Shtetit bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit dhe zyrat vendore të përmbarimit gjyqësor shtetëror për të siguruar rendin dhe qetësinë publike para, gjatë dhe pas ekzekutimit të titujve ekzekutivë, me qëllim zbatimin e legjislacionit në fuqi, duke respektuar pavarësinë e tyre dhe shmangien e konflikteve civile që mund të gjenerojnë vepra penale.

2. Kërkesat për bashkëpunim kufizohen vetëm në ato raste kur strukturat e përmbarimit gjyqësor shtetëror çmojnë që gjatë kryerjes së procedurave të ekzekutimit të titujve ekzekutivë do të ketë pengesa apo rezistencë për kryerjen e detyrës apo kur ka arsye të besueshme prej të cilave rrezikohet jeta e personave të pranishëm dhe ndërhyrja policore është e domosdoshme.

3. Me qëllim sigurimin e bashkëpunimit, zyrat vendore të përmbarimit gjyqësor shtetëror i drejtohen Policisë së Shtetit në rrugë zyrtare jo më vonë se 3 ditë përpara ekzekutimit të titujve ekzekutivë. Në rastet e urgjencës apo të ekzekutimit të titullit në mënyrë të menjëhershme, njoftimi bëhet verbalisht, por në këtë rast kërkesa me shkrim paraqitet jo më vonë se 24 orë përpara ekzekutimit të titullit ekzekutiv.

4. Në kërkesën për bashkëpunim, zyrat vendore të përmbarimit gjyqësor shtetëror paraqesin çdo informacion të nevojshëm lidhur me situatat e krijuara në përputhje me pikën 2 të këtij udhëzimi, me qëllim marrjen e masave parandaluese dhe mundësimin e ekzekutimit të titujve ekzekutivë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Policia e Shtetit detyrohet t’i përgjigjet kërkesës së bërë brenda 2 ditëve nga marrja e saj, me përjashtim të rasteve, të cilat çmohet se paraqesin urgjencë të veçantë apo legjislacioni në fuqi e parashikon ndryshe.

6. Me qëllim dhënien e ndihmës së kërkuar, Policia e Shtetit në varësi të situatës përcakton e vlerëson shkallën e rrezikshmërisë që mund të paraqitet gjatë procesit të ekzekutimit dhe mbi këtë bazë planifikon personelin, mjetet, pajisjet dhe mbështetjen teknike të nevojshme.

7. Në rast se për shkak të përmbushjes së detyrave të saj funksionale, për arsye madhore apo shkaqe të tjera të rëndësishme të veçantë, Policia e Shtetit nuk mund të mbështesë zyrat vendore të

⁴ Udhëzimi nr. 3880/3, datë 3.6.2011 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 88, datë 29 qershor 2011.

përmbarimit gjyqësor shtetëror, strukturat e Policisë së Shtetit njoftojnë me shkrim ose me mjet tjetër komunikimi këto struktura për mosmbështetjen me forca e mjete në datën e kërkuar, të paktën mbi 12 orë përpara datës dhe orës së caktuar për ekzekutim, duke argumentuar arsyen e mosbashkëpunimit apo të mosveprimit.

8. Gjatë ekzekutimit të titujve ekzekutivë Policia e Shtetit eviton rastet e ndërhyrjeve nga të tjerët, si dhe merr masa për të ndaluar rastet e shpërdorimit të detyrës nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit, duke favorizuar padrejtësisht ndonjërin nga palët.

9. Përmbaruesi gjyqësor, pas ekzekutimit të titujve ekzekutivë, përpilon procesverbalin për ekzekutimin pa probleme, të nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në ekzekutim, si dhe përfaqësuesi i Policisë së Shtetit. Një kopje e procesverbalit i dorëzohet përfaqësuesit të Policisë së Shtetit të pranishëm në ekzekutim.

10. Për çdo informacion të marrë gjatë ushtrimit të veprimtarisë, i cili mund të jetë me interes për strukturat e Policisë së Shtetit, përmbaruesit gjyqësorë kanë detyrimin e ruajtjes së fshehtësisë në raport me të tretët, përveç strukturave të Policisë së Shtetit, organit të prokurorisë apo gjykatës.

11. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTRI I DREJTËSISË

Brikena Kasmi

MINISTRI I BRENDSSHËM

Bujar Nishani

UDHËZIM

Nr. 5, datë 12.12.2012

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR ZHVILLIMIN E ANKANDIT NGA PËRMBARUESI GJYQËSOR⁵

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të katërt të nenit 573 të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objekt i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave të hollësishme për zhvillimin e ankandit nga përmbaruesi gjyqësor për shitjen e sendeve të debitorit, të cilat janë sekuestruar, për të garantuar ekzekutimin e vendimit gjyqësor të gjykatës apo të titujve të tjerë ekzekutivë, si dhe mbrojtja e të drejtave dhe interesave të pjesëmarrësve në procedurën e ankandit.

2. Përmbaruesi gjyqësor, gjatë zhvillimit të procedurës së ankandit, udhëhiqet nga parimet:

- a) e ligjshmërisë;
- b) e garantimit të të drejtave të kreditorit, nëpërmjet ekzekutimit të vendimit gjyqësor të gjykatës apo të titujve të tjerë ekzekutivë;
- c) e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit;
- ç) e transparencës;
- d) e garantimit të procesit të rregullt ligjor.

3. Përmbaruesi gjyqësor është përgjegjës për realizimin e ankandit në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile dhe të këtyre rregullave.

Përmbaruesi gjyqësor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera në përcaktimin e fituesit të ankandit, në mënyrë të tillë që të lejojë kontrollin nga strukturat përgjegjëse të zbatimit të ligjit. Këto procesverbale dhe dokumente janë pjesë e dosjes përmbarimore.

4. Përmbaruesi gjyqësor duhet të shmangë kërkesat apo procedurat që përbëjnë diskriminim ndaj ose ndërmjet kandidatëve blerës apo ndaj kategorive të tyre.

⁵ Udhëzimi nr. 5, datë 12.12.2012 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 185, datë 23 janar 2013.

5. Përmbartuesi gjyqësor refuzon një ofertë ose një kërkesë për pjesëmarrjen në procedurën e ankandit, nëse:

a) ofertuesi apo kandidati blerës i jep ose premtion t'i japë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një shpërblim në çfarëdolloj forme, mundësi punësimi ose mall, shërbim ose vlerë, si stimul për një akt, vendim apo procedurë që ndërmer përmbartuesi gjyqësor për procedurën e ankandit;

b) ofertuesi ose kandidati është në kushtet e konfliktit të interesit. Refuzimi dhe arsyet për një veprim të tillë pasqyrohen në procesverbalet e procedurave të ankandit dhe i komunikohen menjëherë e zyrtarisht, kandidatit ose ofertuesit në fjalë. Në këtë rast, përmbartuesi gjyqësor, kur aktet apo veprimet në fjalë përbëjnë vepër penale, bën kallëzim penal, sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.

6. I gjithë dokumentacioni, njoftimet, vendimet, informacionet dhe komunikimet e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile dhe në këtë udhëzim bëhen ose dokumentohen me shkrim dhe janë pjesë e dosjes përmbartimore.

Komunikimi, shkëmbimi dhe ruajtja e informacionit kryhet në mënyrë të tillë, që të sigurojë ruajtjen e integritetit të të dhënave, konfidencialitetin e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje.

7. Përmbartuesi gjyqësor vendos në dispozicion të çdo personi të interesuar, me kërkesë të tij, pasi është përcaktuar oferta fituese apo pasi procedurat e ankandit kanë përfunduar pa përcaktuar një fitues, informacionin e administruar për çdo ankand, brenda 5 (pesë) ditëve nga paraqitja e kërkesës.

Në çdo rast, përmbartuesi gjyqësor vë në dijeni menjëherë, por jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga marrja e vendimit:

- a) çdo kandidat të pasuksesshëm, për arsyet e refuzimit të pjesëmarrjes së tij në ankand;
- b) çdo ofertues të pasuksesshëm, për arsyet e refuzimit të ofertës së tij;
- c) çdo ofertues të suksesshëm, që ka paraqitur një ofertë të vlefshme, për karakteristikat dhe përparësitë e ofertës së përzgjedhur.

Përfashtim nga e drejta për informim bëhet vetëm në rast se dhënia e informacionin vjen në kundërshtim me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale ose cenon interesin publik apo interesat ligjore dhe ekonomike të palëve, ose pengon konkurrencën e drejtë.

Në çdo rast emrat dhe numri i kandidatëve, që kanë shfaqur interes për blerjen e dokumentacionit të ankandit apo këqyrjen e tij, duhet të mbahen konfidenciale. Përmbartuesi gjyqësor nuk i bën publike informacionet e marra nga kandidatët blerës ose ofertuesit, të etiketuara si konfidenciale, ku veçanërisht përfshihet informacioni për aspektet teknike, sekretet tregtare dhe informacionet konfidenciale të ofertave.

8. Afatet kohore në këtë udhëzim jepen në ditë pune, me përfashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe.

II. PËRGATITJA E ANKANDIT

1. Pas vënies së sekuestros, përmbartuesi gjyqësor i kërkon kreditorit dhe debitorit që, me marrëveshje, të përcaktojnë vlerën e sendit.

Nëse brenda një jave nga njoftimi, kreditori dhe debitori nuk arrijnë marrëveshjen, përmbartuesi gjyqësor, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, përcakton me vendim vlerën e sendit, bazuar në aktin e ekspertimit, të paraqitur nga një ekspert i licencuar, dhe vlerën reale të pasurisë në treg, në çastin e vënies së sekuestros mbi të.

Në këtë rast, përmbartuesi gjyqësor njofton kreditorin dhe debitorin për çmimin e caktuar, duke e lajmëruar këtë të fundit që në rast se brenda 10 (dhjetë) ditëve nga njoftimi ai nuk përmbush detyrimin, sendi i sekuestruar do të shitet në ankand.

2. Të nesërmen e kalimit të afatit 10-ditor nga njoftimi për përmbushjen e detyrimit, përmbartuesi gjyqësor nxjerr vendimin për shitjen e sendit në ankand, duke bërë edhe shpalljen për këtë qëllim, e cila afishohet në pjesë të dukshme dhe lehtësisht të aksesueshme për publikun e gjerë në:

- a) zyrën e përmbartuesit gjyqësor;
- b) vendin ku ndodhet sendi;
- c) gjykatën që ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit;
- ç) komunë, bashki apo njësi bashkiake, sipas rastit;

d) një vend apo vende të tjera publike, që përmbaruesi gjyqësor i çmon të përshtatshme për të siguruar nxitjen e konkurrencës dhe pjesëmarrjen e blerësve në procedurën e ankandit.

Shpallja e shitjes në ankand u njoftohet edhe kreditorëve që kanë hipotekë mbi sendin.

3. Përmbaruesi gjyqësor, në shpalljen për shitjen në ankand, përcakton domosdoshmërisht:

- a) gjenealogjetet e pronarit të sendit, ku përfshihen emri, atësia dhe mbiemri;
- b) specifikimin nëse për sendin është vënë hipotekë dhe për çfarë shume të hollash;
- c) çmimin e sendit me të cilin do të fillojë shitja;
- ç) vendin ku do të realizohet ankandit;
- d) ditën kur do të përfundojë shitja në ankand.

4. Përmbaruesi gjyqësor, për përcaktimin e afateve kohore për dorëzimin e ofertave të ankandit dhe të kërkesave për pjesëmarrje, duhet të mbajë parasysh kompleksitetin e objektit të ankandit dhe kohën e kërkuar për hartimin e ofertave, pa cenuar kufijtë kohorë minimalë, dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Shitja nuk mund të bëhet para se të kenë kaluar, minimalisht, 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga shpallja e ankandit.

5. Shpallja për shitjen në ankand shoqërohet edhe me informacionin për:

- a) sendin që do të shitet;
- b) vendin, adresën dhe afatin e fundit kohor, për paraqitjen e ofertave dhe dorëzimin e dokumenteve të ankandit;
- c) gjenealogjetet e përmbaruesit gjyqësor, që është përgjegjës për realizimin e ankandit;
- ç) gjuhën/gjuhët, në të cilën/at duhet të hartohen ofertat;
- d) mënyrën dhe kushtet për marrjen e dokumenteve të ankandit;
- dh) orën dhe datën e hapjes së ofertave, si dhe pjesëmarrjen në hapjen e tyre.

Informacioni për sendin që do të shitet në ankand përgatitet nga përmbaruesi gjyqësor dhe përmban karakteristikat e sendit, duke e përshkruar atë sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, për të krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Informacioni për sendin që do të shitet në ankand:

- i) duhet t'i referohet aktit të pronësisë mbi sendin apo aktit ligjor të disponibilitetit të tij;
- ii) duhet të përshkruajë sendin në përputhje me standardet e vlerësimit sipas sasisë, çmimit për njësi dhe çmimit në total, metodologjisë së përdorur për vlerësimin e sendit të shitjes;
- iii) duhet të shoqërohet, kur është e nevojshme, me genplane, planimetri të objektit, vizatime, modele, makete, mostra, fotografi, analiza kimike dhe dokumente të ngjashme;
- iv) duhet të përshkruajë gjendjen funksionale të sendit nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale.

Informacioni duhet të hartohet në një mënyrë të përshtatshme që u lejon kandidatëve të vendosin nëse do të marrin pjesë apo jo në procedurat e ankandit.

6. Përmbaruesi gjyqësor është përgjegjës për ankandin, në përputhje me rregullat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe në këtë udhëzim.

7. Modeli standard i shpalljes për shitjen në ankand, informacionit që shoqëron shpalljen dhe dokumenteve të tjera të ankandit përcaktohen nga Dhoma Kombëtare e Përmbaruese Gjyqësorë Privatë me miratimin e Ministrit të Drejtësisë.

8. Çmimi fillestar në ankand është 80 për qind i çmimit të përcaktuar sipas nenit 564 të Kodit të Procedurës Civile.

III. ZHVILLIMI I ANKANDIT

1. Ofertuesit nënshkruajnë një deklaratë, përmes së cilës deklarojnë se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me përmbaruesin gjyqësor, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Secili ofertues që merr pjesë në ankand nëpërmjet paraqitjes së ofertës, përpara fillimit të ankandit duhet të depozitojë si garanci, në zyrën e përmbarimit, një shumë të hollash të barabartë me 10 për qind të çmimit të sendit të caktuar në shpallje.

Kreditori nuk lë garanci, në rast se kredia e tij e kalon masën e garancisë.

3. Përmbaruesi gjyqësor kualifikon në procedurat e ankandit çdo kandidat ose ofertues, vetëm nëse:

a) jep ofertën dhe ankandin brenda afatit të përcaktuar në shpalljen për shitjen në ankand;
b) paraqet formularin e sigurimit të ofertës për shumën dhe vlefshmërinë e kërkuar në dokumentet e ankandit;

c) paraqet dokument identifikimi;

ç) kandidati ose ofertuesi është person juridik, paraqet, sipas rastit:

i) vërtetimin nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit;

ii) certifikatën e regjistrimit në organet tatimore ose NIPT-in.

4. Pas paraqitjes së ofertës nuk duhet të kryhet asnjë bisedim për ofertën ndërmjet përmbaruesit gjyqësor dhe ofertuesit. Përmbaruesi gjyqësor nuk ka të drejtë t'u kërkojë ofertuesve të ndërmarrin përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentet e ankandit, apo të ndryshojnë vlerën e ofertës ose ta modifikojnë në çfarëdolloj mënyre atë.

5. Shitja e sendit bëhet në zyrën e përmbaruesit gjyqësor ose në një vend tjetër publik, nëse është i përshtatshëm për zhvillimin e ankandit dhe që është njoftuar në shpalljen e shitjes në ankand. Ajo vazhdon 15 (pesëmbëdhjetë) ditë dhe përfundon me mbarimin e orarit zyrtar të ditës së fundit që tregohet në shpalljen për shitjen në ankand.

6. Përmbaruesi gjyqësor i hap të gjitha ofertat në datën, vendin dhe kohën e përcaktuar në dokumentet e ankandit, pas mbarimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose pas mbarimit të afatit përfundimtar të përcaktuar pas zgjatjes së këtij afati.

Emri, adresa e ofertuesit, oferta e të cilit hapet, dokumentacioni ligjor dhe çdo dokument i kërkuar nga përmbaruesi gjyqësor, si dhe çmimi i çdo oferte lexohen me zë të lartë për ata persona që janë të pranishëm dhe regjistrohen në procesverbalin e procedurës së ankandit.

Procesverbali duhet t'i vihet menjëherë në dispozicion, në bazë të kërkesës, çdo ofertuesi, ndërsa ofertuesit që ka paraqitur ofertën, por që nuk është i pranishëm ose i përfaqësuar në hapjen e ofertave, duhet t'i dërgohet për njoftim.

Për zhvillimin e ankandit mbahet procesverbal, në të cilin ofertuesi shënon, kundrejt nënshkrimit, çmimin që jep për sendin, pavarësisht nga çmimi që ka dhënë më parë. Në rast se ofertuesi vepron me përfaqësues, duhet të paraqitet dhe të shënohet në procesverbal edhe prokura noteriale.

7. Pas përfundimit të seancës publike, përmbaruesi gjyqësor verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta që përmbushin kërkesat ligjore. Nëse përmbaruesi gjyqësor gjykon se i nevojitet më shumë se një ditë pune për të përfunduar veprimtarinë e tij, vë në dijeni pjesëmarrësit për orën dhe datën kur ofertuesve do t'u komunikohet rezultati i vlerësimit të ofertës dhe kualifikimi përfundimtar. Kohëzgjatja e procedurës nuk duhet të kalojë 10 (dhjetë) ditë.

Përmbaruesi gjyqësor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Në çdo rast, nuk duhet të kërkohej, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. Megjithatë, përmbaruesi gjyqësor duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave, me kusht që këto të mos jenë bërë për qëllime mashtrimi, duke njoftuar menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën.

Përmbaruesi gjyqësor vlerëson se oferta është e vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në shpalljen për shitjen në ankand dhe në dokumentet e ankandit.

Përmbaruesi gjyqësor vlerëson se një ofertë është e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e ankandit, apo gabime të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.

Përmbaruesi gjyqësor nuk e pranon një ofertë kur:

a) ofertuesi nuk është i kualifikuar;

b) ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik;

c) oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e ankandit;

ç) në rastet e refuzimit apo të skualifikimit, sipas dispozitave të këtij udhëzimi.

8. Në përfundim të procedurës së shqyrtimit të ofertave, përmbartuesi gjyqësor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e ankandit. Që të vazhdojë procesi i përzgjedhjes së fituesit duhet të pranohet të paktën një ofertë e vlefshme.

Ofertat renditen duke filluar me çmimet më të larta dhe deri në ato të barabarta me çmimin fillestar minimal të shitjes.

Përmbartuesi gjyqësor përcakton ofertën më të mirë, pas krahasimit dhe vlerësimit të ofertave.

Përmbartuesi gjyqësor shpall fitues ofertuesin, oferta e të cilit përmbush kriteret kualifikuese dhe ka dhënë çmimin më të lartë.

Njoftimi i fituesit i jepet menjëherë ofertuesit që ka paraqitur ofertën më të mirë, si dhe ofertuesve të tjerë të suksesshëm. Njoftimi i fituesit përmban:

- a) emrin e ofertuesit të suksesshëm dhe vlerën e ofruar prej tij;
- b) emrat e ofertuesve pjesëmarrës dhe vlerat e ofertave të tyre;
- c) emrat e ofertuesve të skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit.

Njoftimi i fituesit shpallet në një vend të dukshëm në zyrën e përmbartuesit gjyqësor.

9. Shitja e sendit në ankand është e pavlefshme nëse në procedurën e ankandit marrin pjesë si ofertues debitori, përfaqësuesi i tij ligjor, përmbartuesi gjyqësor, si dhe personat e përcaktuar në nenin 709 të Kodit Civil, dhe që sipas nenit 572 të Kodit të Procedurës Civile, nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ankand.

Në këtë rast, shuma e lënë si garanci nga blerësi kalon në dobi të shtetit dhe sendi, me kërkesë të secilit kreditor, mund të shitet përsëri në ankand, duke vepruar në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile dhe në këtë udhëzim.

10. Në rast se në ankandin e parë nuk është paraqitur asnjë ofertues, atëherë, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përfundimi i tij, përmbartuesi gjyqësor përcakton çmimin e ri të sendit, që zbritet me 20% nga çmimi i ankandit të parë. Ankandi i dytë për shitjen e sendit zhvillohet jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e caktimit të çmimit të ri dhe u nënshtrohet të njëjtave rregulla si për ankandin e parë, të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile dhe në këtë udhëzim.

Në rast se në ankandin e dytë nuk është paraqitur asnjë ofertues, atëherë veprohet sipas rregullave të përcaktuara në nenin 577 të Kodit të Procedurës Civile.

IV. PËRFUNDIMI I PROCEDURËS SË ANKANDIT

1. Pas përcaktimit të ofertuesit fitues, përmbartuesi gjyqësor njofton menjëherë blerësin që të paguajë çmimin e sendit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga mbarimi i ankandit.

2. Me pagimin e çmimit dhe të taksës mbi aktet për shitjen e sendit, përmbartuesi gjyqësor jep vendim për kalimin e sendit në pronësi të blerësit, të cilin ia njofton blerësit.

3. Blerësi fiton të gjitha të drejtat që kishte mbi sendin debitori nga momenti i nxjerrjes së vendimit për kalimin e sendit në pronësi nga përmbartuesi, i cili është i detyruar të vërë në posedim të blerësit sendin brenda 10 (dhjetë) ditëve nga pagimi i çmimit të sendit.

4. Blerësi, që nuk paguan çmimin brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij kreu, humbet të drejtën e kthimit të shumës së lënë si garanci, e cila kalon në dobi të shtetit dhe për shitjen e sendit bëhet një ankand i ri, duke ndjekur rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile dhe në këtë udhëzim.

V. ANKIMIMI

Kundër veprimeve të përmbartuesit gjyqësor, të kryera gjatë procedurës së ankandit, mund të bëhet ankim në gjykatë, në formën e kundërshtimit të veprimeve të përmbartuesit gjyqësor.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, drejtori i Përgjithshëm i Përmbartimit, Dhoma Kombëtare e Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë, Banka e Shqipërisë, si dhe përmbartuesit gjyqësorë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr. 1, datë 4.6.2014

**PËR MËNYRËN E EKZEKUTIMIT TË DETYRIMEVE MONETARE TË NJËSIVE
TË QEVERISJES SË PËRGJITHSHME NË LLOGARI TË THESARIT⁶**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 589 të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 43 e 54 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe të ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky udhëzim ka si qëllim përcaktimin e mënyrës së ekzekutimit nga llogaria e thesarit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme, që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë.

2. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe për shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin prej tyre.

3. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore realizohet nga njësia shpenzuese përgjegjëse:

a) me fondet buxhetore për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, të akorduara në ligjin vjetor të buxhetit pasardhës për njësinë shpenzuese, për shlyerjen e detyrimeve të vitit paraardhës, duke respektuar radhën e paraqitjes në njësinë shpenzuese;

b) nga të ardhura të tjera, të siguruara nga njësia e qeverisjes së përgjithshme, në bazë të legjislacionit përkatës, dhe të cilat shërbejnë si burime financimi për vetë njësinë.

4. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, gjatë vitit buxhetor, mbajnë database për vendimet gjyqësore të formës së prerë që parashikojnë detyrime monetare, si dhe për shumat e detyrimeve. Shuma totale e detyrimeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë bëhet pjesë e procesit të programimit buxhetor të vitit të ardhshëm, sipas përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore përkatëse. Këto parashikime i bëhen të njohura edhe njësisë së qeverisjes së përgjithshme nga e cila varen.

5. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore që janë parashikuar të shlyhen nga buxheti përkatës, bëhet sipas radhës së paraqitjes zyrtare të tyre në vitin paraardhës dhe grafiku i shlyerjes bëhet publik, nëpërmjet publikimit në faqen *on-line* të njësisë shpenzuese apo në forma të tjera të publikimit, që i bëhen të ditura publikut. Përmbaruesi i përmbahet grafikut të shlyerjes së detyrimit të publikuar.

6. Në rastet kur njësia shpenzuese debitore ndodhet përpara detyrimeve që kanë të bëjnë me shumën të mëdha apo jotipike, atëherë, në bazë të nenit 517 të Kodit të Procedurës Civile, i drejtohet gjykatës, për shlyerjen pjesore të detyrimit me fondet e vitit/viteve në vijim, duke bërë edhe njoftimin përkatës pranë përmbaruesit gjyqësor. Në rast pranimit, nga ana e gjykatës, të kërkesës për ekzekutimin e pjesshëm të vendimit, njësia shpenzuese gjatë planifikimit të buxhetit për vitin pasardhës parashikon si nevojë vetëm shumën e kështit/kësteve, që parashikohen të shlyhen gjatë atij viti buxhetor, në përputhje me vendimin e gjykatës.

7. Nëse gjatë vitit buxhetor ka fonde të papërdorura, përpara mbylljes së vitit buxhetor këto fonde mund të përdoren, për aq sa është e mundur, për shlyerjen e një pjese të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, duke respektuar radhën e paraqitjes.

8. Vendimet gjyqësore të njësive të qeverisjes vendore, të paraqitura zyrtarisht te këto njësi, ndjekin të njëjtën procedurë të përshkruar në këtë udhëzim.

9. Në rastin kur njësia shpenzuese nuk ka ndjekur vullnetarisht asnjë nga procedurat e parashikuara në pikat 5 ose 6 të këtij udhëzimi, atëherë përmbaruesi gjyqësor fillon procedurat e ekzekutimit të detyruar nga llogaria e thesarit. Llogari e thesarit, sipas parashikimeve të nenit 8 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”,

⁶ Udhëzimi nr. 1, datë 4.6.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 88, datë 13 qershor 2014.

të ndryshuar, konsiderohet llogaria e unifikuar e thesarit në Bankën e Shqipërisë.

10. Në rastin e parashikuar në pikën 9 të këtij udhëzimi, kur përmbaruesi gjyqësor kërkon vendosjen e masës së sekuestros, ndiqet procedura e mëposhtme:

a) Përmbaruesi gjyqësor i dërgon titullarit të njësisë shpenzuese dhe degës së thesarit:

- dokumentin që vërteton njoftimin e njësisë shpenzuese debitore për ekzekutimin vullnetar dhe të detyruar të detyrimit dhe marrjen dijeni nga ana e tij. Dokumentacioni është, sipas rastit, origjinal ose i noterizuar apo i vërtetuar “njësia me origjinalin”, nga sekretaria e gjykatës;

- vendimin gjyqësor, i cili, në kuptim të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile, konsiderohet si titull ekzekutiv;

- kërkesën/urdrin e zyrës së përmbarimit për vendosjen e masës së sekuestros.

b) Titullari i njësisë shpenzuese, brenda 5 (pesë) ditëve, i kërkon degës së thesarit pagesën e shumës së detyrimit nga llogaria e parashikuar në këtë udhëzim;

c) Dega e thesarit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës nga titullari i njësisë shpenzuese, bën pagesën e detyrimit.

11. Nëse titullari i njësisë shpenzuese nuk paraqet kërkesën brenda afatit të parashikuar në shkronjën “b” të pikës 10, dega e thesarit vendos masën e sekuestros në shpenzimet operative (artikulli buxhetor 602) të njësisë shpenzuese, në masën e vendimit gjyqësor të formës së prerë, por pa prekur shpenzimet e detyrueshme për funksionimin e institucionit, si: energji, ujë dhe materiale e shërbime speciale (artikulli 6021), të përshkruara në Manualin e Shpenzimeve Publike, të publikuara nga ministri i Financave.

12. Në asnjë rast nuk mund të vendoset masa e sekuestros mbi të ardhurat në burim të buxhetit të shtetit, pasi ato nuk janë fonde buxhetore të njësisë debitore.

13. Vendimet gjyqësore të njësive të qeverisjes qendrore, të paraqitura zyrtarisht deri më datë 31.12.2013, në Ministrinë e Financave, të shlyhen sipas procedurës së përcaktuar në vendimin nr. 50, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”, dhe udhëzimit përkatës, nga fondet e miratuara në ligjin vjetor të buxhetit të shtetit, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

14. Vendimet gjyqësore të njësive të qeverisjes qendrore, të paraqitura zyrtarisht te këto njësi, pas datës 31.12.2013 dhe deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, ndjekin këtë procedurë:

a) në rastin kur ka të parashikuar fonde për këtë qëllim, ekzekutohen menjëherë duke respektuar radhën e paraqitjes së vendimeve gjyqësore;

b) pjesa tjetër rregullohet si parashikim për vitin 2015, në përputhje me këtë udhëzim.

15. Udhëzimi nr. 2, datë 18.8.2011, i Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit”, shfuqizohet.

16. Ngarkohen njësitë e qeverisjes së përgjithshme, degët e thesarit dhe përmbaruesit gjyqësorë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 33, datë 29.12.2014

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR VEPRIME E SHËRBIME TË ADMINISTRATËS GJYQËSORE E MINISTRISË SË DREJTËSISË, PROKURORISË DHE NOTERISË

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, e Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, ministri i Financave dhe ministri i Drejtësisë

UDHËZOJNË:

1. Tarifat për veprime e shërbime nga administrata gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, prokurorisë, dhe noterisë, caktohen sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Agjent për mbledhjen e tarifave për kryerjen e veprimeve të shërbimeve administrative në gjykata, Ministrinë e Drejtësisë, prokurorisë caktohen administratat përkatëse të këtyre institucioneve, ndërsa agjent për mbledhjen e tarifës të shërbimit noterial, caktohet "Posta Shqiptare" sh.a.

3. Tarifat paguhën në momentin e kryerjes së veprimeve dhe bëhen me anën e pullës për tarifën fikse ose me mandatarkëtim për ato raste kur, kjo tarifë sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur, është shprehur në përqindje.

4. Termi "tarifë" në pikën 8 të shkronjës "A" të shtojcës 1, ka të njëjtin kuptim me termin "taksë mbi aktet", i përdorur në nenin 156 të Kodit të Procedurës Civile.

5. Pullat vendosen në çdo kopje të dokumentit të lëshuar, për të gjitha dokumentet që, sipas ligjit, duhet të pajisen me pulla. Dokumentet janë të vlefshme kur pulla është e vulosur nga organi që kryen shërbimin. Për plotësimin e vlerës së pullës për aktet që lëshohen mund të përdoren një ose më shumë pulla, me kusht që ato të plotësojnë vlerën e tarifës.

6. Në rast se personi kërkon kopje të akteve apo dokumenteve të lëshuara nga organet gjyqësore apo noteriale, vlera e pullës është përcaktuar në shtojcën nr. 1, me kusht që tek akti ose dokumenti të jetë shënuar fjala "kopje". Në rast të kundërt, merret vlera e plotë e tarifës.

7. Tarifa e paguar nuk kthehet kur hiqet dorë nga kryerja e veprimeve gjyqësore apo noteriale.

8. Institucionet përgjegjëse për vjeljen e tarifave me anën e pullës planifikojnë dhe porosisin në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve pullat sipas nevojave.

9. Mbi tarifën e shërbimit të përfshira në këtë udhëzim nuk aplikohet TVSH-ja.

10. Këto tarifa aplikohen në çdo rast pavarësisht tarifave të shërbimit, të parashikuara në akte të tjera ligjore apo nënligjore.

11. Administrata e gjykatave, prokurorisë, Ministria e Drejtësisë dhe "Posta Shqiptare", në cilësinë e agjentëve të mbledhjes së tarifave, në përputhje me këtë udhëzim detyrohen:

a) të bëjnë një deklaratë për çdo muaj për të ardhurat e mbledhura nga tarifa, jo më vonë se 15 ditë pas përfundimit të muajit për të cilin bëhen deklaratimet;

b) të paguajnë për llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore tarifën kombëtare të arkëtuar për atë muaj në datën ose para datës së detyrueshme të deklaratës;

Për pagesën me vonesë të shumave të arkëtuara nga tarifa për agjentin, zbatohen sanksione sipas dispozitave të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Për shkeljet, sipas përcaktimeve të nenit 117, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për agjentin e tarifës, zbatohen sanksionet e përcaktuara në këtë nen;

c) Deklarata, bëhet në formën dhe përmbajtjen që përcaktohet në udhëzimin e ministrit të Financave, nr. 26, datë 4.9.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar. Deklarata për pagesën e tarifës kombëtare plotësohet dhe dorëzohet vetëm në mënyrë elektronike nga agjentët nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, www.tatime.gov.al.

Deklarata konsiderohet e dorëzuar, në datën e dërgimit elektronik të deklaratës së plotësuar. Agjentët e përcaktuar në këtë udhëzim duhet të dorëzojnë deklaratën edhe në qoftë se për periudhën tatimore nuk kanë për të paguar detyrime për tarifën.

Mosdeklarimi brenda datës 15 të muajit pasardhës, i çdo periudhe tatimore nga agjenti i tarifës kombëtare, ndëshkohet me gjobë për mosdeklarim sipas dispozitave të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

12. Për shërbimin e kryer, institucionet përkatëse të gjykatës, Ministrisë së Drejtësisë dhe prokurorisë përfitojnë 10% komision të llogaritur mbi masën e tarifave që kanë arkëtuar.

13. Posta Shqiptare sh.a. për shërbimin e kryer përfiton 3% komision të llogaritur mbi masën e tarifave që ka arkëtuar.

14. Agjentët në përputhje me këtë udhëzim vetëllogaritin shumën që përfitojnë nga komisioni,

duke shumëzuar përqindjen e komisionit, të përcaktuar me këtë udhëzim të përbashkët, me vlerën e arketimeve nga tarifat për periudhën tatimore dhe mbajnë drejtpërsëdrejti vlerën e komisionit që përfitojnë, si dhe deklarojnë dhe paguajnë në llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore, shumën e mbetur, pasi zbritet vlera e komisionit që përfitojnë.

15. Udhëzimi nr. 13, datë 12.2.2009, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, prokurorisë dhe noterisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCEVE
Shkëlqim Cani

MINISTRI I DREJTËSISË
Nasip Naço

SHTOJCA NR. 1

TARIFA PËR VEPRIMET DHE SHËRBIMET QË KRYHEN NGA ADMINISTRATA GJYQËSORE E MINISTRISË SË DREJTËSISË, PROKURORIA DHE NOTERIA

		Masa e tarifës në lekë	Masa e tarifës në %
A.	Tarifa për veprime e shërbime që kryhen nga administrata gjyqësore e prokuroria:		
1.	Për lëshimin e vërtetimit se personi nuk ka pengesa ligjore për pajisjen me pasaportë për jashtë shtetit	200	
2.	Për lëshimin nga gjykata të çdo kopje vendimi e çdo dokumenti që kërkohet nga të interesuarit	200	
3.	Për lëshimin e dëshmisë së penalitetit nga zyrat e gjendjes gjyqësore	200	
4.	Për legalizimin e akteve të noterisë nga Ministria e Drejtësisë	200	
5.	Për lëshimin e vërtetimit se ndaj shtetasit nuk është filluar çështje penale nga prokuroria	200	
6.	Për lëshimin e vendimit të pushimit ose të vendimit të mosfillimit të çështjes penale nga prokuroria	200	
7.	Për lëshimin e vërtetimit nga gjykata se kërkuesi nuk është në proces gjyqësor.	200	
8.	Kërkesë padi që paraqiten në gjykatë:		
	a) për pension ushqimor	0	
	b) për vërtetim fakti	200	
	c) padi për zgjidhje martese	3000	
	ç) padi për pavlefshmëri të veprimeve juridike	3000	
	d) padi të rrjedhura nga marrëdhënie kontraktore, si dhe për shkaktim dëmi	3000	
	I) me vleftë deri 100 000 lekë	3000	
	II) me vleftë mbi 100 000 lekë		1%
	dh) padi për pjesëtim pasurie	3000	
	e) padi për kthim në punë	0	
9.	Pranimi i ankimeve kundër vendimeve të gjykatës	200	

	Masa e tarifës në lekë	Masa e tarifës në %
B. Tarifë për veprime që kryhen nga përmbaruesi gjyqësor shtetëror:		
1. Për vënien në ekzekutim të vendimeve e titujve të tjerë ekzekutivë me objekt të pavleftësueshëm	3500	
2. Për vënien në ekzekutim të vendimeve e titujve të tjerë ekzekutivë me objekt të vleftësueshëm:		
a) kundrejt shtetasve		2%
b) kundrejt personave juridikë		2%
3. Për lajmërimet dhe veprimet e tjera të përmbaruesit gjyqësor	200	
4. Për lëshime nga përmbaruesi gjyqësor të çdo lloj akti ose dokumenti të kërkuar nga të interesuarit	200	
5. Për vënien në ekzekutim të vendimeve me objekt pension ushqimor	0	
C. Tarifa e pullës që zbatohet për veprimet që kryehn nga zyrat noteriale:		
1. Përpilimi i testamentave me akte noteriale	450	
2. Depozitimi i testamentave ollografe	200	
3. Prokura (redaktimi);		
a) Të përgjithshme	200	
b) B) të posaçme	200	
4. Për lëshimin e kopjeve, shkurtime e pjesë të akteve të depozituara në zyrën noteriale	200	
5. Vërtetimi se kopjet ose shkurtime të dokumentave janë të njëjta me origjinalin	200	
6. Vërtetim përkthimi dhe vërtetim njësie me origjinalin	200	
7. Kontrata për kalim pronësie të pasurisë së luajtshme	700	
8. Kontrata për kalim pronësie të pasurisë së paluajtshme	1000	
9. Redaktimi i akteve noteriale të ndryshme	200	
10. Njoftim dhe kujtesë noteriale ose akte të tjera jashtëgjyqësore	200	
11. Legalizim i nënshkrimit të shtetasve në akte të ndryshme	200	
12. Pranimi për ruajtje të dokumenteve të personave fizikë dhe juridikë në zyrat noteriale	300	
13. Vërtetimi i qenies së një personi dhe qëndrimi i tij në një vend të caktuar	200	
14. Kundërshtimi i çekut dhe kambialit (protesta)	200	
15. Kontratë qiraje	200	
16. Kontratë huaje	200	
17. Kontratë sipërmarrje	200	
18. Veprime të tjera noteriale	200	

UDHËZIM

Nr. 1276/5, datë 27.7.2017

PËR CAKTIMIN E TARIFAVE PËR SHËRBIMET E OFRUARA NGA SHËRBIMI PËRMBARIMOR GJYQËSOR SHTETËROR⁷

(Ndryshuar me udhëzimin nr. 32, datë 30.8.2018)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, si dhe neneve 12 dhe 12/a, të ligjit nr. 8730, datë 18.1.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”, të ndryshuar, ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave

⁷ Udhëzimi nr. 1276/5, datë 27.7.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 155, datë 2 gusht 2017.

Udhëzimi nr. 32, datë 30.8.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.132, datë 3 shtator 2018.

UDHËZOJNË:

I. Objekti dhe qëllimi

1. Ky udhëzim përcakton llojet e shërbimeve përmbareme të tarifuar dhe masën e tarifës së shërbimeve të ofruara nga përmbaresi gjyqësor shtetëror gjatë procedurës së ekzekutimit të titullit ekzekutiv.

2. Ministri i Financave dhe ministri i Drejtësisë udhëzojnë si më poshtë subjektet përmbarese në një procedurë të ekzekutimit të titujve ekzekutivë me synimin:

a) përmirësimin e punës në llogaritjen dhe dokumentimin e tarifave dhe shpenzimeve procedurale, që parapaguhen nga pala kreditore /kërkuese dhe/ose përballohen nga subjekti përmbare sipas dispozitave ligjore, nënligjore apo tarifave në fuqi;

b) shmangien e problemeve të evidentuara në praktikën e zbatimit të ligjit;

c) garantimin e pagimit të tarifave dhe shpenzimeve procedurale si detyrim i palës debitoare ose subjektit ndaj të cilit janë kryer veprime përmbareme nga një subjekt përmbare;

ç) garantimin e përlllogaritjes dhe pagimin e tarifave dhe shpenzimeve procedurale si detyrim të ekzekutimit të titullit ekzekutiv brenda një afati të arsyeshëm;

e) përcaktimin e çështjeve thelbësore të aspektit financiar dhe kontraktual të procedurës së ekzekutimit të titujve ekzekutivë sipas Kodit të Procedurës Civile, duke parashikuar aspektet në lidhje me detyrimet financiare; subjektet që duhet të paguajnë tarifën dhe/ose shpenzimet; kuotat/kuantifikimin e detyrimeve; bazueshmërinë sipas së cilës vendosen detyrimet përkatëse.

II. Parimet e skemës së tarifave dhe shpenzimeve

1. Në caktimin e skemës së tarifës fikse dhe shpenzimeve procedurale përmbareme zbatohen parimet e mëposhtme:

a) Në përcaktimin e skemës apo përlllogaritjes së tarifave reflektohen kostot e shkaktuara, direkt ose në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, në ofrimin e shërbimeve të ekzekutimit të titujve ekzekutivë.

b) Kostot e shërbimeve të ekzekutimit të titujve ekzekutivë duhet të financohen me anë të tarifave fikse të vendosura mbi kërkuesit ose përfituesit e shërbimeve.

c) Skema e tarifave ofron transparencë dhe njëkohësisht eficiencë shërbimi, mbi bazat e kostos dhe përfitueshmërisë së rezultatit të pritshëm.

d) Përlllogaritja e shpenzimeve procedurale gjatë ekzekutimit synon mirëpërcaktimin e çdo shume (edhe minimale), me qëllim dhënien e garancive financiare për subjektet përmbarese.

III. Tarifa fikse e shërbimit përmbareme gjyqësor shtetëror

1. Tarifa fikse është pagesa që arkëton Zyra Përmbareme për fillimin e procedurave të ekzekutimit dhe kryerjen e të gjitha veprimeve procedurale të parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile, deri në ekzekutimin përfundimtar të titullit ekzekutiv.

2. *Vlera e tarifës fikse të shërbimit përmbareme, kur titulli ekzekutiv përmban një detyrim monetar si kthim shume dhe/ose pagim detyrimi, përlllogaritet si më poshtë:*

a) *Tabela e tarifave fikse përmbareme në lek, sipas vlerave të detyrimit:*

Vlera e detyrimit nga ... lekë deri në ... lekë	Tarifa fikse (në lekë mbi vlerën e detyrimit)
1 – 10,000	6,000
10,001 – 20,000	7,000
20,001 – 30,000	8,000
30,001 – 40,000	9,000
40,001 – 50,000	10,000
50,001 – 60,000	11,000
60,001 – 70,000	12,000
70,001 – 80,000	13,000
80,001 – 90,000	14,000
90,001 – 100,000	15,000
100,001 – 150,000	17,000

150,001 – 200,000	18,000
200,001 – 250,000	20,000
250,001 – 300,000	22,000
300,001 – 350,000	24,000
350,001 – 400,000	26,000
400,001 – 450,000	28,000
450,001 – 500,000	30,000

b) Tabela e tarifave fikse përmbartimore në %, sipas vlerave të detyrimit:

Vlera e detyrimit nga ... lekë deri në ... lekë	Tarifa fikse (në përqindje mbi vlerën e detyrimit)
500,001 – 2,000,000	5.5%
2,000,001 – 5,000,000	3.85%
5,000,001 – 10,000,000	2.75%
10,000,001 – 30,000,000	2.2%
30,000,001 – 90,000,000	1.65%
Mbi 90,000,000	1.1% Minimumi 1, 485,000 lekë Maksimumi 2, 500,000 lekë

3. Vlera e tarifës fikse të shërbimit përmbartimor, kur titulli ekzekutiv përmban një detyrim jomonetar dhe të pavlerësueshëm, përlogaritet në varësi të objektit të ekzekutimit si më poshtë:

a) Për reklamimin e një sendi të luajtshëm ose të paluajtshëm, vlera e tarifës fikse përlogaritet në masën e **1 page bazë minimale mujore**.

b) Për lirin dhe vënien në posedim të një sendi të paluajtshëm, vlera e tarifës fikse përlogaritet në masën e **2 pagave bazë minimale mujore**, kur sendi nuk ka një vlerë monetare të përcaktuar për çmimin e shitjes sipas të dhënave nga regjistri i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, apo sipas vlerësimit të një eksperti të pavarur të caktuar nga gjykata dhe/ose përmbartuesi gjyqësor. Në rast se sendi i paluajtshëm ka një vlerë referuese për çmimin e shitjes së tij sipas të dhënave të Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme apo sipas vlerësimit të ekspertit, atëherë tarifa fikse përlogaritet në përqindje mbi vlerën e sendit, sipas tabelës së treguar në pikën 2 të këtij seksioni.

c) Për vënien në posedim të sendit të luajtshëm, vlera e tarifës fikse përlogaritet në masën e **1 page bazë minimale mujore** kur sendi nuk ka një vlerë të përcaktuar për çmimin e shitjes. Në rast se sendi i luajtshëm ka një vlerë të përcaktuar për çmimin e shitjes në dokumentacionin e regjistruar apo ka një vlerë të përcaktuar për të cilën ky send është regjistruar si barrë siguroese, atëherë tarifa fikse do të përlogaritet në përqindje sipas tabelës së parashikuar në pikën 2 të këtij seksioni.

d) Për marrjen e fëmijës dhe lejin e së drejtës së vizitës, vlera e tarifës fikse përlogaritet në masën **5,000 lekë**, ndërsa tarifa fikse që lidhet me ekzekutimin e masës së pensionit ushqimor është **zero lekë**.

e) Për organizimin dhe shitjen e sendit në ankand, vlera e tarifës fikse përlogaritet në masën e **1 page bazë minimale mujore**.

f) Për zbatimin e një vendimi gjyqësor ose titulli ekzekutiv me objekt të pavlerësueshëm, nëpërmjet të cilit debitori duhet të përmbushë një detyrim të caktuar, vlera e tarifës fikse përlogaritet në masën e **1 page bazë minimale mujore**.

4. Vlera e tarifës fikse të shërbimit përmbartimor, kur titulli ekzekutiv është vendim i gjykatës për sigurimin e padisë, përlogaritet si më poshtë:

a) Nëse vendimi për sigurimin e padisë përmban një detyrim monetar dhe vlera e padisë është deri në 500,000 lekë, tarifa është 1/4 e pagës bazë minimale mujore.

b) Nëse vendimi për sigurimin e padisë përmban një detyrim monetar dhe vlera e padisë është më shumë se 500,000 lekë deri në 2,000,000 lekë, tarifa është 1/2 e pagës bazë minimale mujore.

c) Nëse vendimi për sigurimin e padisë përmban një detyrim monetar dhe vlera e padisë është më shumë se 2,000,000 lekë, tarifa është një shumë e barabartë me 1 pagë bazë minimale mujore.

d) Nëse vendimi për sigurimin e një padie përmban një detyrim jomonetar ose vlera e padisë nuk është e përcaktuar, tarifa e subjektit përmbartimor është një shumë e barabartë me 1/3 e pagës bazë minimale mujore.

4.1 Nëse një vendim për sigurimin e padisë ka të bëjë me një pretendim monetar dhe jomonetar, normat e tarifave përkatëse merren në total.

4.2 Në rastin e ekzekutimit të një vendimi për sigurimin e padisë ose me revokimin e tij, tarifat e subjektit përmbartimor paguhet nga personi që ka kryer kërkesën për zbatimin e masës për sigurimin e padisë.

5. Tarifa për ekzekutimin e titujve ekzekutivë me objekt “gjobë penale”, “gjobë administrative” dhe “shpenzime procedurale” është:

a) Për vlerën deri në 100.000 lekë, tarifa është 10%.

b) Për vlerën mbi 100.000 lekë, tarifa është 5%.

6. Vlerës së tarifës fikse të përlogaritur nga Zyra Përmbartimore sipas pikave 2, 3, 4 dhe 5 të këtij seksioni, në momentin e faturimit i aplikohet TVSH-ja sipas legjislacionit tatimor në fuqi.

7. Tarifa fikse e përlogaritur sipas pikave 2, 3, 4 dhe 5 të këtij seksioni parapaguhet nga kreditori në llogarinë bankare të Zyrës Përmbartimore Gjyqësore në momentin e nënshkrimit të kontratës së shërbimit përmbartimor prej subjektit përmbartues dhe në fund të ekzekutimit i ngarkohet debitorit ose personave të barazuar me të.

8. Nëse kreditori/kërkuesi nuk parapaguan vlerën e tarifës fikse, përmbartuesi gjyqësor nuk fillon veprimet procedurale për ekzekutimin e titullit ekzekutiv. Në këtë rast, Zyra Përmbartimore i kthen kreditorit/kërkuesit dokumentet ligjore të administruara prej tij, brenda një afati 15-ditor nga momenti kur konstatohet mospërmbushje apo refuzim në kryerjen e pagesës së tarifës fikse përmbartimore.

Parapagimi i tarifës fikse përmbartimore nuk kërkohet në rastet kur kreditori është përjashtuar nga dispozitat ligjore që rregullojnë fushën e ekzekutimit të detyrueshëm.

9. Përjashtohen nga parapagimi i tarifës fikse të shërbimit përmbartimor:

a) Një person fizik që paraqet për ekzekutim një vendim të marrë gjatë procedimit gjyqësor, ku personi ka qenë plotësisht ose pjesërisht i çliruar nga tarifat/taksat si pasojë e pagesës për ndihmë juridike ose pagesa e një tarife shtetërore, për shkak të paaftësisë paguese.

b) Një person fizik që paraqet për ekzekutim një vendim të marrë gjatë procedimit penal me të cilin shlyhet një detyrim për kompensim të një dëmi të shkaktuar personit fizik në një vepër penale.

c) Pala kreditore që paraqet për ekzekutim një vendim përfundimtar të Gjykatës Administrative, sipas legjislacionit në fuqi “Për Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”.

d) Pala kreditore që paraqet për ekzekutim titullin ekzekutiv të “Dënimit me gjobë sipas vendimit për kundërvajtjen administrative”, të nxjerrë në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi “Për kundërvajtjet administrative”.

10. Tarifa fikse e përlogaritur sipas këtij seksioni, si rregull i ngarkohet palës debitore dhe personave të barazuar me të dhe arkëtohet pas ekzekutimit tërësor të detyrimit që përmban titulli ekzekutiv ose në proporcion me vlerën e detyrimit të ekzekutuar. Përjashtim nga ky rregull zbatohet për rastet e parashikuara nga shkronjat (a), (b), (c) dhe (e) të pikës 3 të këtij seksioni, pasi këto tarifa i ngarkohen një personi të tretë, i cili si kërkues apo përfitues konkret i veprimit të kryer nga përmbartuesi gjyqësor, është i detyruar të paguajë këto tarifa në përputhje me kushtet e parashikuara nga ky udhëzim.

11. Tarifa për ekzekutimin e titujve ekzekutivë sipas këtij seksioni, në çdo rast nuk mund të jetë më e madhe se 2,500,000 lekë, pavarësisht vlerës së detyrimit.

IV. Shpenzimet e tjera sipas nenit 525 të Kodit të Procedurës Civile

1. Shpenzimet e tjera sipas nenit 525 të Kodit të Procedurës Civile përbëhen nga shpenzimet e nevojshme për kryerjen e veprimeve procedurale për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, duke përfshirë:

a) Shpenzimet për administrimin e të dhënave të nevojshme për kryerjen e procedurave të ekzekutimit;

b) Shpenzimet për korrespondencën në lidhje me procedurën përmbartimore;

c) Shpenzimet në lidhje me transportin, magazinimin dhe ruajtjen e sendeve të sekuestruara ose pasurisë së sekuestruar;

d) Shpenzimet në lidhje me hapjen, inventarizimin, mbylljen, lëvizjen, prishjen dhe pastrimin e ambienteve ose subjekteve të tjera në proces ekzekutimi;

e) Shpenzimet në lidhje me caktimin e përfaqësuesit ligjor të palës debitoare, shpenzimet e kryera për veçimin e pjesës takuese të palës debitoare dhe shpenzimet për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë së palës debitoare;

f) Shpenzime në lidhje me publikimin e ankandit;

g) Shpenzimet e kryera për dorëzimin e barrës/ve siguruese;

h) Shpenzimet e ndihmës ligjore të përdorura nga subjekti përmbarues (brenda tarifave të përcaktuara nga udhëzimi i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Avokatëve), me qëllim zgjidhjen e çështjeve ligjore, me objekt kundërshtim veprimesh përmbarimore dhe pavlefshmëri titulli ekzekutiv. Në rastet kur me vendim gjyqësor të formës së prerë konstatohet pavlefshmëria e veprimeve përmbarimore, për shkak zbatimi gabim apo moszbatim të ligjit nga përmbaruesi gjyqësor shtetëror, ky i fundit nuk mund të faturojë shpenzimin të kreditori. Nëse këto shpenzime janë parapaguar nga kreditori, subjekti përmbarues do t'ia rikthejë ato kreditorit.

i) Shpenzimet për veprimet procedurale pranë Zyrrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, sipas tarifave zyrtare të miratuara në zbatim të legjislacionit në fuqi "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".

2. Shpenzimet e menaxhimit të Zyrës përmbarimore dhe pagesat e personelit nuk konsiderohen shpenzime të nevojshme sipas nenit 525 të Kodit të Procedurës Civile.

3. Shpenzimet e veprimeve sipas pikës 1 të këtij seksioni i paguhen subjektit që kryen këto veprime për efekt të procesit të ekzekutimit të detyrueshëm. Kur për veprimet e përcaktuara në pikën 1 të këtij seksioni ka tarifa zyrtare të miratuara nga autoritetet publike përgjegjëse, zbatohen nivelet e tarifimit të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore përkatëse. Këto shpenzime përbëjnë detyrim për t'u paguar nga debitori, ndaj të cilit ka filluar procedura e ekzekutimit dhe i ngarkohen atij (debitorit) në përfundim të procesit të ekzekutimit.

4. Për shpenzimet e parashikuara në pikën 1 të këtij seksioni, subjekti përmbarues lëshon faturë tatimore ndaj palëve kreditore apo debitoare, e cila shoqërohet me kopje të dokumenteve të pagesave të lëshuara nga të tretët, dokumente të cilat shërbejnë për të dokumentuar shpenzimet e zbritshme të subjektit përmbarues, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Shpenzimet përmbarimore të pagueshme nga subjekti përmbarues dhe të kryera në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm, sipas masës dhe llojeve në zbatim të këtij udhëzimi, përpara përfundimit të ekzekutimit, përshkruhen në një akt përmbledhës, të emërtuar "Procesverbal për shpenzimet procedurale gjatë ekzekutimit", duke bashkëlidhur faturat përkatëse. Pala debitorë, së cilës i ngarkohen këto shpenzime, ka të drejtë të njihet dhe marrë kopje të këtij procesverbali.

V. Tarifa fikse të pagueshme nga personat e tretë

1. Në rastet e shitjes së sendit në ankand, tarifa fikse e organizmit të ankandit në masën **15,000 lekë** do të paguhet nga ofertuesi që shpallet fitues në ankand.

2. Në rastet e shitjes së sendit në ankand, tarifa fikse për lirimin dhe vënien në posedim të sendit të paluajtshëm apo të luajtshëm, në masën e përcaktuar përkatësisht në shkronjat (b) dhe (c) të pikës 3, të seksionit III të këtij udhëzimi, do të paguhet nga pronari (blerësi) i sendit të paluajtshëm apo të luajtshëm në ankand.

3. Tarifa e subjektit përmbarimor për përgatitjen e një kopjeje të një dokumenti dhe lëshimin e vërtetimeve sipas kërkesës së çdo të interesuari është:

a) 5 lekë për një faqe formati A4;

b) 7 lekë për një faqe formati A3;

c) 200 lekë për një vërtetim përmbarimor.

4. Tarifave të mësipërme, në momentin e kryerjes së pagesës, u aplikohet TVSH-ja sipas legjislacionit tatimor në fuqi.

VI. Për të gjitha tarifat e parashikuara nga ky udhëzim *u aplikohet vlera përkatëse e TVSH-së*. Përveç sa

përkufizohet më sipër, debitori solidar është në mënyrë solidare përgjegjës për pagesën e tarifës dhe/ose shpenzimeve të subjektit përmbarues.

VII. Ndarja e të ardhurave, kriteret e procedurat e administrimit dhe të shpërndarjes së të ardhurave, mbledhja dhe përdorimi i tyre, bëhet sipas Udhëzimit të Përbashkët nr. 33, datë 29.12.2014, të ministrit të

Drejtësisë dhe ministrit të Financave, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë dhe Noterisë”, si dhe kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi. Tarifa e paguar nuk kthehet kur hiqet dorë nga kryerja e veprimeve përmbaremore gjyqësore.

VIII. Dispozita kalimtare dhe të fundit

1. Për procedurat përmbaremore që kanë filluar dhe nuk kanë përfunduar përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, udhëzohen subjektet përmbaremore për të:

a) mos kthyer tarifën fikse të paguar nga pala kreditore, për rastet kur tarifa e parapaguar është në vlerë më të madhe se masa e tarifës fikse sipas këtij udhëzimi;

b) mos faturuar tarifën fikse sipas këtij udhëzimi, për rastet kur tarifa e parapaguar nga kreditori është në vlerë më të vogël se masa e tarifës fikse sipas këtij udhëzimi;

c) përlllogaritur dhe faturuar palës debitore tarifën fikse të aplikueshme rast pas rasti, sipas parashikimeve të këtij udhëzimi, kur tarifat përmbaremore nuk janë parapaguar nga kreditori i procesit, për shkaqe të përjashtimit ligjor apo në rastin e pezullimit të procesit në fazën vullnetare të tij;

ç) përlllogaritur dhe evidentuar në një akt përmbledhës, të emërtuar “Procesverbal për shpenzimet procedurale gjatë ekzekutimit”, të gjitha shpenzimet përmbaremore të pagueshme nga subjekti përmbaremore dhe të arkëtueshme prej debitorit të dosjes përmbaremore aktive dhe/ose të pezulluar;

d) përlllogaritur dhe faturuar personave të tretë tarifën fikse të pagueshme prej tyre sipas parashikimeve të seksionit V të këtij udhëzimi, nëse në vijimësi të procesit përmbaremore pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi kryhen veprime procedurale të parashikuara në këtë seksion.

2. Për të gjitha procedurat përmbaremore që do të fillohen nga subjektet përmbaremore pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, tarifën fikse dhe shpenzimet përmbaremore do të përlllogariten sipas dispozitave të këtij udhëzimi.

3. Pika B, e shtojcës 1, të udhëzimit të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave nr. 33, datë 29.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë dhe Noterisë”, shfuqizohet.

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi shërbimi përmbaremore gjyqësor shtetëror, që funksionon sipas ligjit nr. 8730, datë 18.1.2001, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbaremore Gjyqësor Shtetëror”, të ndryshuar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Gazment Bardhi

MINISTRI I FINANCEVE
Helga Vukaj

UDHËZIM

Nr. 1276/6, datë 27.7.2017

**PËR PËRCAKTIMIN E NIVELIT MINIMAL DHE MAKSIMAL TË ZBATIMIT TË
VLERËS SË TARIFËS SË SUKSESIT PËR VEPRIMET PËRMBAREMORE TË
OFRUARA NGA SHËRBIMI PËRMBAREMORE GJYQËSOR SHTETËROR⁸**

(Ndryshuar me udhëzimin nr. 33, datë 30.8.2018)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, si dhe neneve 12 dhe 12/b, të ligjit nr.8730, datë 18.1.2001, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbaremore Gjyqësor Shtetëror”, të ndryshuar, ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave

⁸ Udhëzimi nr. 1276/6, datë 27.7.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 155, datë 2 gusht 2017.

Udhëzimi nr. 33, datë 30.8.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.132, datë 3 shtator 2018.

UDHËZOJNË:

I. Qëllimi udhëzimit

1. Ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave udhëzojnë si më poshtë subjektet e përfshira në një procedurë të ekzekutimit të vendimit gjyqësor nga shërbimi përmbarimor gjyqësor shtetëror me synimin:

- a) rritjen e cilësisë dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve përmbarimore;
- b) përcaktimin e parimeve për tarifat e suksesit dhe sigurimin e transparencës së llogarive dhe arkëtimit gjatë ofrimit të shërbimit përmbarimor;
- c) ndërveprimin shkakësor të përfitimit financiar me cilësinë e shërbimit;
- d) mbrojtjen e interesave të palës kreditore/kërkuese dhe siguri i trajtimit të barabartë të tyre, duke u bazuar në përfutueshmërinë e ndërsjellë.

II. Rregulla të përgjithshme mbi aplikimin e tarifës së suksesit

1. Masa e tarifës së suksesit është shprehje e vullnetit të palës kreditore dhe përmbaruesit gjyqësor dhe përcaktohet me marrëveshje të nënshkruar nga të dyja palët, në momentin e nënshkrimit të kontratës së shërbimit. Marrëveshja me të cilën caktohet tarifa e suksesit, e nënshkruar rregullisht midis kreditorit dhe subjektit përmbarues, bëhet pjesë integrale e kontratës së shërbimit përmbarimor, duke pasur të njëjtën fuqi ligjore me kontratën.

2. Marrëveshja për aplikimin e tarifës së suksesit që nënshkruhet ndërmjet kreditorit dhe subjektit përmbarues, duhet të nënshkruhet sipas formatit “tip”, miratuar me urdhër të veçantë nga ministri i Drejtësisë.

3. Marrëveshja sipas modelit “tip” të miratuar, në të cilën përcaktohet tarifa e suksesit, nënshkruhet nga kreditori/kërkuesi dhe kryetari i Zyrës Përmbarimore në të cilën është paraqitur kërkesa për ekzekutim.

4. Pala kreditore dhe subjekti përmbarues përcaktojnë vlerën konkrete, brenda nivelit minimal dhe maksimal të vlerës së tarifës së suksesit përcaktuar në këtë udhëzim, bazuar në kriteret e mëposhtme si:

- a) shumën totale të detyrimit;
- b) kohën e ekzekutimit nga ana e subjektit përmbarues;
- c) shpejtësinë e kryerjes së veprimeve përmbarimore, brenda afateve maksimale ligjore;
- d) përcaktimin e veprimeve apo rezultateve alternative që konsiderohen në mënyra të ndryshme si sukses, duke përllogaritur tarifa alternative suksesi;
- e) përcaktimin e nivelit minimal të arkëtimit të detyrimit, që do të konsiderohet si sukses nga palët;
- f) sekuestrimin dhe/ose ekzekutimin e sendeve në pronësi të palës debitore, përveç pasurive të hipotekuara nga pala debitore si mjet për të siguruar ekzekutimin e detyrimit.

5. Masa e tarifës së suksesit të përcaktuar në marrëveshjen e nënshkruar midis kreditorit dhe subjektit përmbarues, duhet të respektojë nivelin minimal dhe maksimal të aplikimit të saj, sipas përcaktimit në këtë udhëzim.

6. Tarifa e suksesit paguhet në çdo rast nga kreditori, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në marrëveshjen e nënshkruar nga kreditori dhe Zyrës Përmbarimore. Tarifa e suksesit nuk parapaguhet dhe nuk i ngarkohet debitorit.

7. Në çdo rast, *mbi tarifën e suksesit aplikohet TVSH-ja*, e cila llogaritet në momentin e pagesës dhe vetëm për atë pjesë të tarifës së suksesit e cila arkëtohet nga përmbaruesi gjyqësor, bazuar në kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshje.

8. Tarifa e suksesit aplikohet vetëm me vullnetin e palëve, të formalizuar në marrëveshje, përllogaritet dhe faturohet pjesërisht apo plotësisht nga Zyra Përmbarimore, paguhet nga kreditori dhe nuk i ngarkohet debitorit.

9. Drejtori i Përgjithshëm i Përmbarimit miraton me urdhër metodologjinë mbi mënyrën e negocimit dhe parashikimit të masës konkrete të tarifës së suksesit, të specifikuar sipas rasteve dhe objektit, që do të duhet të aplikohet apo pranohet nga kryetari i Zyrës Përmbarimore.

III. Tarifa e suksesit e përllogaritur mbi bazën e shumës së ekzekutuar

1. *Kur titulli ekzekutiv përmban një detyrim monetar, pala kreditore dhe subjekti përmbarues, sipas vullnetit të tyre,*

mund të parashikojnë në marrëveshje masën e tarifës së suksesit, por në çdo rast kjo tarifë nuk mund të jetë më e vogël se 1% dhe jo më e madhe se 20% e vlerës së ekzekutuar të detyrimit.

Në rast të marrjes pjesë në ekzekutim edhe të kreditorëve të tjerë të po atij debitori, secili prej tyre ka të drejtë të përvaktojë se cila do të jetë vlera e tarifës së suksesit.

2. Pala kreditore ka detyrimin që të informojë për shumat e ekzekutuara në llogarinë e saj, si dhe t'i paguajë subjektit përmbaues tarifën e suksesit për shërbimin e arkëtimit të detyrimit monetar të mbledhur, jo më vonë se 30 ditë nga momenti i realizimit të arkëtimit të detyrimit monetar. Në rast se ekzekutimi i shumës së detyrimit monetar kryhet nëpërmjet llogarisë bankare të subjektit përmbaues, pagesa/faturimi i tarifës së suksesit do të bëhet pas kreditimit të kësaj pagese në llogarinë e palës kreditore/kërkuesit.

3. Tarifa e suksesit e caktuar në marrëveshje ndërmjet kreditorit dhe përmbauesit gjyqësor shtetëror, kur titulli ekzekutiv përmban një detyrim monetar në vlerë:

a) Deri në 500,000 lekë nuk mund të jetë më e vogël se 1% dhe jo më e madhe se 20% e vlerës totale të detyrimit të njëjël ose titullit të ekzekutuar, ose kombinimit të të dyjave;

b) Mbi 500,000 lekë deri në 90,000,000 lekë nuk mund të jetë më e vogël se 1% dhe jo më e madhe se 10% e vlerës totale të detyrimit të njëjël ose titullit të ekzekutuar, ose kombinimit të të dyjave;

c) Mbi 90,000,000 lekë nuk mund të jetë më e vogël se 1% dhe jo më e madhe se 5% e vlerës totale të detyrimit të njëjël ose titullit të ekzekutuar dhe/ose vendimit të ndërmjetëm të ekzekutuar ose kombinimit të të dyjave, por jo më shumë se 10,000,000 lekë.

4. Tarifa e suksesit paguhet në çdo rast nga kreditori në përfundim të procesit të ekzekutimit ose në përfundim të veprimeve të caktuara, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në kontratën e nënshkruar nga kreditori dhe përmbauesi gjyqësor shtetëror kur kanë dakordësuar zbatimin e tarifës së suksesit për titullin ekzekutiv në fjalë.

5. Në çdo rast, mbi tarifën e suksesit aplikohet TVSH-ja, e cila llogaritet në momentin e pagesës dhe vetëm për atë pjesë që arkëtohet nga përmbauesi gjyqësor, bazuar në kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshje.

6. Tarifa e suksesit, e përlogaritur dhe e faturuar pjesërisht apo plotësisht nga përmbauesi gjyqësor, paguhet nga kreditori dhe nuk i ngarkohet debitorit.

IV. Tarifa e suksesit e përlogaritur mbi bazën e veprimeve përmbaimore të kryera

1. Vlera e tarifës së suksesit të shërbimit përmbaimor, kur titulli ekzekutiv përmban një detyrim jomonetar dhe të pavlerësueshëm, përlogaritet në varësi të:

a) vendit të ekzekutimit;

b) objektit të ekzekutimit;

c) kohës së kryerjes së veprimit përmbaimor dhe/ose përsëritjes së këtij veprimi përmbaimor.

2. Bazuar në kriteret si më sipër treguar, tarifa e suksesit për veprime përmbaimore të kryera do të jetë një vlerë monetare, e cila nuk mund të jetë më pak se 1,000 (një mijë) lekë dhe jo më shumë se 100,000 (njëqind mijë) lekë.

V. Kombinimi i tarifës së suksesit

1. Pala kreditore dhe subjekti përmbaues mund të bien dakord në përputhje me marrëveshjen “tip” të miratuar me urdhër të ministrit të Drejtësisë, aplikimin e tarifës në mënyrë të kombinuar, mbi vlerën e detyrimit të ekzekutuar, por gjithmonë shumat e tarifës së suksesit të kombinuar nuk duhet të kalojnë shumën që do të aplikohet në aplikimin e secilës metode tarifimi më vete.

VI. Ndarja e të ardhurave, kriteret e procedurat e administrimit dhe të shpërndarjes së të ardhurave, mbledhja dhe përdorimi i tyre, bëhet sipas Udhëzimit të Përbashkët nr. 33, datë 29.12.2014, të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë dhe Noterisë”, si dhe kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi.

VII. Ky udhëzim rregullon marrëdhëniet midis palës kreditore dhe subjektit përmbaues, të lindura pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Gazment Bardhi

MINISTRI I FINANCEVE
Helga Vukaj

URDHËR
Nr. 367, datë 6.9.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE MBI VEPRIMET E KANCELARIT NË
RASTIN E KONFIRMIMIT APO ARKIVIMIT TË URDHËRIT TË EKZEKUTIMIT⁹**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, të nenit 7 pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe neneve 310/1, 466/1 dhe 511/1 të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

URDHËROJ:

1. Titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim nëpërmjet lëshimit të urdhrit të ekzekutimit, i cili për rastet e parashikuara nga shkronjat “a” dhe “b” të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile, lëshohet nga gjykata që ka dhënë vendimin. Në këtë rast, kancelari konfirmon urdhrin e ekzekutimit brenda pesë ditëve nga marrja formë të prerë e vendimit gjyqësor.

2. Kancelari i gjykatës së shkallës së parë brenda 5 ditëve nga mbarimi i afatit të ankimit ndaj një vendimi gjyqësor, verifikon nëse është paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit nga palët në proces.

3. Nëse për vendimin gjyqësor të gjykatës së shkallës së parë, është paraqitur ankim në gjykatën e apelit, kancelari nuk kryen asnjë veprim mbi kopjen e urdhrit të ekzekutimit.

4. Nëse për vendimin gjyqësor të gjykatës së shkallës së parë, nuk është paraqitur ankim në gjykatën e apelit, kancelari verifikon nëse në vendimin gjyqësor është bërë shënimi mbi datën se kur vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë. Nëse në vendimin gjyqësor është bërë shënimi mbi datën se kur vendimi ka marrë formë të prerë, kancelari brenda 5 ditëve nga data kur vendimi ka marrë formë të prerë konfirmon në kopjen e urdhrit të ekzekutimit, që shoqëron vendimin gjyqësor, sipas rregullave të mëposhtme:

- a) vendos shënimin “I EKZEKUTUESHËM NGA DATA ____/____/____”;
- b) vendos gjeneralitetet e tij;
- c) vendos funksionin e tij;
- d) vendos nënshkrimin e tij, si dhe
- dh) vulos me vulën e gjykatës.

Kopja që përmban shënimet e mësipërme merr numrin dhe datën përkatëse dhe konsiderohet urdhër ekzekutimi. Urdhri i ekzekutimit u njoftohet palëve sipas rregullave të parashikuara në kreun IV të titullit VI të pjesës I të Kodit të Procedurës Civile.

5. Nëse vendimi gjyqësor i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar në gjykatën e apelit dhe kjo gjykatë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit, kancelari brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit verifikon nëse në vendimin gjyqësor është bërë shënimi mbi lënien në fuqi nga gjykata e apelit dhe mbi datën se kur vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë. Nëse në vendimin gjyqësor është bërë shënimi mbi lënien në fuqi nga gjykata e apelit dhe datën se kur vendimi ka marrë formë të prerë, kancelari brenda 5 ditëve nga data kur vendimi ka marrë formë të prerë konfirmon në kopjen e urdhrit të ekzekutimit që shoqëron vendimin gjyqësor, sipas rregullave të mëposhtme:

- a) vendos shënimin “I EKZEKUTUESHËM NGA DATA ____/____/____”;
- b) vendos gjeneralitetet e tij;
- c) vendos funksionin e tij;
- d) vendos nënshkrimin e tij, si dhe
- dh) vulos me vulën e gjykatës.

Kopja që përmban shënimet e mësipërme merr numrin dhe datën përkatëse dhe konsiderohet urdhër i ekzekutimit. Urdhri i ekzekutimit u njoftohet palëve, sipas rregullave të parashikuara në kreun IV të titullit VI të pjesës I të Kodit të Procedurës Civile.

⁹ Urdhri nr. 367, datë 6.9.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.155, datë 16 shtator 2013.

6. Vendimi i gjykatës së apelit, i cili ndryshon apo prish një vendim të gjykatës së shkallës së parë, për të cilin duhet të lëshohet urdhër ekzekutimi, sipas pjesë së katërt të këtij Kodi, shoqërohet në çdo rast me urdhrin e ekzekutimit, të nënshkruar nga kryetari i trupit gjykues që ka dhënë vendimin. Urdhri i ekzekutimit dorëzohet në sekretarinë gjyqësore dhe kancelari brenda 5 ditëve konfirmon në kopjen e urdhrit të ekzekutimit që shoqëron vendimin gjyqësor, sipas rregullave të mëposhtme:

- a) vendos shënimin “I EKZEKUTUESHËM NGA DATA ____/____/____”;
- b) vendos gjeneralitetet e tij;
- c) vendos funksionin e tij;
- d) vendos nënshkrimin e tij; si dhe
- dh) vulos me vulën e gjykatës.

Kopja që përmban shënimet e mësipërme merr numrin dhe datën përkatëse dhe konsiderohet urdhër ekzekutimi. Urdhri i ekzekutimit u njoftohet palëve, sipas rregullave të parashikuara në kreun IV të titullit VI të pjesës I të Kodit të Procedurës Civile.

7. Kancelari i gjykatës së apelit njëkohësisht me palët, për urdhrin e ekzekutimit sipas pikës 6 të këtij urdhri, njofton edhe gjykatën e shkallës së parë që ka dhënë vendimin e ndryshuar apo të prishur. Kancelari i gjykatës së shkallës së parë brenda 5 ditëve nga marrja e këtij njoftimi, urdhëron arkivimin nëpërmjet një shënimi të posaçëm në kopjen e urdhrit të ekzekutimit, sipas rregullave të mëposhtme:

- a) vendos shënimin “AKT I ARKIVUAR-NDRYSHUAR/PRISHUR ME VENDIMIN GJYQËSOR TË GJYKATËS SË APELIT_____, NR.____DATE____”.
- b) vendos gjeneralitetet e tij;
- c) vendos funksionin e tij;
- d) vendos nënshkrimin e tij;
- dh) vendos datën e arkivimit; si dhe
- e) vulos me vulën e gjykatës.

8. Vetëm urdhri i ekzekutimit i konfirmuar nga kancelari sipas rregullave të parashikuara në këtë urdhër, bëhet i ekzekutueshëm nga përmbartuesi gjyqësor.

9. Ngarkohen kancelarët e gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit për zbatimin e këtij urdhri.

10. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri.

11. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

PJESA E DYTË
SHËRBIMI PËRMBARIMOR GJYQËSOR PRIVAT

LIGJ

Nr. 10 031, datë 11.12.2008

PËR SHËRBIMIN PËRMBARIMOR GJYQËSOR PRIVAT¹⁰

(Ndryshuar me ligjet nr.10137, datë 11.5.2009, nr.36/2012, datë 29.3.2012, nr.80/2013, datë 14.2.2013, nr. 109/2016, datë 27.10.2016)
(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i ligjit

Ky ligj ka si objekt të përcaktojë mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Privat, kriteret që duhet të përmbushin shtetasit për të ushtruar detyrën e përmbaruesit gjyqësor privat, statusin, masat disiplinore, detyrat, përgjegjësitë, tarifat, si dhe marrëdhëniet me institucionet shtetërore dhe me subjektet e tjera publike dhe private.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për përmbaruesit gjyqësorë privatë, që kryejnë veprimet e tyre procedurale për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, Kodit Civil, akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, si dhe për subjektet e tjera private dhe shtetërore, që përfshihen në procesin e ekzekutimit.

Neni 3

Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor

Shërbimi Përmbarimor në Republikën e Shqipërisë organizohet në Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror, sipas ligjit nr.8730, datë 18.1.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor” dhe në Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat.

Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Privat rregullohet sipas këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore.

Neni 3/1

Kontrolli i respektimit të kriterëve ligjore

(Shtuar me ligjin nr.80/2013, datë 14.2.2013)

Kontrolli për verifikimin e respektimit të kriterëve ligjore nga ana e përmbaruesve gjyqësorë privatë bëhet nga Ministria e Drejtësisë, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, përveç kur parashikohet shprehimisht në këtë ligj, duke garantuar të drejtën për t’u informuar, dëgjuar dhe mbrojtur.

¹⁰ Ligji nr. 10 031, datë 11.12.2008 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 190, datë 31 dhjetor 2008.

Ligji nr.10137, datë 11.5.2009 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 86, datë 12 qershor 2009.

Ligji nr.36/2012, datë 29.3.2012 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 34, datë 13 prill 2012.

Ligji nr. nr.80/2013, datë 14.2.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 31, datë 12 mars 2013.

Ligji nr. 109/2016, datë 27.10.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 229, datë 24 nëntor 2016.

KREU II SHËRBIMI PËRMBARIMOR GJYQËSOR PRIVAT

Neni 4

Subjektet që ushtrojnë shërbimin përmbarimor gjyqësor privat

(Ndryshuar me ligjin nr.10137, datë 11.5.2009)

1. Veprimet përmbarimore kryhen vetëm nga individë, të pajisur me certifikatën e aftësisë profesionale të përmbaruesit gjyqësor privat, dhe nën përgjegjësinë vetjake të tyre. Certifikimi bëhet sipas dispozitave në vijim, të këtij ligji. Përmbaruesi gjyqësor privat ushtron veprimet përmbarimore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Shërbimi përmbarimor mund të ofrohet nëpërmjet një subjekti tregtar, duke respektuar përcaktimet në pikën 1 të këtij neni. Veprimtaria e këtyre subjekteve përfshihet në kategorinë XI.2, të shtojcës së ligjit për licencat. Kjo veprimtari licencohet sipas ligjit për licencat. Dispozitat e këtij ligji për përmbaruesin gjyqësor privat vlejnë edhe për subjektin tregtar të licencuar për aq sa kanë kuptim.

Neni 5

Funksioni publik i Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Privat

Për efekt të këtij ligji, Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Privat është një funksion i pavarur me karakter publik, i cili ushtrohet nga përmbaruesit gjyqësorë privatë dhe shoqëritë përmbaruese private.

Përmbaruesit gjyqësorë privatë ose shoqëritë përmbaruese private, në ushtrimin e funksioneve të tyre, i nënshtrohen zbatimit të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, Kodit Civil dhe ligjeve të tjera për ekzekutimin e titujve ekzekutivë.

Neni 6

Statusi ligjor i përmbaruesit gjyqësor privat

Përmbaruesi gjyqësor privat kryen dhe mban detyrën në emër të tij dhe nën përgjegjësinë vetjake. Vetëm personat e licencuar, sipas kriterëve dhe rregullave të përcaktuara në këtë ligj mund të kryejnë procedura ekzekutimi brenda funksionit të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Privat.

Neni 7

Juridiksioni territorial i Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Privat

Përmbaruesi gjyqësor privat ose shoqëritë përmbaruese private ushtrojnë funksionet e tyre procedurale përmbarimore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 8

Papajtueshmëritë

Përmbaruesi gjyqësor privat nuk mund të ushtrojë funksione publike, të praktikojë profesionin e noterit, avokatit ose çdo profesion tjetër, i cili është i papajtueshëm me ushtrimin e paanshëm të profesionit të tij.

Shoqëritë përmbaruese private duhet të kenë si objekt të veprimtarisë së tyre tregtare vetëm ekzekutimin e titujve ekzekutivë.

Neni 9

Konflikti i interesit

Përmbaruesi gjyqësor privat është i detyruar të mos pranojë kërkesën ose të heqë dorë nga ekzekutimi kur ky ka filluar, nëse ai ka marrë dijeni ose duhet të kishte marrë dijeni për ekzistencën e një shkakut, që tregon një konflikt interesi, kur:

a) ka një interes personal, të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me të apo të afërmit e tij, në çështjen për të cilën kërkohet ose ka filluar ekzekutimi;

b) përmbaruesi gjyqësor privat është kujdestar apo përfaqësues i njëres prej palëve në proces ekzekutimi;

c) ai vetë, bashkëshortja ose të afërmit e tij deri në shkallën e dytë janë në konflikt gjyqësor, në marrëdhënie kredie ose huaje me njërin prej palëve në proces ekzekutimi;

ç) përmbaruesi gjyqësor privat është ortak ose aksionar në një shoqëri tjetër, e cila është palë në proces ekzekutimi;

d) ekziston një arsye serioze dhe e mjaftueshme që tregon një situatë konflikti interesi.

Nëse rrethana të tilla vërtetohen te një ortak, aksionar apo administrator i një shoqërie përmbaruese private, kjo shoqëri është e detyruar që të mos pranojë kërkesën apo të heqë dorë nga ekzekutimi, kur ky ka filluar.

Neni 10

Përgjegjësitë e Ministrit të Drejtësisë

(Ndryshuar shkronja a me ligjin nr.10137, datë 11.5.2009)

Ministri i Drejtësisë ushtron përgjegjësitë e mëposhtme:

a) jep, pezullon ose heq certifikatën e përmbaruesit gjyqësor, privat dhe pezullon ose heq licencën e subjektit tregtar, që ofron shërbimin privat përmbarimor.

b) kontrollon, nëpërmjet strukturave të Ministrisë së Drejtësisë, zbatimin e këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore, lidhur me veprimtarinë e përmbaruesve gjyqësorë privatë;

c) miraton Kodin e Etikës së përmbaruesve gjyqësorë privatë;

ç) fillon procedimin disiplinor ndaj përmbaruesve gjyqësorë privatë dhe, kur është rasti, merr masa disiplinore;

d) miraton komisionin vlerësues për provimin e kualifikimit të përmbaruesve gjyqësorë privatë;

dh) miraton modelin e kontratës, që do të lidhet midis përmbaruesit gjyqësor privat dhe palës së interesuar;

e) përcakton, në bashkëpunim me Ministrin e Financave, tarifat përkatëse për kryerjen e shërbimit të përmbarimit gjyqësor privat;

ë) përcakton një të deleguar në mbledhjet e Këshillit Drejtues pa të drejtë vote;

f) organizon provimin e kualifikimit për përmbarues gjyqësor privat.

KREU III

CERTIFIKIMI DHE REGJISTRIMI

Neni 11

Organi certifikues

Ministri i Drejtësisë është autoriteti shtetëror, i cili i jep certifikatën personave që kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë e tyre si përmbarues gjyqësorë privatë, në përputhje me rregullat funksionale dhe organizative të këtij ligji.

Asnjë person nuk mund të fitojë titullin dhe të ushtrojë funksionin e përmbaruesit gjyqësor privat, pa u pajisur më parë me certifikatën përkatëse nga Ministri i Drejtësisë.

Neni 12

Kushtet për certifikimin e përmbaruesit gjyqësor privat

Një person, që kërkon të certifikohet si përmbarues gjyqësor privat, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) të ketë arsimin e lartë juridik;

ç) të ketë eksperiencë pune 3 vjet si jurist;

d) të ketë kaluar me sukses provimin e kualifikimit si përmbarues gjyqësor privat;

dh) të mos të jetë i dënuar për kryerjen e një vepre penale, me vendim të formës së prerë.

Neni 13

Provimi i kualifikimit

Provimi i kualifikimit, për ushtrimin e veprimtarisë si përmbaues gjyqësor privat, zhvillohet para një komisioni të caktuar nga Ministri i Drejtësisë.

Përbërja e komisionit, rregullat për funksionimin e tij, modalitetet, procedurat dhe mënyra e zhvillimit të provimit, si dhe tematika e provimit përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

Neni 14

Përfshirja nga detyrimi i dhënies së provimit të kualifikimit

(Ndryshuar me ligjin nr.36/2012 datë 29.3.2012)

Përfshihen nga detyrimi për të dhënë provimin e kualifikimit personat që në datën 30.12.2011 kanë qenë përmbaues gjyqësorë në Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor.

Neni 15

Marrja e certifikatës dhe regjistrimi

Pas zhvillimit të provimit të kualifikimit, lista e kandidatëve fitues shpallet publikisht në mjediset e Ministrisë së Drejtësisë.

Pas shpalljes së listës, kandidatët fitues regjistrohen, me kërkesën e tyre, në regjistrin e përmbauesve gjyqësorë privatë dhe pajisen me certifikatën përkatëse.

Neni 16

Regjistrimi i shoqërive përmbauese private

(Shfuqizuar me ligjin nr.10137, datë 11.5.2009)

Neni 17

Njoftimi i ndryshimit të vendit të ushtrimit të veprimtarisë

Kur përmbauesi gjyqësor privat apo shoqëritë përmbauese private ndryshojnë të dhënat, sipas nenit 19 të këtij ligji, duhet të njoftojnë menjëherë shkresërisht Ministrinë e Drejtësisë.

Struktura përgjegjëse pranë Ministrisë së Drejtësisë duhet të pasqyrojë ndryshimet përkatëse në regjistrë.

Neni 18

Betimi i përmbauesit gjyqësor privat

Përmbauesi gjyqësor privat, para se të fillojë detyrën e tij, betohet përpara Ministrit të Drejtësisë apo personit të autorizuar prej tij, sipas formulës:

“Betohem se detyrat e përmbauesit gjyqësor privat do t'i kryej në përputhje me ligjin, duke i qëndruar besnik Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, do të ruaj sekretin profesional dhe gjatë veprimtarisë sime do të udhëhiqem nga parimet e profesionalizmit, paanësisë dhe respektimit të të drejtave të njeriut”.

Neni 19

Regjistri i përmbauesve gjyqësorë privatë

(Shfuqizuar pjesërisht me ligjin nr.10137, datë 11.5.2009)

Regjistri i përmbauesve gjyqësorë privatë krijohet pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Ky regjistër ndahet në dy pjesë.

Në pjesën e parë regjistrohen të dhënat e personave fizikë si më poshtë:

- a) identiteti;
- b) vendbanimi;
- c) numri i licencës;
- ç) data e fillimit të veprimtarisë përmbarimore;
- d) adresa e vendit, ku zhvillon veprimtarinë përmbarimore.

Neni 20

Punësimi i përmbaruesve gjyqësorë të pacertifikuar

Shoqëritë përmbaruese private dhe përmbaruesit gjyqësorë privatë nuk do të caktojnë apo autorizojnë asnjë person, që të veprojë në emër të tyre në një procedurë ekzekutimi, në rast se ky nuk është i certifikuar sipas këtij ligji, apo i është hequr certifikata.

KREU IV ÇREGJISTRIMI

Neni 21

Çregjistrimi nga regjistri i profesionit të përmbaruesit gjyqësor privat *(Shfuqizuar shkronja ç me ligjin nr.10137, datë 11.5.2009)*

Përmbaruesit gjyqësor i hiqet certifikata dhe çregjistrohet nga regjistri në rastet kur:

- a) heq dorë me kërkesën e tij nga ushtrimi i profesionit të përmbaruesit gjyqësor privat;
- b) humbet apo i kufizohet zotësia për të vepruar;
- c) dënohet penalisht me një vendim të formës së prerë të gjykatës;
- ç) shfuqizuar
- d) ndaj tij jepet masa disiplinore e heqjes së licencës;
- dh) nuk paraqet kërkesë për rifillimin e veprimtarisë, në rast se certifikata është pezulluar.

Neni 22

Pezullimi i veprimtarisë përmbarimore

Kur përmbaruesi gjyqësor privat emërohet apo zgjidhet në detyra shtetërore, administrative, publike, me kërkesën e tij, apo me nismën e Ministrit të Drejtësisë, certifikata për ushtrimin e veprimtarisë pezullohet për aq kohë sa zgjat detyra.

Për rifillimin e veprimtarisë përmbarimore, subjekti fizik i drejtohet Zyrës së Regjistrimit të përmbaruesve gjyqësorë privatë, e cila, me miratimin e Ministrit të Drejtësisë, brenda 5 ditëve kryen veprimet përkatëse.

Kur me kalimin e një viti nga mbarimi i detyrës, subjekti fizik nuk paraqet kërkesë për rifillimin e veprimtarisë, ai çregjistrohet nga regjistri i profesionit të përmbaruesit gjyqësor privat.

KREU V ORGANET DREJTUESE DHE KOMPETENCAT E DHOMËS KOMBËTARE TË PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

Neni 23

Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë

Përmbaruesit gjyqësorë privatë organizohen në shkallë vendi, nëpërmjet përfaqësimit profesional në Dhomën Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë.

Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë është person juridik, që ushtron veprimtarinë e saj në mënyrë të pavarur nga shteti.

Neni 24 Anëtarësimi

Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë përbëhet nga përmbaruesit gjyqësorë, të cilët janë pajisur me certifikatë nga Ministri i Drejtësisë.

Neni 25

Detyrat e Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë

Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë ka kompetencat e mëposhtme:

- a) siguron zbatimin e kriterëve profesionale dhe etike, me të cilat duhet të veprojnë përmbaruesit gjyqësorë privatë, gjatë ushtrimit të funksionit të tyre;
- b) nxjerr direktiva, lidhur me funksionimin e veprimtarisë së përmbaruesve gjyqësorë privatë;
- c) mbikëqyr ushtrimin e profesionit të përmbaruesit gjyqësor privatë;
- ç) zgjedh organet drejtuese të Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë;
- d) harton modelin e kontratës, që do të lidhet midis përmbaruesit gjyqësor privatë dhe palës së interesuar, përpara fillimit të procedurave të ekzekutimit;
- dh) cakton kuotat, që duhet të derdhin përmbaruesit gjyqësorë privatë në llogarinë e Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë;
- e) përfaqëson Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat në marrëdhënie me Ministrinë e Drejtësisë, organet e tjera të administratës shtetërore, organizmat ndërkombëtarë dhe palët e treta.

Neni 26

Organet drejtuese të Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë

Organet drejtuese të Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë janë asambleja e përgjithshme dhe këshilli drejtues.

Neni 27

Asambleja e përgjithshme

Organi më i lartë i përfaqësimit dhe vendimmarrjes së Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë është asambleja e përgjithshme.

Asambleja e përgjithshme përbëhet nga të gjithë përmbaruesit gjyqësorë privat, që janë të pajisur me certifikatë.

Mbledhjet e asamblesë së përgjithshme organizohen kur janë të pranishëm jo më pak se 1/2 e përmbaruesve gjyqësorë privatë.

Neni 28

Kompetencat e asamblesë së përgjithshme

Asambleja e përgjithshme ka këto kompetenca:

- a) zgjedh këshillin drejtues të përmbaruesve gjyqësorë privatë, kryetarin, nënkryetarin dhe sekretarin e përgjithshëm;
- b) miraton çdo vit buxhetin e Dhomës së Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë;
- c) miraton statutin e ushtrimit të veprimtarisë së përmbaruesit gjyqësor privat;
- ç) miraton rregulloren e organizimit të mbledhjeve dhe rregulloren e zgjedhjes së anëtarëve të këshillit drejtues;
- d) miraton Statutin e Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë;
- dh) çdo akt tjetër që është i nevojshëm për mbarrëvajtjen e veprimtarisë së Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Privat.

Vendimet e asamblesë së përgjithshme merren me shumicë votash.

Neni 29

Këshilli drejtues

Këshilli drejtues përbëhet nga 7 përfaqësues të zgjedhur nga asambleja e përgjithshme.

Neni 30

Kompetencat e këshillit drejtues

Këshilli drejtues ka këto kompetenca:

- a) harton Statutin e Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë;
- b) miraton programet e trajnimit vazhdues të përmbaruesve gjyqësorë privatë;
- c) kujdeset për funksionimin normal të përmbaruesve gjyqësorë privatë si person juridik apo ortakëri ose shoqëri tregtare;

- ç) jep mendime, kur i kërkohet, për projektligje dhe rregullore, që kanë të bëjnë me profesionin e përmbauesit gjyqësor privat;
- d) miraton rregulloren për trajtimin e ankesave dhe për çdo çështje në kompetencë të tij;
- dh) bashkërendon dhe përkrah nismat, që kanë si qëllim përmirësimin dhe ngritjen profesionale;
- e) thërret mbledhjen e asamblesë së përgjithshme;
- ë) bashkëpunon me strukturat drejtuese të Dhomës së Avokatisë dhe Dhomës së Noterisë për probleme, që kanë të bëjnë me çështjet e ekzekutimit.

KREU VI TE DREJTAT, DETYRAT, PËRGJEGJËSITË DHE MBROJTJA E VEÇANTË E PËRMBAUESVE GJYQËSORË PRIVATË TË CERTIFIKUAR

Neni 31

Të drejtat e përmbauesit gjyqësor privat

Përmbauesi gjyqësor privat ka të drejtat e mëposhtme:

- a) të pranojë lirisht kërkesat e subjekteve fizike apo juridike për ekzekutimin e titujve ekzekutivë, me përjashtim të rastit kur konstaton se është në situatën e konfliktit të interesit;
- b) të kërkojë, kur e konsideron të nevojshme për veprimtarinë e tij procedurale, çdo informacion, që ka të bëjë me gjendjen pasurore të debitorit apo vendndodhjen e tij, të nevojshëm për procedurat e ekzekutimit, nga institucione shtetërore, persona juridikë apo fizikë, në përputhje me ligjin;
- c) të ketë mbështetjen e forcave të rendit, kur e çmon të domosdoshme, gjatë procedurave të ekzekutimit;
- ç) të zgjidhë në mënyrë të njëanshme kontratën e lidhur me palën kreditore, kur kjo e fundit nuk përmbush detyrimet e veta;
- d) të aplikojë sanksionet e parashikuara në ligj, ndaj subjekteve fizike apo juridike, që pengojnë në mënyrë të paligjshme procedurën e ekzekutimit, në përputhje me nenin 46 të këtij ligji.

Neni 32

Detyrat e përmbauesit gjyqësor privat

Përmbauesi gjyqësor privat ka këto detyra:

- a) të veprojë me ndershmëri, paanësi, profesionalizëm dhe kurdoherë në interes të palës kërkuese, pa cenuar në mënyrë të paligjshme të drejtat dhe interesat e palës tjetër;
- b) të zbatojë me përpikëri dispozitat e Kodit të Procedurës Civile dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore;
- c) të kryejë për subjektet fizike ose juridike veprimet e nevojshme, që synojnë realizimin e së drejtës së tyre dhe mbrojtjen e interesave të tyre të ligjshëm;
- ç) të informojë për çdo veprim procedural palën në proces ekzekutimi, si dhe të japë sqarimet e nevojshme për veprimet e kryera;
- d) të këshillojë palën kreditore për pasojat juridike, që rrjedhin nga veprimet procedurale, me qëllim që të mos dëmtohen interesat e tyre;
- dh) të ruajë sekretin profesional dhe të mos zbulojë të dhëna, që i kanë mësuar gjatë veprimtarisë së tyre profesionale ose nga dokumentet, që i janë vënë në dispozicion nga palët në proces ekzekutimi, përveç kur dhënia e këtij informacioni është detyrim ligjor;
- e) të sigurojë pranë një shoqërie sigurimi veprimtarinë e tij profesionale;
- ë) të mbajë regjistrin, në përputhje me dokumentacionin standard, të miratuar nga Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë, ku evidentohen të gjitha aktet dhe veprimet procedurale të kryera gjatë veprimtarisë së ekzekutimit;
- f) të derdhë në mënyrë të rregullt detyrimet tatimore;
- g) të marrë masat dhe veprimet e nevojshme për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, në respekt të dinjitetit njerëzor, duke vënë në balancë nevojat e debitorëve dhe interesat e kreditorëve.

Neni 33

Praktika të ndaluara të përmbarduesit gjyqësor privat

Përmbarduesi gjyqësor privat gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, nuk duhet të kryejë veprime që cenojnë, shqetësojnë apo abuzojnë me subjektet, që u nënshtrohen procedurave të ekzekutimit.

Veçanërisht është e ndaluar:

- a) përdorimi i paligjshëm i forcës ndaj subjekteve fizike, që i nënshtrohen ekzekutimit të detyruar apo pasurisë së tyre;
- b) kërcënimi fizik apo presioni psikologjik ndaj subjektit, palë në procedurë ekzekutimi;
- c) përdorimi i fjalëve të pahijshme, që cenojnë reputacionin apo dinjitetin e subjekteve, që i nënshtrohen ekzekutimit të detyruar;
- ç) angazhimi në ndonjë praktikë të ndaluar, ose përdorimi i ndonjë metode të pandershme në mbledhjen e detyrimeve, në kundërshtim me dispozitat ligjore;
- d) çdo veprim tjetër me karakter mashtrues, i cili do të komprometonte rëndë besimin e palëve dhe figurën morale të përmbarduesit gjyqësor privat.

Neni 34

Mbrojtja e veçantë e përmbarduesit gjyqësor privat

Kur përmbarduesi gjyqësor privat, gjatë ushtrimit të detyrës së tij ose për shkak të saj i rrezikohet jeta, familja apo prona, shteti i garanton mbrojtje të veçantë. Kushtet dhe mënyra e përfitimit të kësaj mbrojtjeje përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 35

Publiciteti i veprimtarisë

Përmbarduesi gjyqësor privat mund të reklamojë publikisht veprimtarinë e tij, por pa cenuar konkurrencën e ndershme dhe praktikën e ligjshme tregtare.

Neni 36

Konfidencialiteti

Përmbarduesi gjyqësor privat, i cili merr informacionet gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, ruan fshehtësinë e tyre dhe nuk duhet t'ua japë këto informacione të tretëve, përveç:

- a) organeve të rendit publik, prokurorisë ose gjykatës;
- b) strukturave të tjera shtetërore, lidhur me çështjet pasurore të debitorëve;
- c) përmbarduesve të tjerë, vetëm nëse informacioni është i nevojshëm për procedurat e ekzekutimit;
- ç) kreditorit, i cili ka depozituar për ekzekutim një titull ekzekutiv;
- d) kur personi, për të cilin kërkohet informacioni, jep pëlqimin.

Neni 37

Llogaria bankare e përmbarduesit gjyqësor privat

Përmbarduesi gjyqësor privat duhet të hapë llogari rrjedhëse bankare, të deklaruar dhe të kryejë, gjatë punës së tij, në këtë llogari të gjitha veprimet financiare, që kanë të bëjnë me procedurat e ekzekutimit.

Neni 38

Dorëzimi i dokumentacionit pas çregjistrimit të përmbarduesit gjyqësor privat

Kur përmbarduesi gjyqësor privat çregjistrohet dhe ka në proces ekzekutimi çështje përmbardimore të papërfunduara, ai detyrohet t'i kthejë gjithë dokumentacionin palës së interesuar, si dhe tarifën e parapaguar për veprimet procedurale të papërfunduara prej tij.

Përmbarduesi gjyqësor privat, pas çregjistrimit detyrohet të dorëzojë në Ministrinë e Drejtësisë dokumentacionin e krijuar për çdo veprim procedural, si dhe vulën e tij.

Rregulla të hollësishme për procedurën dhe afatet e dorëzimit të dokumentacionit përcaktohen me udhëzim të Ministrisë së Drejtësisë.

Neni 39

Vula dhe dokumenti i identifikimit

Përmbaruesi gjyqësor privat ka vulën e vet personale, që përmban emrin e tij ose të shoqërisë dhe vendoset në çdo dokument që ai krijon gjatë veprimtarisë së tij profesionale.

Përmbaruesi gjyqësor privat pajiset me dokument identifikues, të cilin e paraqet në çdo rast të ushtrimit të detyrës.

Dokumenti përdoret vetëm gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të saj.

Dokumenti i identifikimit duhet të përmbajë emrin, mbiemrin e përmbaruesit gjyqësor privat, stemën e Republikës së Shqipërisë, logon e Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, selinë ku do të ushtrojë veprimtarinë përmbaruesi gjyqësor privat, institucionin që e lëshon dhe NIPT-in.

Forma dhe përmbajtja e vulës përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

KREU VII

MARRËDHËNIET ME PALËT NË PROCES EKZEKUTIMI DHE ME TË TRETËT

Neni 40

Marrëdhëniet me palën kreditore

Marrëdhëniet ndërmjet përmbaruesit gjyqësor privat dhe palës kreditore rregullohen mbi bazën e kontratës së lidhur mes tyre. Hollësitë, në lidhje me detyrimet reciproke, përcaktohen në kontratën e lidhur mes përmbaruesit gjyqësor privat dhe kreditorit.

Pala kreditore ka të drejtë të kërkojë nga përmbaruesi gjyqësor privat çdo informacion, lidhur me veprimet procedurale dhe ecurinë e procesit të ekzekutimit.

Neni 41

Marrëdhënia kontraktore

Kur marrëdhëniet kontraktore ndërmjet përmbaruesit gjyqësor privat dhe palës kreditore zgjidhen nga përmbaruesi, ai i kthen palës kreditore dokumentacionin ligjor, si dhe pjesën e shumës së marrë si parapagim për procedurën e ekzekutimit.

Kur pala kreditore vendos të zgjidhë kontratën, pa shkaqe të arsyeshme, përpara përfundimit të procedurës së ekzekutimit, përmbaruesi gjyqësor i kthen dokumentacionin ligjor palës kreditore, vetëm në rast të përmbushjes së detyrimit për çdo shpenzim të kryer deri në atë çast.

Neni 42

Vlefshmëria e akteve dhe veprimeve procedurale

Aktet dhe veprimet procedurale të kryera nga përmbaruesi gjyqësor privat, përpara çastit të zgjidhjes së kontratës, konsiderohen ligjërish të vlefshme dhe procesi i mëtejshëm i ekzekutimit nga një përmbarues tjetër gjyqësor privat fillon nga veprimi procedural i mbetur në kohën e ndërprerjes së procesit të ekzekutimit.

Neni 43

Heqja dorë nga procedura e ekzekutimit

Kur përmbaruesi gjyqësor privat vendos të heqë dorë nga vazhdimi i veprimeve procedurale, për shkak të konfliktit të interesit, ai detyrohet të njoftojë 15 ditë përpara palën kreditore. Gjatë kësaj periudhe përmbaruesi gjyqësor privat është i detyruar që të kryejë veprimet procedurale eventuale. Pas kalimit të afatit të sipërpërmendur, përmbaruesi gjyqësor privat i kthen palës kreditore dokumentacionin e lidhur me çështjen, si dhe, kur është rasti, tarifën e parapaguar për procedurën e ekzekutimit.

Neni 44

Marrëdhëniet me palën debitore dhe personin e tretë

Pala debitore, personat e barazuar me të ose personi i tretë detyrohet të lejojë përmbaruesin gjyqësor privat të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme, të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, për ekzekutimin e detyrueshëm.

Me fillimin e veprimeve procedurale debitori, me kërkesën e përmbaruesit gjyqësor privat, është i detyruar të deklarojë mbi pasuritë e tij dhe saktësinë e të dhënave të tyre. Ndaj debitorit, që fsheh apo i jep fiktive të dhënat mbi pasuritë e tij, përmbaruesi gjyqësor privat, në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi, zbaton sanksionet e parashikuara në ligj.

Pala debitore, personat e barazuar me të ose personi i tretë ka të drejtë të kundërshtojë veprimet e përmbaruesit gjyqësor privat në gjykatë, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile. Në këtë rast, përmbaruesi gjyqësor privat thirret në gjykim me cilësinë e palës së paditur.

Neni 45

Përgjegjësitë ndaj palëve në proces ekzekutimi dhe të tretëve

Kur përmbaruesi gjyqësor privat e zhvillon veprimtarinë e tij në kundërshtim me ligjin, mban përgjegjësi për dëmin që u shkakton palëve në proces ekzekutimi, si dhe për dëmin ndaj të tretëve.

Neni 46

Marrëdhëniet me të tretët

Personat fizikë dhe juridikë, privatë dhe shtetërorë, janë të detyruar që t'i japin përmbaruesit gjyqësor privatë të gjithë informacionin e nevojshëm të kërkuar prej tij, lidhur me gjendjen pasurore të debitorit. Ndaj subjekteve fizike apo juridike, që fshehin në mënyrë të qëllimshme të dhënat e kërkuara nga përmbaruesi gjyqësor, ky i fundit është i detyruar të bëjë kallëzim penal, në përputhje me nenin 320 të Kodit Penal.

Në raste të veçanta, përmbaruesi gjyqësor ka të drejtë që të kërkojë ndihmën e Policisë së Shtetit, të institucioneve të tjera shtetërore apo subjekteve private, për të mundësuar procedurat e ekzekutimit. Organet shtetërore ose publike janë të detyruara të ndihmojnë përmbaruesit gjyqësorë privatë në ushtrimin e funksioneve, sipas ligjit, sa herë që kërkohet ndihma e tyre. Ndaj subjekteve fizike ose juridike që, sipas ligjit, janë të detyruara të kryejnë veprime të caktuara, përmbaruesi gjyqësor privat ka të drejtën e zbatimit të sanksioneve të parashikuara në nenin 606 të Kodit të Procedurës Civile.

KREU VIII

TARIFAT

Neni 47

Tarifat fikse të veprimeve përmbarimore

(ndryshuar me ligjin nr. 109/2016, datë 27.10.2016)

Për fillimin e procedurave të ekzekutimit dhe kryerjen e veprimeve procedurale nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Privat, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile, paguhet tarifa fikse.

Masa e tarifës fikse caktohet duke mbajtur në konsideratë vlerën dhe llojin e detyrimit, si dhe kompleksitetin e veprimit procedural përmbarimor.

Masa e tarifës fikse të veprimit përmbarimor, llojet e veprimeve përmbarimore të tarifuara dhe rastet e përjashtimit nga parapagimi i tarifës për kategori të caktuara përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave, pasi merret dhe mendimi i Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë.

Neni 48

Tarifa e suksesit

(ndryshuar me ligjin nr. 109/2016, datë 27.10.2016)

Përmbauesi gjyqësor privat përfiton një tarifë suksesi, e cila mund të jetë në formën e një shume të caktuar, një përqindjeje të caktuar mbi vlerën e detyrimit të vjelë ose titullit të ekzekutuar, ose nëpërmjet kombinimit të të dyjave mbi vlerën e detyrimit të ekzekutuar. Masa e tarifës së suksesit caktohet në marrëveshjen mes kreditorit dhe përmbauesit gjyqësor, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj.

Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave përcaktojnë me udhëzim të përbashkët nivelin minimal dhe maksimal të zbatimit të vlerës së tarifës së suksesit për veprimet përmbaimore. Tarifa e suksesit nuk parapaguhet dhe nuk i ngarkohet debitorit.

Neni 49

Rastet e pakthyeshmërisë së tarifës

Në rastet e ekzekutimeve të pasuksesshme, kur nga përmbauesi gjyqësor privat janë kryer në mënyrë të rregullt dhe të ligjshme të gjitha veprimet procedurale, tarifat e parapaguara janë të pakthyeshme.

Kur pala kreditore ka paguar vetëm tarifën e fillimit të procedurës përmbaimore dhe detyrimi përmbushet në mënyrë vullnetare nga pala debitore, brenda afateve ligjore, tarifa e fillimit të procedurës është e pakthyeshme.

KREU IX

PROCEDIMI DISIPLINOR

Neni 50

Fillimi i procedimit

Të drejtën për të nisur procedimin disiplinor ndaj përmbauesit gjyqësor privatë e ka Ministri i Drejtësisë, me nismën e vet ose sipas ankesës së paraqitur nga palët në proces ekzekutimi.

Procedimi disiplinor kundër përmbauesit gjyqësor privat mund të fillojë kur konstatohen shkelje të detyrës apo veprime të parregullta gjatë ushtrimit të veprimtarisë së përmbauesit gjyqësor privat.

Ankimi administrativ te Ministri i Drejtësisë nuk i heq të drejtën ankuesit që të ndjekë rrugën gjyqësore për të rivendosur të drejtën e tij.

Neni 51

Procedura

Për shqyrtimin e procedimit disiplinor ndaj përmbauesit gjyqësor privat, Ministri i Drejtësisë krijon komisionin disiplinor të përmbauesve gjyqësorë privatë.

Komisioni disiplinor përbëhet nga:

a) Kryetari i Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë, ose një përfaqësues i autorizuar prej tij, në cilësinë e kryetarit;

b) Kryetari i Këshillit Drejtues të Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Privatë, në cilësinë e anëtarit;

c) 1 avokat i caktuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatëve, në cilësinë e anëtarit.

Komisioni disiplinor i përmbauesve gjyqësorë privatë, brenda dhjetë ditëve pune nga dita e konstatimit të shkeljes, fillon procedimin disiplinor dhe njofton përmbauesin gjyqësor privat që ka kryer shkeljen, për t'u paraqitur në seancën dëgjimore në ngarkim të tij.

Komisioni disiplinor i përmbauesve gjyqësorë privatë, pasi ka përfunduar hetimin administrativ dhe vërteton shkeljen e kryer, i paraqet Ministrisë të Drejtësisë raportin përfundimtar, së bashku me propozimin për masën disiplinore.

Mënyra e organizimit, funksionimi dhe masa e shpërblimit për anëtarët e komisionit disiplinor, përcaktohen me urdhër të Ministrisë të Drejtësisë.

Ministri i Drejtësisë, brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së raportit përfundimtar dhe propozimit për masën disiplinore, merr një nga masat disiplinore, të parashikuara në nenin 54 të këtij ligji.

KREU X SHKELJET DHE MASAT DISIPLINORE

Neni 52 **Shkeljet disiplinore**

Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë shkelje disiplinore.

Konsiderohen shkelje nga përmbaruesi gjyqësor privat veprimet ose mosveprimet e mëposhtme:

- a) shkelja në mënyrë të përsëritur e rregullave ligjore e nënligjore, që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë së tij;
- b) mospërmbyllja me faj e veprimeve përmbarimore, që kanë cenuar të drejtën e palëve në proces ekzekutimi;
- c) mosrespektimi i dispozitave të kodit të etikës së përmbaruesit gjyqësor privat;
- ç) shkelja e besimit të palës kontraktuese, nëpërmjet kryerjes së veprimeve korruptive me palën tjetër, për të mos ekzekutuar apo vonuar ekzekutimin e titullit ekzekutiv;
- d) konflikti i interesit në një procedurë ekzekutive;
- dh) mosevidentimi në mënyrë të rregullt i të gjitha akteve dhe veprimeve procedurale të kryera gjatë veprimtarisë së ekzekutimit;
- e) shkelja e kërkesave të këtij ligji për konfidencialitetin, sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave që merr, si rezultat i ushtrimit të veprimtarisë së vet gjatë procedurës së ekzekutimit;
- ë) refuzimi për të mos lejuar strukturat përgjegjëse shtetërore për të ushtruar kontroll ndaj veprimtarisë procedurale të tij.

Neni 53 **Njoftimi i masës disiplinore**

Urdhri për dhënien e masës disiplinore duhet të jetë i arsyetuar dhe i njoftohet të interesuarit me shkrim jo më vonë se 15 ditë nga data e daljes së urdhrit të Ministrit të Drejtësisë.

Neni 54 **Masat disiplinore** *(Ndryshuar paragrafi fundit me ligjin nr.80/2013, datë 14.2.2013)*

Për kryerjen e shkeljeve të parashikuara në nenin 52 të këtij ligji, Ministri i Drejtësisë jep masat disiplinore si më poshtë:

- a) për shkeljen e përcaktuar në shkronjat “a”, “b” dhe “ç” heqje të licencës dhe çregjistrimin nga regjistri;
- b) për shkeljen e përcaktuar në shkronjat “c”, “d” dhe “dh” me gjobë nga 30 000 deri 50 000 lekë;
- c) për shkeljen e përcaktuar në shkronjat “e” dhe “ë” me pezullim të licencës nga tre muaj deri në dy vjet.

Masat disiplinore jepen brenda 6 muajve nga data e konstatimit të shkeljes, por jo më vonë se 3 vjet nga çasti i kryerjes së saj. Në këtë rast parashkrimi i masës fillon pas afateve të përcaktuara.

Masat disiplinore të parashikuara në këtë ligj janë dënime administrative kryesore.

Neni 55 **E drejta e ankimit**

Kundër vendimit të Ministrit të Drejtësisë përmbaruesi gjyqësor privat mund të bëjë ankim në Gjykatën Administrative brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

Vendimi i Ministrit të Drejtësisë, pas kalimit të afatit të ankimit, ose kur lihet në fuqi nga gjykata, evidentohet në regjistrin e përmbaruesve gjyqësorë privatë.

Neni 56
Shlyerja e gjobave

Në rastin e masës disiplinore me gjobë, përmbaruesi gjyqësor privat, brenda 2 muajve, duhet të shlyej masën e gjobës, në të kundërt, ndaj tij zbatohet masa disiplinore e pezullimit të licencës, deri në çastin e shlyerjes së saj.

Përmbaruesi gjyqësor privat, nëse nuk është dakord me masën e gjobës, ka të drejtën e ankimit gjyqësor.

Neni 57
Derdhja e gjobës në Buxhetin e Shtetit

Gjopa e vendosur kundër subjekteve që pengojnë ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë derdhet në Buxhetin e Shtetit.

Dispozitë kalimtare
(parashikuar me ligjin nr.80/2013, datë 14.2.2013)

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Dispozitë kalimtare
(parashikuar me ligjin nr. 109/2016, datë 27.10.2016)

Deri në miratimin e akteve të reja nënligjore do të zbatohen tarifat e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi.

Neni 58
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

UDHËZIM
Nr.4846/33, datë 3.11.2010

**PËR PROCEDURËN DHE AFATET E DORËZIMIT TË DOKUMENTACIONIT
PAS ÇREGJISTRIMIT TË PËRMBARUESIT GJYQËSOR PRIVAT¹¹**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të paragrafit 2 të nenit 7 të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar dhe të nenit 38 të ligjit nr.10 031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Përmbaruesi gjyqësor privat, pas çregjistrimit për një nga shkaqet e përcaktuara në nenin 21 të ligjit nr.10 031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, i ndryshuar, me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, dorëzon në Ministrinë e Drejtësisë dokumentacionin e krijuar për çdo veprim procedural dhe vulën e tij. Në rastin kur përmbaruesi gjyqësor privat i është hequr licenca dhe është çregjistruar për shkak të një dënimi penal të formës së prerë me burgim ose kur humbet zotësinë për të vepruar, dokumentacioni dhe vula dorëzohen nga një person i afërm i tij.

2. Dokumentacioni i krijuar prej përmbaruesit gjyqësor privat të çregjistruar dhe vula e tij i dorëzohen punonjësit të strukturës përgjegjëse të ngarkuar nga Ministri i Drejtësisë në urdhrin e këtij të fundit, të nxjerrë sipas pikës 1 të këtij udhëzimi.

3. Për dorëzimin e dokumentacionit dhe vulës, përmbaruesi gjyqësor privat/personi i afërm, njoftohet me shkrim të paktën 5 ditë përpara për ditën dhe orën, në të cilën duhet të paraqitet në

¹¹ Udhëzimi nr.4846/33, datë 3.11.2010 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.158, datë 1 dhjetor 2010.

Ministrinë e Drejtësisë për të kryer dorëzimin. Së bashku me njoftimin e dërguar nga struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë, përmbaruesit gjyqësor privat/personit të afërm i përcillet edhe një kopje e urdhrat të Ministrit të Drejtësisë. Ky njoftim i dërgohet njëkohësisht edhe Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, e cila merr masat për njoftimin e përmbaruesit/personit të afërm.

4. Në qoftë se përmbaruesi gjyqësor privat/personi i afërm nuk paraqitet për dorëzimin e dokumentacionit dhe vulës, atij i bëhet edhe një njoftim i dytë, në të njëjtën mënyrë si njoftimi i parë.

5. Në rast se edhe pas njoftimeve sipas pikave 3 dhe 4 të këtij udhëzimi, përmbaruesi gjyqësor privat nuk bashkëpunon për dorëzimin e arkivit, atëherë struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë, në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, marrin masat e nevojshme për marrjen në dorëzim të dokumentacionit.

6. Për dorëzimin e dokumentacionit dhe të vulës mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga përmbaruesi gjyqësor privat/personi i afërm dhe nga punonjësi i strukturës përgjegjëse, i ngarkuar nga Ministri i Drejtësisë për të marrë në dorëzim dokumentacionin dhe vulën. Procesverbali hartohet në 3 kopje, prej të cilave një kopje mbahet në Ministrinë e Drejtësisë, një nga përmbaruesit gjyqësor privat/personi i afërm dhe një kopje i dërgohet për dijeni Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë.

7. Pas dorëzimit të dokumentacionit dhe vulës, struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë, bën shënimet përkatëse në regjistrin e përmbaruesve gjyqësorë privatë, në kolonat e emërtuara “Arkiva e përmbaruesit privat” dhe “Marrja e vulave dhe asgjësimi i tyre”, sipas përcaktimeve të urdhrat të Ministrit të Drejtësisë me nr.4864/26, datë 8.10.2010.

8. Struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë, në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë marrin masat për kalimin e arkivës së përmbaruesit të çregjistruar një përmbaruesi tjetër.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Bujar Nishani

UDHËZIM I PËRBASHKËT **Nr. 1665/1, datë 5.3.2014**

PËR CAKTIMIN E TARIFAVE PËRMBARIMORE PËR SHËRBBIMET E OFRUARA NGA SHËRBBIMI PËRMBARIMOR GJYQËSOR PRIVAT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 10, shkronja “e”, të nenit 47, të nenit 48 dhe të nenit 49 të ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, të ndryshuar, ministri i Financave dhe ministri i Drejtësisë

UDHËZOJNË:

I. Objekti

Ky udhëzim përcakton llojet e shërbimeve përmbarimore të tarifuara dhe masën e tarifës së subjekteve përmbaruese private gjatë procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm.

II. Përkufizime

Për qëllime të këtij udhëzimi, me termat e mëposhtëm do të kuptohet:

1. “Tarifa bazë” është tarifa fikse që i paguhet subjektit përmbarimor për kryerjen e shërbimeve procedurale në përputhje me kontratën midis palëve dhe në përputhje me normat e tarifave të përcaktuara në pikën 1 ose 2 të kreut IX të këtij udhëzimi, për sa u përket padive me vlerë deri në 6.000.000 lekë.

2. “Tarifa e shërbimit” është tarifa që i paguhet subjektit përmbarimor bazuar në kryerjen e shërbimeve procedurale në përputhje me kontratën midis palëve dhe në përputhje me tabelën e tarifave, të përcaktuar në shkronjën “a” të pikës 2 të kreut 5 dhe pikës 3 të kreut 9 të këtij udhëzimi, për sa u përket padive me vlerë më të madhe se 6.000.000 lekë.

3. “Tarifa e suksesit” është tarifa që i paguhet subjektit përbarimor për padi me vlerë më të madhe se 6.000.000 lekë, me kusht mbledhjen nga subjekti përbarimor për llogari të kreditorit të të ardhurave (*cash*) apo edhe çdo procedurë tjetër të suksesshme, e përcaktuar si e tillë nga palët në kontratën përkatëse, dhe e cila mund të jetë në formën e një shume të caktuar, një përqindje të caktuar mbi vlerën e padisë, ose nëpërmjet një formule të kombinuar të të dyjave, por brenda limiteve të përcaktuara në pikën 3 të kreut IX të këtij udhëzimi.

4. “Shpenzimet përbarimore” janë shpenzimet e kryera nga subjekti përbarimor gjatë kryerjes së shërbimeve përbarimore në përputhje me kontratën ndërmjet subjektit përbarimor dhe kreditorit.

Shpenzimet përbarimore ndahen në shpenzime që mbulohen nga tarifa përbarimore dhe shpenzime që nuk mbulohen nga kjo tarifë.

4.1 Shpenzimet përbarimore që mbulohen nga tarifa përbarimore janë:

a) shpenzimet ligjore në lidhje me procedurat gjyqësore gjatë procesit të ekzekutimit të detyrueshëm.

4.2 Shpenzimet përbarimore, që nuk mbulohen nga tarifa përbarimore, janë shpenzimet që përcakton neni 525 i Kodit të Procedurës Civile dhe që përbëhen nga shpenzimet e nevojshme për kryerjen e procedurës përbarimore për ekzekutimin e një titulli ekzekutiv, duke përfshirë:

a) shpenzimet për administrimin e të dhënave të nevojshme për kryerjen e procedurave të ekzekutimit;

b) shpenzimet për korrespondencën në lidhje me procedurën përbarimore;

c) shpenzimet në lidhje me transportin, magazinimin, ruajtjen e sendeve të sekuestruara dhe shpenzime të tjera në lidhje me ruajtjen e pasurisë;

d) shpenzimet në lidhje me hapjen, inventarizimin, mbylljen, lëvizjen, prishjen dhe pastrimin e ambienteve ose subjekteve të tjera në proces ekzekutimi;

e) shpenzimet në lidhje me praninë e detyruar të debitorit;

f) shpenzimet e organizimit të ankandit, duke përfshirë shpenzimet në lidhje me pagesën e çmimit të blerjes;

g) shpenzimet e menaxhimit të zyrës së subjektit përbarimor.

III. Shpërblimi i subjekteve përbaruese

1. Tarifa vihet për një veprim procedural të një subjekti përbarimor.

2. Subjekti përbarimor ka të drejtë të vendosë një tarifë në masën dhe sipas procedurës së parashikuar në këtë akt.

IV. Subjekti përgjegjës për pagimin e tarifës dhe shpenzimeve përbarimore

1. Tarifa përbarimore dhe shpenzimet përbarimore përbëjnë detyrim për t’u paguar nga debitori, ndaj të cilit ka filluar procedura e ekzekutimit dhe i ngarkohen atij (debitorit) në përfundim të procesit të ekzekutimit. Debitori solidar është në mënyrë solidare përgjegjës për pagesën e tarifës së subjektit përbarues.

2. Tarifat dhe shpenzimet përbarimore përballohen nga kreditori deri në përfundim të procesit të ekzekutimit. Në rast të ekzekutimit të pasuksesshëm, tarifa dhe shpenzimet përbarimore paguhet nga kreditori dhe i njihen atij si shpenzime të zbritshme, por mbeten përfundimisht detyrim i debitorit.

3. Transferimi i një çështjeje përbarimore nga një subjekt përbarimor te një tjetër nuk kërkon kryerjen e pagesave të tarifës bazë nga debitori, nëse subjekti përbarimor që e transferon çështjen e ka marrë pagesën e kësaj tarife.

V. Pagesa fillestare e tarifës dhe e shpenzimeve përbarimore nga kreditori

1. Tarifa bazë përbarimore për paditë deri në vlerën 6.000.000 lekë paguhet fillimisht nga kreditori në mënyrën si më poshtë:

a) parapagim 20.000 lekë;

b) diferenca e shumës së tarifës me shumën e parapaguar do të paguhet pas njoftimit për kalimin në ekzekutim të detyrueshëm, vendosjes së sekuestros mbi pasuritë e të gjitha palëve debitoare në kontratë (dorëzanës, palë të treta... etj.). Kreditori dhe subjekti përbarues mund të vendosin ta

paguajnë diferencën e tarifës sipas kësaj pike të udhëzimit, të plotë ose me pagesa të pjesëshme sipas afateve të rena dakord mes palëve me marrëveshje. Përveç rasteve kur bihet dakord ndryshe, pagesa e diferencës bëhet pas dorëzimit nga subjekti përmbartimor i dokumentacionit të kënaqshëm për kreditorin, që të justifikojë pagesën në përputhje me kushtet në kontratën midis palëve.

2. Tarifa përmbartimore për paditë mbi vlerën 6.000.000 lekë përbëhet nga tarifa për shërbim/veprime përmbartimore dhe tarifa e suksesit, të cilat paguhen si më poshtë:

a) Tarifa për shërbim/veprim përmbartimor do të paguhet mbi bazën e kryerjes së veprimeve procedurale përmbartimore nga ana e subjekteve përmbartimore sipas tabelës së mëposhtme.

Tabela e tarifave për shërbim sipas veprimeve përmbartimore

Nr.	Lloji i shërbimit	Vlera e shërbimit
1.	Njoftimi për ekzekutim vullnetar	20.000 lekë
2.	Njoftimi për kalimin në ekzekutim të detyrueshëm, vendosja e sekuestros mbi pasuritë e të gjitha palëve debitoare në kontratë (dorëzanës, palë të treta... etj.) ¹²	15.000 lekë për njoftim/sekuestro, por jo më shumë se 100.000 lekë
3.	Njoftimi për arritjen e marrëveshjes së palëve për vlerën e tregut të pasurive të sekuestruara	15.000 lekë për çdo njoftim
4.	Njoftimi për caktimin e një eksperti vlerësues	15.000 lekë për çdo njoftim
5.	Njoftimi i aktit të ekspertimit	15.000 lekë për çdo njoftim
6.	Njoftimi dhe organizimi i ankandit të parë	50.000 lekë
7.	Njoftimi dhe organizimi i ankandit të dytë	50.000 lekë
8.	Vendimi për shpallje fituesi/ofrimi i sendit, për vendim pezullim dhe çdo vendim tjetër i ndërmjetëm që mund të merret	15.000 lekë
9.	Ndjekja e procedurës për kalimin e pronësisë në ZVRPP	20.000 lekë
10.	Ekzekutimi i barrëve siguruese	30.000 lekë për ekzekutim të një barre siguruese, por jo më shumë se 80.000 lekë
11.	Dorëzimi i kartelave të pasurisë dhe i çelësave të pasurisë së lirë nga posedimi i të tretëve	20.000 lekë

Tarifa për njoftim për ekzekutim vullnetar (pika 1 e tabelës) parapaguhet nga kreditori.

b) Tarifa e suksesit paguhet fillimisht nga kreditori me mbledhjen e suksesshme të detyrimit përkatës apo rezultateve të tjera të suksesshme, siç është rënë dakord midis palëve. Gjithsesi, debitori është përfundimisht përgjegjës për pagesën e kësaj tarife, në përputhje me shkronjën “c”.

c) Kosto tarifash të pagueshme nga debitori. Debitorit i ngarkohen si shpenzim e gjithë shuma e tarifës për veprimet përmbartimore, si dhe pjesa përkatëse e tarifës së suksesit deri në masën e përcaktuar në pikën 3 të kreut IX të këtij udhëzimi.

VI. Parapagimi i tarifës përmbartimore

1. Një tarifë përmbartimore është e parapagueshme vetëm nëse përcaktohet si e tillë në këtë udhëzim.

2. Një subjekt përmbartues është i detyruar të marrë parapagim nga kreditori/kërkuesi përpara procedurës së ekzekutimit, vetëm siç parashikohet në këtë udhëzim. Nëse kreditori/kërkuesi nuk i parapaguan subjektit përmbartues tarifën e përcaktuar si të parapagueshme në këtë udhëzim, atëherë subjekti përmbartues nuk lejohet të fillojë procedurën e ekzekutimit. Në këtë rast, subjekti përmbartues i kthen kreditorit/kërkuesit menjëherë dokumentet ligjore të paraqitura prej tij.

3. Parapagimi nuk kërkohet nga:

a) një person fizik që paraqet për ekzekutim një vendim të marrë gjatë procedimit gjyqësor, ku personi fizik ka qenë plotësisht ose pjesërisht i çliruar nga pagesa për ndihmë juridike ose pagesa e një tarife shtetërore, për shkak të paaftësisë së paguese;

b) një person fizik që paraqet për ekzekutim një vendim të marrë gjatë procedimit penal me të cilin shlyhet një detyrim për kompensim të një dëmi të shkaktuar personit fizik në një vepër penale;

¹² Njoftimi do të konsiderohet një i vetëm edhe pse i dërgohet në të njëjtin moment disa bankave apo ZVRPP-ve.

- c) një person fizik që paraqet për ekzekutim një pretendim për detyrim ushqimor;
- d) për subjektet që me ligj të veçantë nuk detyrohen që të parapaguajnë tarifën përmbartimore.
4. Nëse ka kreditorë të ndryshëm për vënien në ekzekutim të një urdhri ekzekutimi, ata parapaguajnë sipas marrëveshjes reciproke.

VII. Procedura për marrjen dhe kthimin e parapagesës së tarifës për subjektin përmbartues

1. Parapagimi i një tarife të subjektit përmbartues bëhet në llogarinë bankare zyrtare të një subjekti përmbartues. Një subjekt përmbartues i lëshon kreditorit një faturë për parapagesën, që përcakton të dhënat e dokumentit të ekzekutimit dhe emrin e debitorit.

2. Nëse subjekti përmbartues e mbledh tarifën përkatëse nga debitori plotësisht, subjekti përmbartues i kthen kreditorit parapagesën brenda dhjetë ditë pune pas marrjes së tarifës nga debitori.

3. Nëse procedura e ekzekutimit përfundon pa shlyerjen e detyrimit ose debitori ka përmbushur pretendimin në lidhje me kreditorin në përputhje me kërkesat përpara se ai të paraqesë një ankesë te subjekti përmbartues, tarifa e parapaguar nuk i kthehet kreditorit nga subjekti përmbartues, i cili e mban këtë pagesë për mbulimin e kostove të procedurës së ekzekutimit. Kreditori informohet me shkrim nga subjekti përmbartues për arsyet e refuzimit të kthimit të tarifës së parapaguar.

VIII. Tatimi mbi vlerën e shtuar

1. Tatimi mbi vlerën e shtuar i shtohet tarifës së mbledhur nga një subjekt përmbartues privat.
2. Tarifat përmbartimore i nënshtrohen ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar.

IX. Tarifat dhe llogaritja e tyre bazuar në vlerën e padisë

1. Tarifa bazë përmbartimore për ekzekutimin e padive me vlerë deri në një shumë 500.000 lekë bazuar në urdhrin e ekzekutimit llogaritet sipas vlerës së detyrimit dhe normës së tarifës së subjektit përmbartues, të përcaktuar në tabelën e mëposhtme, si dhe parapaguhet në masën siç tregohet në kolonën 3 “Tarifë e parapagushme” të tabelës:

Vlera e padisë për pagesë deri në . . . lekë	Norma e tarifës së subjektit përmbartues në lekë. Tarifa bazë	Tarifë e parapagushme
10 000	6000	5000
20 000	7000	5200
30 000	8000	5300
40 000	9000	5400
50 000	10 000	5500
60 000	11 000	5600
70 000	12 000	5700
80 000	13 000	5800
90 000	14 000	5900
100 000	15 000	6000
150 000	17 000	6500
200 000	18 000	7000
250 000	20 000	7500
300 000	22 000	8000
350 000	24 000	8500
400 000	26 000	9000
450 000	28 000	9500
500 000	30 000	10 000

2. Tarifa bazë përmbartimore për padi me vlerë që kalojnë shumën 500.000 lekë deri në vlerën 6.000.000 lekë, llogaritet si më poshtë:

a) tarifa e subjektit përmbartues për një vlerë padie prej 500.001 deri në 600.000 lekë, është 5.8% e vlerës së padisë;

b) tarifa e subjektit përmbartues për një vlerë padie prej 600.001 deri në 700.000 lekë është 5.6% e vlerës së padisë;

c) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë padie prej 700.001 deri në 800.000 lekë është 5.4% e vlerës së padisë;

d) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë padie prej 800.001 deri në 900.000 lekë është 5.2% e vlerës së padisë;

e) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë padie prej 900.001 deri në 1.000.000 lekë është 5.0% e vlerës së padisë;

f) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë 1.000.001 deri në 2.000.000 lekë është 4.8% e vlerës së padisë;

g) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë padie prej 2.000.001 deri në 4.000.000 lekë është 4.6% e vlerës së padisë;

h) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë padie prej 4.000.001 deri në 6.000.000 lekë është 4.4% e vlerës së padisë;

3. Tarifa përmbaimore për paditë me vlerë që kalojnë shumën 6.000.000 lekë.

Totali i tarifës për shërbime/veprime përmbaimore së bashku me tarifën e suksesit nuk mund të tejkalojnë shumën përkatëse sipas përcaktimeve më poshtë, për efekt të mbajtjes dhe përballimit si kosto nga ana e debitorit:

a) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë padie prej 6.000.001 deri në 8.000.000 lekë është 4.2% e vlerës së padisë;

b) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë prej 8.000.001 deri në 10.000.000 lekë është 4.0% e vlerës së padisë;

c) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë padie prej 10.000.001 deri në 20.000.000 lekë është 3.8% e vlerës së padisë;

d) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë padie prej 20.000.001 deri në 30.000.000 lekë është 3.6% e vlerës së padisë;

e) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë padie prej 30.000.001 deri në 40.000.000 lekë është 3.4% e vlerës së padisë;

f) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë padie prej 40.000.001 deri në 50.000.000 lekë është 3.2% e vlerës së padisë;

g) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë prej 50.000.001 deri në 60.000.000 lekë është 3.0% e vlerës së padisë;

h) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë prej 60.000.001 deri në 70.000.000 lekë është 2.8% e vlerës së padisë;

i) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë prej 70.000.001 deri në 80.000.000 lekë është 2.6% e vlerës së padisë;

k) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë padie prej 80.000.001 deri në 90.000.000 lekë është 2.4% e vlerës së padisë;

l) tarifa e subjektit përmbaues për një padi, vlera e së cilës është më e madhe se 90.000.000 lekë është 2.160.000 lekë + 0.1% për një vlerë që kalon 90.000.000 lekë.

X. Tarifat për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të ndërmjetme

1. Një tarifë për ekzekutimin e një vendimi të ndërmjetëm, për sigurimin e padisë, bazohet në vlerën e padisë dhe paguhet si më poshtë:

a) nëse vlera e padisë është deri në 500 000 lekë, tarifa është një shumë e barabartë me një të katërtën e pagës minimale mujore zyrtare;

b) nëse vlera e padisë është ndërmjet 500 001 dhe 2 000 000 lekë, tarifa është një shumë e barabartë me gjysmën e pagës mujore minimale zyrtare;

c) nëse vlera e padisë është më shumë se 200 000 lekë, tarifa është një shumë e barabartë me pagën minimale zyrtare mujore.

2. Nëse vendimi për sigurimin e një padie ka të bëjë me një pretendim jomonetar ose vlera e padisë nuk është e përcaktuar, në rastin e ekzekutimit të një vendimi me këtë objekt ose të revokimit të tij, tarifa e subjektit përmbaimore është një shumë e barabartë me një të tretën e pagës minimale zyrtare mujore.

3. Nëse një vendim për sigurimin e padisë ka të bëjë me një pretendim monetar dhe jomonetar, normat e tarifave të përshkruara në pikat 1 dhe 2 të këtij kreu merren në total.

4. Në rastin e ekzekutimit të një vendimi për sigurimin e padisë ose me revokimin e tij, tarifat e subjektit përmbarimor paguhet nga personi që ka bërë kërkesë për zbatimin e masës për sigurimin e padisë.

5. Tarifat e subjektit përmbarimor bëhen të arkëtueshme me paraqitjen, në rastin e ekzekutimit të detyruar, të një vendimi për sigurimin e padisë. Nëse një paditës nuk paguan tarifën e subjektit përmbarimor, ky i fundit nuk lejohet të nisë procedime përmbarimore.

XI. Tarifat e pagueshme për kopjen e dokumenteve dhe lëshimin e vërtetimeve

1. Një person, që kërkon lëshimin e një kopjeje, paguan për këtë kopje. Kjo dispozitë nuk zbatohet për një organ administrativ ose pjesëmarrës në procedim që ka të drejtë të marrë një raport mbi kryerjen e një veprimi përmbarimor, nëse ky dokument i lëshohet personit për herë të parë.

2. Tarifa e subjektit përmbarimor për përgatitjen e një kopjeje të një dokumenti është:

a) 20 lekë për një faqe formati A4;

b) 25 lekë për një faqe formati A3.

3. Një subjekt përmbarimor merr një tarifë prej 200 lekësh për lëshimin e një vërtetimi në lidhje me një veprim përmbarimor. Nëse vërtetimi jepet në lidhje me një çështje me objekt detyrim ushqimor, tarifa e subjektit përmbarimor është 60 lekë.

XII. Tarifa shtesë e subjektit përmbarimor

1. Një subjekt përmbarimor ka të drejtë të kërkojë një nga tarifat shtesë, të përcaktuara në këtë kre, mbi bazën dhe në masën e parashikuar në ligjin përmbarimor privat, për veprimet përmbarimore teknikisht, ligjërisht komplekse ose që kërkojnë më shumë kohë se një procedurë e zakonshme, për të kryer veprimet për të cilat palët kanë rënë dakord në kontratë. Tarifa shtesë përcaktohet në formën e një shume të plotë ose tarifë me orë. Tarifa shtesë i shtohet tarifës bazë dhe subjekti përmbarimor ka të drejtën të kërkojë pagesën e kësaj tarife vetëm nëse debitori nuk ka përmbushur detyrimin gjatë afatit të përmbushjes vullnetare dhe subjekti përmbarimor kryen një veprim përmbarimor për të cilën ai ose ajo ka të drejtë të marrë një tarifë shtesë.

2. Përveç kur parashikohet ndryshe me ligj, tarifa shtesë arkëtohet së bashku me tarifën bazë.

3. Tarifa shtesë për veprimet e sekuestrimit

a) Përmbaruesi arkëton një tarifë shtesë në masën 0.1% të vlerës së sendit të sekuestruar për një veprim sekuestrimi të kryer jashtë zyrës së subjektit përmbarimor, sipas procesverbalit të konstatimit, që përbëhet nga sekuestrimi i sendeve të luajtshme në posedim të debitorit ose për një veprim sekuestrimi në lidhje me një send të paluajtshëm.

b) Vendimi që urdhëron pagesën e një tarife shtesë nxirret pas veprimit të sekuestrimit dhe vlerësimit të sendit. Në rastin e një mosmarrëveshjeje në lidhje me sendin e sekuestruar ose çmimin e tij, vendimi që urdhëron pagesën e një tarife shtesë nxirret pas zgjidhjes së mosmarrëveshjes, me kusht që sendi të mbetet i sekuestruar dhe të jetë vlerësuar.

4. Tarifa shtesë për shitjen e sendit të sekuestruar

a) Një subjekt përmbarimor merr një tarifë shtesë në një shumë prej 2% të çmimit të shitjes së sendit, e cila paguhet nga fituesi i ankandit. Ndërsa në rastin kur prona i kalon në pronësi kreditorit në bazë të nenit 577 të Kodit të Procedurës Civile, atëherë kreditori është i detyruar të paguajë 1% të çmimit.

5. Tarifa shtesë në formën e tarifave për orë dhe tarifave për distancë

Në rastin e kryerjes së një veprimi përmbarimor jashtë zyrës së subjektit përmbarimor, të përcaktuar në nënndarjet IX dhe XIII të këtij udhëzimi, subjekti përmbarimor ka të drejtën të kërkojë një tarifë prej 1,000 lekësh, duke filluar nga ora e dytë e veprimit. Detyrimi për pagesën e tarifës shtesë i lëshohet një personi që e ka shkaktuar atë dhe duhet të bëjë pagesën menjëherë pas kryerjes së veprimit përmbarimor. Tarifa shtesë për veprimet në distancë nga selia e përmbaruesit është 10 lekë/km.

6. Krahshë shpenzimeve në lidhje me praninë e detyruar të debitorit, caktimin e përfaqësuesit ligjor të palës debitore, shpenzimet e kryera për veçimin e pjesës takuese të palës debitore dhe shpenzimet

për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë së palës debitore etj., përmbaruesi duhet të marrë edhe një tarifë prej një page mujore.

7. Tarifat shtesë gjatë procedurës përmbarimore

a) Tarifa shtesë për veprimet e mëposhtme përmbarimore:

i) reklamimin e një sendi të luajtshëm;

ii) lirimimin e sendit të paluajtshëm;

iii) administrimin e arkivimit e dosjes përmbarimore;

iv) organizimin e ankandit.

b) Për një veprim të përcaktuar në nënparagrafin “i” të shkronjës “a” të kësaj pike, tarifa shtesë e subjektit përmbarimor është një shumë e barabartë me gjysmën e minimumit zyrtar të pagës mujore.

c) Në rastin e organizimit të një ankandi, tarifa shtesë e subjektit përmbarimor do të jetë një shumë e barabartë me pagën minimale mujore zyrtare. Në rastet e shitjes së pasurisë, tarifa shtesë paguhet nga kreditori ose nga ofertuesi që shpallet fitues në ankand.

d) Tarifa shtesë për lirimimin e sendit të paluajtshëm ose vënien në posedim të sendit të paluajtshëm palës kërkuese është e barabartë me shumën e dy pagave minimale zyrtare mujore.

dh) Për administrimin e arkivimit e dosjes përmbarimore, tarifa shtesë është një shumë e barabartë me një të katërtën e pagës minimale zyrtare mujore.

XIII. Tarifa përmbarimore për ekzekutimin e titullit me objekt detyrimi ushqimor e takim fëmije

1. Tarifa që paguhet për zbatimin e një detyrimi ushqimor është një shumë që përputhet me normën e detyrimit përcaktuar në titullin ekzekutiv. Kjo tarifë arkëtohet së bashku me pagesën e parë mujore. Nëse debitori paguan vetëm një pjesë të detyrimit ushqimor, atëherë arkëtohet një tarifë që është në përpjesëtim me shumën e vjelë nga debitori.

2. Nëse debitori i pezullon pagesat e detyrimit ushqimor, e si rezultat i kësaj kryhen veprime përmbarimore shtesë, me qëllim që të sigurohet përmbushja e mëtejshme e pretendimit, atëherë kërkohej një tarifë shtesë në një shumë që përputhet me gjysmën e vlerës së detyrimit ushqimor.

3. Nëse ka vonesa në pagesat e detyrimit ushqimor dhe është përcaktuar shuma e këtyre prapambetjeve, tarifa për arkëtimin e shumës së borxhit llogaritet sipas tabelës së normës së tarifave.

4. Tarifa që duhet të parapaguajë kreditori në rastin e një takimi me fëmijën është e barabartë me një pagë minimale mujore.

XIV. Udhëzimi i ministrit të Drejtësisë e ministrit të Financave nr. 1240/5, datë 15.9.2009, revokohet.

XV. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi zyrat përmbarimore private që funksionojnë sipas ligjit nr. 10031, datë 11.12.2009 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, i ndryshuar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË

Nasip Naço

MINISTRI I FINANCIVE

Shkëlqim Cani

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 289, datë 19.5.2017

PËR PROCEDURAT E BASHKËPUNIMIT TË PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË ME POLICINË E SHTETIT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të paragrafit 2, të nenit 523 të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të nenit 7, të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të nenit 6, pika 18 dhe nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar dhe neneve 31/c dhe 46 të ligjit nr. 10 031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, i ndryshuar, ministri i Punëve të Brendshme dhe ministri i Drejtësisë,

UDHËZOJNË:

I. Qëllimi i udhëzimit

1. Ky udhëzim ka për qëllim:

a) Të përcaktojë kriteret dhe rregullat e zbatueshme, mbi bazën e të cilave kërkohet dhe jepet ndihma ose mbështetja nga strukturat e Policisë së Shtetit për përmbaruesit gjyqësorë privatë, në ndihmë të përmbushjes së shërbimit publik për kryerjen e veprimeve procedurale në realizimin e një procesi përmbarimor.

b) Të përcaktojë mënyrën e ndihmës dhe mbështetjes së përmbaruesve gjyqësorë privatë nga Policia e Shtetit para, gjatë dhe pas kryerjes së veprimeve përmbarimore në terren, për të siguruar rendin dhe qetësinë publike gjatë procesit të ekzekutimit, duke garantuar shmangien e konflikteve civile gjatë tij, në mbrojtje të jetës dhe dinjitetit të përmbaruesit gjatë ushtrimit të detyrës.

c) Të orientojë në zbatimin e unifikuar të kriterëve ligjorë nga ana e përmbaruesve gjyqësorë privatë, kur kërkojnë mbështetjen e Policisë së Shtetit dhe mënyrën e ofrimit të kësaj mbështetjeje.

d) Të garantojë realizimin e procesit të sekuestrimit të mjeteve motorike nga përmbaruesi gjyqësor privat, nëpërmjet procedurave të bllokimit fizik të tyre nga Policia e Shtetit.

II. Parime mbi identifikimin e nevojës për ndihmë dhe mbështetje nga Policia e Shtetit të përmbaruesit gjyqësor privat dhe bllokimit fizik të mjeteve motorike të sekuestruara prej tij.

1. Nevoja për ndihmë nga Policia e Shtetit do të cilësohet në ato raste, kur përmbaruesi gjyqësor privat çmon se veprimet procedurale përmbarimore nuk mund të kryhen pa mbështetjen, ndihmën dhe prezencën e Policisë së Shtetit, pasi ekzekutimi i tyre paraqet rrezik:

a) për jetën, shëndetin dhe dinjitetin e përmbaruesit gjyqësor privat;

b) të personave të tjerë që do të asistojnë ekzekutimin;

c) për kreditorin.

2. Përmbaruesi gjyqësor privat ka diskrecion të plotë në vlerësimin e nevojës për mbështetje nga strukturat e Policisë së Shtetit gjatë kryerjes së veprimit përmbarimor në terren. Ai vlerëson kur:

a) mund të cenohet rëndë procesi përmbarimor nga pengesa e debitorit;

b) ekziston një pamundësi për kryerjen e një veprimi konkret përmbarimor;

c) mund t'i cenohet jeta, morali dhe integriteti shoqëror.

3. Përmbaruesi gjyqësor privat do të mbështetet dhe ndihmohet nga Policia e Shtetit për sekuestrimin e mjeteve motorike të sekuestruara prej tij, të cilat janë regjistruar më parë si të sekuestruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

III. Subjektet përmbaruese udhëzohen:

1. Në çdo rast, kur përmbaruesi gjyqësor privat vlerëson të nevojshme mbështetjen, prezencën dhe/ose ndihmën e Policisë së Shtetit për kryerjen e një veprimi përmbarimor, ai paraqet “kërkesë” me shkrim sipas formatit të miratuar nga Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, pranë strukturës përgjegjëse të Policisë së Shtetit (komisariat dhe/ose drejtori qarku) e cila mbulon territorin ku banon debitori apo vendin ku do të kryhet veprimi përmbarimor.

2. “Kërkesa” për mbështetje, prezencë ose ndihmë depozitohet pranë strukturës përgjegjëse të Policisë së Shtetit jo më vonë se 3 ditë përpara datës dhe orës së caktuar për kryerjen e veprimit përmbarimor. Ky afat nuk zbatohet, kur përmbaruesi gjyqësor privat ndodhet përballë veprimeve apo rrethanave në kushtet e flagrancës dhe të paparashikuara.

3. “Kërkesa” për mbështetje, prezencë ose ndihmë, dërgohet nga përmbaruesi gjyqësor privat dhe shoqërohet sipas rastit nga dokumentacioni përkatës si më poshtë:

a) fotokopje e dokumentit të identifikimit të përmbaruesit gjyqësor privat;

b) fotokopje e urdhrit të ekzekutimit të lëshuar nga gjykata dhe për ato raste që nuk lëshohet urdhër, dërgohet fotokopje e titullit ekzekutiv.

Kopjet e dokumenteve të cituara në germën “a” dhe “b”, njehsohen me vulën individuale të përmbaruesit gjyqësor privat.

4. Anulimi, ndryshimi i datës dhe/ose orës së “kërkesës” për mbështetje, prezencë ose ndihmë nga

Policia e Shtetit të përmbauesit gjyqësor privat, bëhet vetëm me njoftim paraprak me shkrim të përmbauesit gjyqësor privat, i cili i drejtohet njësisë policore dhe në çdo rast vendoset për dijeni drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit bashkë me kryetarin e Dhomës.

5. “Kërkesa” për bllokimin fizik të mjeteve motorike bëhet nga përmbauesi gjyqësor privat nëçdo rast kur është regjistruar më parë një sekuestro konservative në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor.

6. “Kërkesa” për bllokimin fizik të mjeteve motorike shoqërohet me njoftimin zyrtar të vendosjes së sekuestros konservative mbi dokumentacionin e mjetit nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor.

7. “Kërkesa” për bllokimin fizik të mjeteve motorike kryhet shkresërisht ose elektronikisht nëpërmjet

nënshkrimit elektronik të përmbauesit gjyqësor privat, i cili ofrohet nga infrastruktura e çelësit publik. Lista emërore e përmbauesve gjyqësorë privatë të cilët do të përdorin nënshkrimin elektronik nëpërmjet çelësit publik, saktësohet çdo fillim muaji nga DHKPGJP-ja dhe dërgohet për njohje te drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

8. “Kërkesa” për bllokimin fizik të mjeteve motorike dërgohet në DPP (Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë) dhe një konfirmim zyrtar i regjistrimit të saj në Sistemin e Administrimit Elektronik të Gjobave (E- Gjobave) dhe/ose sistemin TIMS me statusin (Alert), do të merret jo më vonë se 5 ditë nga DTI (Drejtorja e Teknologjisë dhe Informacionit) pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

9. Marrja në dorëzim e dokumentacionit dhe/ose mjetit të sekuestruar nga strukturat e Policisë së Shtetit me kërkesë të përmbauesit gjyqësor privat, kryhet jo më vonë se 72 orë nga njoftimi i tij për bllokimin e tij nga Policia e Shtetit.

10. Në çdo rast, marrja në dorëzim e dokumentacionit dhe/ose mjetit të sekuestruar apo lirimi nga bllokimi fizik kryhet me procesverbal, i cili nënshkruhet dhe vulloset nga përmbauesi gjyqësor privat dhe punonjësi i Policisë së Shtetit i pranishëm.

11. Nëse përmbauesi gjyqësor privat konstaton se strukturat e Policisë së Shtetit, bëhen pengesë për realizimin e procesit përmbauesor nëpërmjet mosrespektimit të kreut III të këtij udhëzimi, menjëherë zbaton sanksionet ligjore të parashikuara, në Kodin e Procedurës Civile dhe në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, duke njoftuar edhe dy ministrat, atë të Drejtësisë dhe të Punëve të Brendshme.

IV. Policia e Shtetit, nëpërmjet strukturave të saj udhëzohet:

1. Të mbështesë në terren dhe të ndihmojë me veprime konkrete, përmbauesin gjyqësor privat, në çdo rast që kërkohet prej tij, pasi administron “kërkesën” me shkrim dhe kopjen e dokumentave sipas pikës 3 të kreut III të këtij udhëzimi.

2. Në çdo rast kur kërkohet mbështetja, ndihma dhe prezenca e saj, Policia e Shtetit merr masat e nevojshme për të garantuar dhe ofruar sigurinë fizike të përmbauesit gjyqësor privat dhe/ose personave që e shoqërojnë atë në ndihmë dhe gjatë kryerjes së veprimit përmbauesor në “ditën, orën dhe vendin” e caktuar për këtë qëllim nëpërmjet kërkesës zyrtare.

3. Policia e Shtetit duhet t’i përgjigjet jo më vonë se 2 ditë nga marrja e kërkesës për mbështetje, ndihmë dhe prezencë ndaj përmbauesit gjyqësor privat, me përjashtim të rasteve kur kërkesa çmohet se paraqet një urgjencë dhe rrezikshmëri të veçantë për jetën e përmbauesit gjyqësor privat. Në këto raste prezenca, ndihma dhe mbështetja duhet të jetë e menjëhershme.

4. Në rastet e pamundësisë funksionale dhe operative, të Policisë së Shtetit për shkaqe madhore apo të një rëndësie të veçantë për të mbështetur, ndihmuar dhe qenë prezentë në ditën dhe kohën e kërkuar nga përmbauesi gjyqësor privat, strukturat e Policisë së Shtetit duhet ta njoftojnë atë me shkrim apo me një mjet tjetër komunikimi (të dhënë si mënyrë alternative komunikimi nga përmbauesi në kërkesën drejtuar policisë), të paktën 12 orë para datës dhe orës së caktuar për ekzekutim, duke argumentuar arsyen e mosbashkëpunimit.

5. Gjatë ekzekutimit të titujve ekzekutivë Policia e Shtetit ka për detyrë të evitojë ndërhyrjet nga të pranishmit, pa lejen e përmbauesit gjyqësor privat dhe të mbrojë jetën dhe dinjitetin e tij, nëse

cenohet përgjatë ushtrimit të detyrës, si dhe merr masa për të parandaluar rastet e shpërdorimit të detyrës nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit, të cilët mund të favorizojnë padrejtësisht ndonjërin nga palët në ekzekutim.

6. Përmbaruesi gjyqësor privat pas kryerjes së veprimit përmbarimor në prezencë të punonjësit të Policisë

së Shtetit, duhet të përpilojë procesverbalin e kryerjes së veprimit përmbarimor i cili nënshkruhet nga palët prezente dhe punonjësi i Policisë së Shtetit. Një kopje e procesverbalit të vulosur me vulën e përmbaruesit gjyqësor privat i dorëzohet punonjësit të Policisë së Shtetit.

7. Të regjistrojë në Sistemin e Administrimit Elektronik të Gjobave (E-Gjobave) dhe/ose sistemin TIMS me statusin (Alert), “kërkesat” për bllokim fizik të dërguara nga subjektet përmbaruese për çdo automjet dhe/ose mjet motorik mbi dokumentacionin e të cilit është regjistruar sekuestro konservative në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor, si dhe të mundësojë shkëmbimin e informacionit me Dhomën Kombëtare nëpërmjet ndërveprimit të platformave elektronike të DHKPGJP-së dhe DPP-së. Rregulla të veçanta të ndërveprimit elektronik dhe komunikimit zyrtar nëpërmjet platformave zyrtare të DHKPGJP-së dhe DPP-së, përcaktohen nga drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë dhe kryetari i Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë.

8. Nëpërmjet njësive rajonale të Policisë Rrugore, gjatë kryerjes së detyrave të patrullave policore, këto

të fundit të kryejnë bllokimin fizik të çdo automjeti dhe/ose mjeti motorik për të dhënat e të cilit përmbaruesi gjyqësor privat ka kërkuar, shkresërisht apo elektronikisht bllokimin fizik të tij, ose kur automjeti dhe/ose mjeti motorik pikaset në qarkullimin e lirë rrugor apo që gjendet në ambiente të parkimit publik ose privat, në rastet kur për të dhënat e të cilit ka njoftime për këto vendndodhje.

9. Në çdo rast të bllokimit fizik të automjeteve dhe/ose mjeteve motorike të kryera nga patrulla rrugore e njësive rajonale të Policisë Rrugore dhe/ose Policia Kufitare, duhet të vendosë menjëherë mjetin e bllokuar në ambientet e komisariateve policore, apo ambienteve të përcaktuara të Policisë së Shtetit për qëllime parkimi të automjeteve të sekuestruara.

10. Njësitë rajonale të Policisë Rrugore dhe/ose Policia Kufitare dhe/ose Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit njoftojnë përmbaruesin gjyqësor privat jo më vonë se 5 ditë nga marrja e njoftimit të kërkesës për bllokim fizik të mjeteve motorike të sekuestruara nga përmbaruesi gjyqësor privat.

11. Për mjetin motorik të bllokuar, njoftohet menjëherë dhe jo më vonë se 24 orë në rrugën e komunikimit zyrtar (adresë elektronike zyrtare, telefon) përmbaruesi gjyqësor privat, i cili brenda 72 orësh duhet të marrë në dorëzim dokumentacionin dhe/ose mjetin e bllokuar dhe të paguajë shpenzimet e kryerjes së bllokimit fizik dhe mbajtjes së automjetit të bllokuar në ambiente të caktuara parkimi nga Policia e Shtetit.

12. Për çdo kërkesë për mbështetje, ndihmë dhe prezencë të kërkuar nga përmbaruesi gjyqësor privat

dhe/ose kërkesë për kryerjen e bllokimit fizik të mjeteve motorike të kërkuara zyrtarisht prej tij, punonjësit apo strukturat e Policisë së Shtetit, nuk mund të paraqesin diskutime apo pretendime lidhur me dokumentacionin apo procedurën e ndjekur nga përmbaruesi gjyqësor privat. Për çdo veprim, apo dyshim të konstatuar në dokumentacionin apo sjelljen e përmbaruesit gjyqësor privat, punonjësi i Policisë së Shtetit përpilon një raport të vlerësimit të shqetësimit të konstatuar të cilin e paraqet menjëherë para drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe kryetarit të Dhomës Kombëtare.

V. Zbatimi i udhëzimit dhe dispozita tranzitore:

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen përmbaruesit gjyqësorë privatë dhe Policia e Shtetit të Republikës së Shqipërisë.

2. Kryetari i Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë dhe drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, respektivisht ngarkohen të njoftojnë dhe orientojnë subjektet që përfaqësojnë për respektimin e këtij udhëzimi.

3. Brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, DPP-ja dhe DHKPGJP-ja marrin masat e nevojshme për plotësimin e infrastrukturës me qëllim zbatimin e pikës 7 të kreut IV të këtij udhëzimi.

MINISTRI I DREJTËSISË
Petrit Vasili

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Fatmir Xhafaj

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 385/6, datë 26.6.2017

**PËR PËRCAKTIMIN E NIVELIT MINIMAL DHE MAKSIMAL TË ZBATIMIT TË
VLERËS SË TARIFËS SË SUKSESIT PËR VEPRIMET PËRMBARIMORE TË
OFRUARA NGA SHËRBIMI PËRMBARIMOR GJYQËSOR PRIVAT¹³**

(Ndryshuar me udhëzimin nr. 31, datë 30.8.2018)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 10, shkronja “e”, të nenit 48 të ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbarrimor gjyqësor privat” të ndryshuar, ministri i Financave dhe ministri i Drejtësisë

UDHËZOJNË

I. Qëllimi i udhëzimit

1. Ministri i Financave dhe ministri i Drejtësisë udhëzojnë si më poshtë subjektet e përfshira në një procedurë të ekzekutimit të vendimit gjyqësor me synimin:

- a) nxitjen e konkurrencës së ndershme dhe efektive në ofrimin e shërbimeve përmbarrimore;
- b) përcaktimin e parimeve për tarifën e suksesit dhe sigurimin e transparencës së llogarive dhe arkëtimit gjatë ofrimit të shërbimit përmbarrimor privat;
- c) përcaktimin e standardeve të cilësisë për ofrimin e shërbimit të suksesshëm, nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit përmbarrimor që ndërmerr veprime të shpejta/cilësore dhe ndan riskun financiar me palën kreditore/kërkuese, duke sjellë rritje të përfitimit ekonomik;
- d) mbrojtjen e interesave të palës kreditore/ kërkuese dhe sigurimi i trajtimit të barabartë të tyre, duke u bazuar në përfitueshmërinë e ndërsjellë;
- e) ndërrëprimin shkaktësor të përfitimit financiar me cilësinë e shërbimit;
- f) gjetjen e balancës ndërmjet mbrojtjes së interesit të palës kreditore në të njëjtën kohë me rritjen e qëndrueshmërisë financiare të ofruesve të shërbimit përmbarrimor privat.

II. Tarifa e suksesit të përlogaritur mbi bazën e shumës së ekzekutuar

1. Kur titulli ekzekutiv përmban një detyrim monetar, pala kreditore dhe subjekti përmbarrues, sipas vullnetit të tyre, mund të parashikojnë në marrëveshje masën e tarifës së suksesit, por në çdo rast kjo tarifë nuk mund të jetë më e vogël se 1% dhe jo më e madhe se 20% e vlerës së ekzekutuar të detyrimit.

Në rast të marrjes pjesë në ekzekutim edhe të kreditorëve të tjerë të po atij debitori, secili prej tyre ka të drejtë të përfaqësojë se cila do të jetë vlera e tarifës së suksesit.

2. Pala kreditore ka detyrimin që të informojë për shumën e ekzekutuar në llogarinë e saj, si dhe t’i paguajë subjektit përmbarrues tarifën e suksesit për shërbimin e arkëtimit të detyrimit monetar të mbledhur, jo më vonë se 30 ditë nga momenti realizimit të arkëtimit të detyrimit monetar. Në rast se

¹³ Udhëzimi i Ministrit të Drejtësisë dhe i Ministrit të Financave nr. 385/6, datë 26.6.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 139, datë 30 qershor 2017.

Udhëzimi i Ministrit të Drejtësisë dhe i Ministrit të Financave nr. 31, datë 30.8.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 132, datë 3.9.2018.

ekzekutimi i shumës së detyrimit monetar kryhet nëpërmjet llogarisë bankare të subjektit përmbaues, pagesa/faturimi i tarifës së suksesit do të bëhet pas kreditimit të kësaj pagese në llogarinë e palës kreditore/kërkuesit.

3. Pala kreditore dhe subjekti përmbaues përcaktojnë vlerën konkrete brenda nivelit minimal dhe maksimal të vlerës së tarifës së suksesit përcaktuar në këtë udhëzim, bazuar në kriteret e mëposhtme, si:

- a) shumën totale të detyrimit;
- b) kohën e ekzekutimit nga ana e subjektit përmbaues;
- c) shpejtësinë e kryerjes së veprimeve përmbaimore, brenda afateve maksimale ligjore;
- d) përcaktimin e veprimeve apo rezultateve alternative që konsiderohen në mënyra të ndryshme si sukses, duke përllogaritur tarifa alternative suksesi;
- e) përcaktimin e nivelit minimal të arkëtimit të detyrimit, që do të konsiderohet si sukses nga palët;
- f) sekuestrimin dhe/ose ekzekutimin e sendeve në pronësi të palës debitore, përveç pasurive të hipotekuara nga pala debitore si mjet për të siguruar ekzekutimin e detyrimit.

4. Masa e tarifës së suksesit është shprehje e vullnetit të palës kreditore dhe përmbauesit gjyqësor dhe përcaktohet me marrëveshje të nënshkruar nga të dyja palët, në momentin e nënshkrimit të kontratës së shërbimit. Marrëveshja me të cilën caktohet tarifa e suksesit, e nënshkruar rregullisht midis kreditorit dhe subjektit përmbaues, bëhet pjesë integrale e kontratës së shërbimit përmbaimore, duke pasur të njëjtën fuqi ligjore me kontratën.

5. Marrëveshja për aplikimin e tarifës së suksesit, që nënshkruhet ndërmjet kreditorit dhe subjektit përmbaues, duhet të nënshkruhet sipas formatit “tip”, miratuar me urdhër të veçantë nga ministri i Drejtësisë.

6. Masa e tarifës së suksesit të përcaktuar në marrëveshjen e nënshkruar midis kreditorit dhe subjektit përmbaues duhet të respektojë nivelin minimal dhe maksimal të aplikimit të saj, sipas përcaktimit në

këtë udhëzim.

7. *Tarifa e suksesit e caktuar në marrëveshje ndërmjet kreditorit dhe përmbauesit gjyqësor privat, kur titulli ekzekutiv përmban një detyrim monetar në vlerë:*

a) *Deri në 500,000 lekë nuk mund të jetë më e vogël se 1% dhe jo më e madhe se 20% e vlerës totale të detyrimit të vjelë ose titullit të ekzekutuar ose kombinimit të të dyjave;*

b) *Mbi 500,000 lekë deri në 90,000,000 lekë nuk mund të jetë më e vogël se 1% dhe jo më e madhe se 10 % e vlerës totale të detyrimit të vjelë ose titullit të ekzekutuar ose kombinimit të të dyjave;*

c) *Mbi 90,000,000 lekë nuk mund të jetë më e vogël se 1% dhe jo më e madhe se 5% e vlerës totale të detyrimit të vjelë ose titullit të ekzekutuar dhe/ose vendimit të ndërmjetëm të ekzekutuar ose kombinimit të të dyjave, por jo më shumë se 10,000,000 lekë.*

8. *Tarifa e suksesit paguhet në çdo rast nga kreditori në përfundim të procesit të ekzekutimit ose në përfundim të veprimeve të caktuara, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në kontratën e nënshkruar nga kreditori dhe përmbauesi gjyqësor privat kur kanë dakordësuar zbatimin e tarifës së suksesit për titullin ekzekutiv në fjalë.*

9. *Në çdo rast, mbi tarifën e suksesit aplikohet TVSH, e cila llogaritet në momentin e pagesës dhe vetëm për atë pjesë që arkëtohet nga përmbauesi gjyqësor, bazuar në kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshje.*

10. *Tarifa e suksesit, e përllogaritur dhe e faturuar pjesërisht apo plotësisht nga përmbauesi gjyqësor, paguhet nga kreditori dhe nuk i ngarkohet debitorit.*

III. Tarifa e Suksesit të përllogaritur mbi bazën e veprimeve përmbaimore të kryera

1. Vlera e tarifës së suksesit të shërbimit përmbaimore, kur titulli ekzekutiv përmban një detyrim jomonetar dhe të pavlerësueshëm, përllogaritet në varësi të:

- a) vendit të ekzekutimit;
- b) objektit të ekzekutimit;
- c) kohës së kryerjes së veprimit përmbaimore dhe/ose përsëritjes së këtij veprimi përmbaimore;

2. *Bazuar në kriteret si më sipër treguar, tarifa e suksesit për veprime përmbaimore të kryera do të jetë një vlerë monetare, e cila nuk mund të jetë më pak se 1,000 (një mijë) lekë dhe jo më shumë se 100, 000 (njëqind mijë) lekë.*

3. Tarifa e suksesit paguhet në çdo rast nga kreditori, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në marrëveshjen e nënshkruar nga kreditori dhe subjekti përmbaues privat.

4. Në çdo rast, *mbi tarifën e suksesit aplikohet TVSH-ja*, e cila llogaritet në momentin e pagesës dhe vetëm për atë pjesë të tarifës së suksesit e cila arkëtohet nga përmbauesi gjyqësor, bazuar në kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshje.

5. Tarifa e suksesit aplikohet vetëm me vullnetin e palëve, të formalizuar në marrëveshje, përlllogaritet dhe faturohet pjesërisht apo plotësisht nga subjekti përmbaues privat, paguhet nga kreditori dhe nuk i ngarkohet debitorit.

IV. Kombinimi i tarifës së suksesit

1. Pala kreditore dhe subjekti përmbaues mund të bien dakord në përputhje me marrëveshjen “tip” të miratuar me urdhër të ministrit të Drejtësisë, aplikimin e tarifës në mënyrë të kombinuar, mbi vlerën e detyrimit të ekzekutuar, por gjithmonë shuma e tarifës së suksesit e kombinuar nuk duhet të kalojë shumën që do të aplikohet në aplikimin e secilës metodë tarifimi më vete.

V. Dispozita kalimtare dhe të fundit

1. Ky udhëzim rregullon marrëdhëniet e lindura midis palës kreditore dhe subjektit përmbaues, të lindura pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Gazment Bardhi

MINISTRI I FINANCIVE
Helga Vukaj

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 385/7, datë 28.6.2017

PËR CAKTIMIN E TARIFAVE PËR SHËRBIMET E OFRUARA NGA SHËRBIMI PËRMBARIMOR GJYQËSOR PRIVAT¹⁴

(Ndryshuar me udhëzimin nr. 30, datë 30.8.2018)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe nenit 47 të ligjit nr. 10 031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbauesor gjyqësor privat”, të ndryshuar, ministri i Financave dhe ministri i Drejtësisë

UDHËZOJNË:

I. Qëllimi i udhëzimit

1. Ministri i Financave dhe ministri i Drejtësisë udhëzojnë si më poshtë subjektet përmbauese në një procedurë të ekzekutimit të titujve ekzekutivë me synimin:

a) përmirësimin e punës në llogaritjen dhe dokumentimin e tarifave dhe shpenzimeve procedurale, që parapaguhet nga pala kreditore/ kërkuese dhe/ose përballohen nga subjekti përmbaues sipas dispozitave ligjore, nënligjore apo tarifave në fuqi;

b) shmangien e problemeve të evidentuara në praktikën e zbatimit të ligjit;

c) garantimin e pagimit të tarifave dhe shpenzimeve procedurale si detyrim i palës debitore ose subjektit ndaj të cilit janë kryer veprime përmbauese nga një subjekt përmbaues;

ç) garantimin e përlllogaritjes dhe pagimin e tarifave dhe shpenzimeve procedurale si detyrim të ekzekutimit të titullit ekzekutiv brenda një afati të arsyeshëm;

e) përcaktimin e çështjeve thelbësore të aspektit financiar, kontraktual dhe fiskal të procedurës së

¹⁴ Udhëzimi i Ministrit të Drejtësisë dhe i Ministrit të Financave nr. 385/7, datë 26.6.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 139, datë 30 qershor 2017.

Udhëzimi i Ministrit të Drejtësisë dhe i Ministrit të Financave nr. 30, datë 30.8.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 132, datë 3.9.2018.

ekzekutimit të titujve ekzekutivë sipas Kodit të Procedurës Civile, duke parashikuar aspektet në lidhje me detyrimet financiare; subjektet që duhet të paguajnë tarifat dhe/ose shpenzimet; kuotat/kuantifikimin e detyrimeve; bazueshmërinë sipas së cilës vendosen detyrimet përkatëse.

II. Parimet e skemës së tarifave dhe shpenzimeve

a) Në përcaktimin e skemës apo përlogaritjes së tarifave reflektohen kostot e shkaktuara, direkt ose në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, në ofrimin e shërbimeve të ekzekutimit të titujve ekzekutivë.

b) Kostot e shërbimeve të ekzekutimit të titujve ekzekutivë duhet të financohen me anë të tarifave fikse të vendosura mbi kërkuesit ose përfituesit e shërbimeve.

c) Skema e tarifave ofron transparencë dhe njëkohësisht eficiencë shërbimi, mbi bazat e kostos dhe përfitueshmërisë së rezultatit të pritsëm.

d) Përlogaritja e shpenzimeve procedurale gjatë ekzekutimit synon mirëpërcaktimin e çdo shume (edhe minimale), me qëllim dhënien e garancive financiare për subjektet përmbarese.

III. Tarifa fikse e shërbimit përmbarimor gjyqësor privat

1. Tarifa fikse është pagesa që arkëton përmbaresi gjyqësor privat për fillimin e procedurave të ekzekutimit dhe kryerjen e të gjitha veprimeve procedurale të parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile,

deri në ekzekutimin përfundimtar të titullit ekzekutiv.

2. *Vlera e tarifës fikse të shërbimit përmbarimor, kur titulli ekzekutiv përmban një detyrim monetar si kthim shume dhe/ose pagim detyrimi, përlogaritet si më poshtë:*

a) *Tabela e tarifave fikse përmbarimore në lek, sipas vlerave të detyrimit:*

Vlera e detyrimit nga ... lekë deri në ... lekë	Tarifa fikse (në lekë mbi vlerën e detyrimit)
1 – 10,000	6,000
10,001 – 20,000	7,000
20,001 – 30,000	8,000
30,001 – 40,000	9,000
40,001 – 50,000	10,000
50,001 – 60,000	11,000
60,001 – 70,000	12,000
70,001 – 80,000	13,000
80,001 – 90,000	14,000
90,001 – 100,000	15,000
100,001 – 150,000	17,000
150,001 – 200,000	18,000
200,001 – 250,000	20,000
250,001 – 300,000	22,000
300,001 – 350,000	24,000
350,001 – 400,000	26,000
400,001 – 450,000	28,000
450,001 – 500,000	30,000

b) *Tabela e tarifave fikse përmbarimore në %, sipas vlerave të detyrimit:*

Vlera e detyrimit nga ... lekë deri në ... lekë	Tarifa fikse (në përqindje mbi vlerën e detyrimit)
500,001 – 2,000,000	5.5%
2,000,001 – 5,000,000	3.85%
5,000,001 – 10,000,000	2.75%
10,000,001 – 30,000,000	2.2%
30,000,001 – 90,000,000	1.65%
Mbi 90,000,000	1.1% Minimumi 1, 485,000 lekë Maksimumi 2, 500,000 lekë

3. *Vlera e tarifës fikse të shërbimit përmbarimor, kur titulli ekzekutiv përmban një detyrim jomonetar dhe të*

pavlerësueshëm, përllogaritet në varësi të objektit të ekzekutimit si më poshtë:

a) Për reklamimin e një sendi të luajtsbëm ose të paluajtsbëm, vlera e tarifës fikse përllogaritet në masën e 1 page bazë minimale mujore.

b) Për lirimin dhe vënien në posedim të një sendi të paluajtsbëm, vlera e tarifës fikse përllogaritet në masën e 2 pagave bazë minimale mujore, kur sendi nuk ka një vlerë monetare të përcaktuar për çmimin e shitjes sipas të dhënave nga regjistri i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtsbme apo sipas vlerësimit të një eksperti të pavarur të caktuar nga gjykata dhe/ose përmbartuesi gjyqësor privat. Në rast se sendi i paluajtsbëm ka një vlerë referuese për çmimin e shitjes së tij sipas të dhënave të zyrtarëve të regjistrimit të pasurive të paluajtsbme apo sipas vlerësimit të ekspertit, atëherë tarifa fikse përllogaritet në përqindje mbi vlerën e sendit, sipas tabelës së treguar në pikën 2 të këtij seksioni.

c) Për vënien në posedim të sendit të luajtsbëm, vlera e tarifës fikse përllogaritet në masën e 1 page bazë minimale mujore kur sendi nuk ka një vlerë të përcaktuar për çmimin e shitjes. Në rast se sendi i luajtsbëm ka një vlerë të përcaktuar për çmimin e shitjes në dokumentacionin e regjistruar apo ka një vlerë të përcaktuar, për të cilën ky send është regjistruar si barrë siguruese, atëherë tarifa fikse do të përllogaritet në përqindje sipas tabelës së parashikuar në pikën 2 të këtij seksioni.

d) Për marrjen e fëmijës dhe lejimin e së drejtës së vizitës, vlera e tarifës fikse përllogaritet në masën e 1 page bazë minimale mujore, ndërsa tarifa fikse që lidhet me ekzekutimin e masës së pensionit ushqimor, është një shumë e plotë që përputhet me normën minimale të detyrimit ushqimor, të përcaktuar me ligj.

e) Për organizimin dhe shitjen e sendit në ankand, vlera e tarifës fikse përllogaritet në masën e 1 page bazë minimale mujore;

f) Për zbatimin e një vendimi gjyqësor ose titulli ekzekutiv me objekt të pavlerësueshëm, nëpërmjet të cilit debitori duhet të përmbushë një detyrim të caktuar, vlera e tarifës fikse përllogaritet në masën e 1 page bazë minimale mujore.

4. Vlera e tarifës fikse të shërbimit përmbartimor, kur titulli ekzekutiv është vendim i gjykatës për sigurimin e padisë, përllogaritet si më poshtë:

a) Nëse vendimi për sigurimin e padisë përmban një detyrim monetar dhe vlera e padisë është deri në 500,000 lekë, tarifa është 1/4 e pagës bazë minimale mujore.

b) Nëse vendimi për sigurimin e padisë përmban një detyrim monetar dhe vlera e padisë është më shumë se 500,000 lekë deri në 2,000,000 lekë, tarifa është 1/2 e pagës bazë minimale mujore.

c) Nëse vendimi për sigurimin e padisë përmban një detyrim monetar dhe vlera e padisë është më shumë se 2,000,000 lekë, tarifa është një shumë e barabartë me 1 pagë bazë minimale mujore.

d) Nëse vendimi për sigurimin e një padie përmban një detyrim jomonetar ose vlera e padisë nuk është e përcaktuar, tarifa e subjektit përmbartimor është një shumë e barabartë me 1/3 e pagës bazë minimale mujore.

4.1 Nëse një vendim për sigurimin e padisë ka të bëjë me një pretendim monetar dhe jomonetar, normat e tarifave përkatëse merren në total.

4.2 Në rastin e ekzekutimit të një vendimi për sigurimin e padisë ose me revokimin e tij, tarifat e subjektit përmbartimor paguhet nga personi që ka kryer kërkesën për zbatimin e masës për sigurimin e padisë.

5. Mbi vlerën e tarifës fikse të përllogaritur nga përmbartuesi gjyqësor sipas pikave 2, 3 dhe 4 të këtij seksioni, aplikohet TVSH-ja, sipas legjislacionit tatimor në fuqi.

6. Tarifa fikse e përllogaritur sipas pikave 2, 3 dhe 4 të këtij seksioni parapaguhet nga kreditori në llogarinë bankare të përmbartuesit gjyqësor privat në momentin e nënshkrimit të kontratës së shërbimit përmbartimor prej subjektit përmbartues dhe në fund të ekzekutimit i ngarkohet debitorit ose personave të barazuar me të.

7. Nëse kreditori/kërkuesi nuk parapaguan vlerën e tarifës fikse, përmbartuesi gjyqësor privat nuk fillon veprimet procedurale për ekzekutimin e titullit ekzekutiv. Në këtë rast, subjekti përmbartues i kthen kreditori/kërkuesit dokumentet ligjore të administruara prej tij, brenda një afati 15-ditor nga momenti kur konstatohet mospërmbushje apo refuzim në kryerjen e pagesës së tarifës fikse përmbartimore. Parapagimi i tarifës fikse përmbartimore nuk kërkohet në rastet kur kreditori është përjashtuar nga dispozitat ligjore që rregullojnë fushën e ekzekutimit të detyrueshëm.

8. Përjashtohen nga parapagimi i tarifës fikse të shërbimit përmbartimor privat:

a) Një person fizik që paraqet për ekzekutim një vendim të marrë gjatë procedimit gjyqësor, ku

personi ka qenë plotësisht ose pjesërisht i çliruar nga pagesa për ndihmë juridike ose pagesa e një tarife shtetërore, për shkak të paaftësisë paguese;

b) Një person fizik që paraqet për ekzekutim një vendim të marrë gjatë procedimit penal me të cilin shlyhet një detyrim për kompensim të një dëmi të shkaktuar personit fizik në një vepër penale;

c) Pala kreditore që paraqet për ekzekutim një vendim përfundimtar të Gjykatës Administrative, sipas legjislacionit në fuqi “Për Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”;

d) Pala kreditore që paraqet për ekzekutim titullin ekzekutiv të “Dënimit me gjobë sipas vendimit për kundërvajtjen administrative”, të nxjerrë në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi “Për kundërvajtjet administrative”.

9. Tarifa fikse e përlllogaritur sipas këtij seksioni, si rregull i ngarkohet palës debitore dhe personave të barazuar me të dhe arkëtohet pas ekzekutimit tërësor të detyrimit që përmban titulli ekzekutiv ose në proporcion me vlerën e detyrimit të ekzekutuar. Përfshirë nga ky rregull zbatohet për rastet e parashikuara nga shkronjat (a)(b)(c) dhe (e) të pikës 3 të këtij seksioni, pasi këto tarifa i ngarkohen një personi të tretë, i cili si kërkues apo përfitues konkret i veprimit të kryer nga përmbartuesi gjyqësor, është i detyruar të paguajë këto tarifa në përputhje me kushtet e parashikuara nga ky udhëzim.

10. *Shfuqizuar.*

11. *Shfuqizuar.*

IV. Shpenzimet e tjera sipas nenit 525 të Kodit të Procedurës Civile:

1. *Shpenzimet e tjera sipas nenit 525 të Kodit të Procedurës Civile përbëhen nga shpenzimet e nevojshme për kryerjen e veprimeve procedurale për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, duke përfshirë: shpenzimet për administrimin e të dhënave të nevojshme për kryerjen e procedurave të ekzekutimit;*

a) *Shpenzimet për korrespondencën në lidhje me procedurën përmbartimore;*

b) *Shpenzimet në lidhje me transportin, magazinimin dhe ruajtjen e sendeve të sekuestruara ose pasurisë së sekuestruar;*

c) *Shpenzimet në lidhje me hapjen, inventarizimin, mbylljen, lëvizjen, prishjen dhe pastrimin e ambienteve ose subjekteve të tjera në proces ekzekutimi;*

d) *Shpenzimet në lidhje me caktimin e përfaqësuesit ligjor të palës debitore, shpenzimet e kryera për veçimin e pjesës takuese të palës debitore dhe shpenzimet për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë së palës debitore;*

e) *Shpenzime në lidhje me publikimin e ankandit;*

f) *Shpenzimet e kryera për dorëzimin e barrës/ve siguruese;*

g) *Shpenzimet e ndihmës ligjore të përdorura nga subjekti përmbartues (brenda tarifave të përcaktuara nga udhëzimi i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Avokatëve), me qëllim zgjidhjen e çështjeve ligjore, me objekt kundërshtim veprimesh përmbartimore dhe pavlefshmëri titulli ekzekutiv. Në rastet kur me vendim gjyqësor të formës së prerë konstatohet pavlefshmëria e veprimeve përmbartimore për shkak zbatimi gabim apo moszbatim të ligjit nga përmbartuesi gjyqësor privat, ky i fundit nuk mund të faturojë shpenzimin te kreditori. Nëse këto shpenzime janë parapaguar nga kreditori, subjekti përmbartues do t’ia rikthejë ato kreditori;*

h) *Shpenzimet për veprimet procedurale pranë Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, sipas tarifave zyrtare të miratuara në zbatim të legjislacionit në fuqi “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.*

2. Shpenzimet e menaxhimit të zyrës së subjektit përmbartues dhe/ose të përmbartuesit gjyqësor privat dhe pagesat e stafit ndihmës të tij, nuk konsiderohen shpenzime të nevojshme sipas nenit 525 të Kodit të Procedurës Civile.

3. Shpenzimet e veprimeve sipas pikës 1 të këtij seksioni i paguhen subjektit që kryen këto veprime për efekt të procesit të ekzekutimit të detyrueshëm. Kur për veprimet e përcaktuara në pikën 1 të këtij seksioni ka tarifa zyrtare të miratuara nga autoritetet publike përgjegjëse, zbatohen nivelet e tarifimit të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore përkatëse. Këto shpenzime përbëjnë detyrim për t’u paguar nga debitori, ndaj të cilit ka filluar procedura e ekzekutimit dhe i ngarkohen atij (debitorit) në përfundim të procesit të ekzekutimit.

4. *Për shpenzimet e parashikuara në pikën 1 të këtij seksioni, subjekti përmbartues lëshon faturë tatimore ndaj palëve kreditore apo debitore, e cila shoqërohet me kopje të dokumenteve të pagesave të lëshuara nga të tretët, dokumente të cilat shërbejnë për të dokumentuar shpenzimet e zbritshme të subjektit përmbartues, sipas legjislacionit në fuqi.*

5. *Shpenzimet përmbartimore të pagueshme nga subjekti përmbartues dhe të kryera në fazën e ekzekutimit të*

detyrueshëm, sipas masës dhe llojeve në zbatim të këtij udhëzimi, përpara përfundimit të ekzekutimit, përsbkruben në një akt përmbledhës, të emërtuar “Procesverbal për shpenzimet procedurale gjatë ekzekutimit”, duke bashkëlidhur faturat përkatëse. Pala debitore së cilës i ngarkohen këto shpenzime, ka të drejtë të njihet dhe të marrë kopje të këtij procesverbali.

V. Tarifat fikse të pagueshme nga personat e tretë

1. Në rastet e shitjes së sendit në ankand, tarifa fikse e organizmit të ankandit në masën prej 2 pagave bazë minimale mujore do të paguhet nga ofertuesi që shpallet fitues në ankand.

2. Në rastet e shitjes së sendit në ankand, tarifa fikse për lirim dhe vënien në posedim të sendit të paluajtshëm apo të luajtshëm, në masën e përcaktuar përkatësisht në shkronjat (b) dhe (c) të pikës 3, të seksionit III të këtij udhëzimi, do të paguhet nga pronari (blerësi) i sendit të paluajtshëm apo të luajtshëm në ankand.

3. Tarifa e subjektit përmbartimor për përgatitjen e një kopije të një dokumenti dhe lëshimin e vërtetimeve sipas kërkesës së çdo të interesuari është:

- a) 10 lekë për një faqe formati A4;
- b) 15 lekë për një faqe formati A3;
- c) 250 lekë për një vërtetim përmbartimor.

4. Tarifave të mësipërme, në momentin e kryerjes së pagesës, u shtohet TVSH-ja sipas legjislacionit tashmë në fuqi.

VI. Për të gjitha tarifat e parashikuara nga ky udhëzim *aplikohet TVSH*. Përveç sa përkufizohet më sipër, debitori solidar është në mënyrë solidare përgjegjës për pagesën e tarifës dhe/ose shpenzimeve të subjektit përmbartues.

VII. Zbatimi i udhëzimit dhe hyrja në fuqi

1. Për procedurat përmbartimore që kanë filluar dhe nuk kanë përfunduar përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, udhëzohen subjektet përmbartuese (persona juridikë apo fizikë) për të:

a) mos kthyer tarifën fikse të paguar nga pala kreditore, për rastet kur tarifa e parapaguar është në vlerë më të madhe se masa e tarifës fikse sipas këtij udhëzimi;

b) mos faturuar tarifën fikse sipas këtij udhëzimi, për rastet kur tarifa e parapaguar nga kreditori është në vlerë më të vogël se masa e tarifës fikse sipas këtij udhëzimi;

c) përlllogaritur dhe faturuar palës debitore tarifën fikse të aplikueshme rast pas rasti, sipas parashikimeve të këtij udhëzimi, kur tarifat përmbartimore nuk janë parapaguar nga kreditori i procesit, për shkaqe të përjashtimit ligjor apo në rastin e pezullimit të procesit në fazën vullnetare të tij;

ç) përlllogaritur dhe faturuar palës debitore të gjitha tarifat fikse të aplikueshme sipas parashikimeve në seksionin III, pika 10 të këtij udhëzimi;

d) përlllogaritur dhe evidentuar në një akt përmbledhës, të emërtuar “Procesverbal për shpenzimet procedurale gjatë ekzekutimit” të gjitha shpenzimet përmbartimore të pagueshme nga subjekti përmbartues dhe të arkëtueshme prej debitorit të dosjes përmbartimore aktive dhe/ose të pezulluar;

e) përlllogaritur dhe faturuar personave të tretë tarifat fikse të pagueshme prej tyre sipas parashikimeve të seksionit V të këtij udhëzimi, nëse në vijimësi të procesit përmbartimor pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi kryhen veprime procedurale të parashikuara në këtë seksion.

2. Për të gjitha procedurat përmbartimore që do të fillohen nga subjektet përmbartimore pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, tarifat fikse dhe shpenzimet përmbartimore do të përlllogariten sipas dispozitave të këtij udhëzimi.

3. Udhëzimi i përbashkët nr. 1240/5, datë 15.9.2009, “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor Privat”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Gazment Bardhi

MINISTRI I FINANCAVE
Helga Vukaj

URDHËR

**PËR FORMËN, PËRMBAJTJEN DHE RREGULLAT E PAJISJES E
ADMINISTRIMIT TË VULAVE TË PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të neneve 15 dhe 39, të ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 390, datë 6.8.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare”,

URDHËROJ:

1. Përmbaruesi gjyqësor privat paraqet kërkesë pranë Ministrisë së Drejtësisë, për pajisjen me vulën e njomë, pas certifikimit nga ministri i Drejtësisë dhe marrjes së aktit administrativ përkatës nga Qendra Kombëtare e Biznesit për ushtrimin e veprimtarisë.

2. Pajisja e përmbaruesve gjyqësorë privatë me vula bëhet nga Ministria e Drejtësisë brenda 30 ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës.

3. Certifikimi si përmbarues gjyqësor privat lëshohet vetëm për individë, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, vula që lëshohet për ta është personale dhe përdoret vetëm nga përmbaruesi gjyqësor privat, si dhe vendoset në çdo dokument që ai krijon gjatë veprimtarisë së tij profesionale.

4. Pavarësisht se shërbimi përmbarimor mund të ofrohet nëpërmjet një subjekti tregtar, vula është personale dhe përdoret vetëm nga përmbaruesi i pajisur me certifikatën e aftësisë profesionale të përmbaruesit gjyqësor privat.

5. Veprimet përmbarimore kryhen vetëm nga individë të pajisur me certifikatën e aftësisë profesionale të përmbaruesit gjyqësor privat dhe nën përgjegjësinë vetjake të tyre.

6. E drejta për të përdorur vulën nuk mund t’u jepet në asnjë rrethanë të tretëve. Në rast se gjatë kontroleve, konstatohet se vula e përmbaruesve gjyqësorë privatë përdoret nga persona të tretë ose nga subjekti tregtar ku përmbaruesi ushtron funksionin, ky fakt përbën shkelje të rëndë në veprimet e tyre procedurale për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, i ndryshuar.

7. Vula e njomë ka formë rrethore, me diametër 35 mm. Brenda saj shkruhen në formë harkore me shkronja kapitale fjalët “REPUBLIKA E SHQIPËRISË” dhe poshtë tyre me shkronja kapitale më të vogla shkruhet në një rresht të dytë emri, shkronja e parë e emrit të babait dhe mbiemri i përmbaruesit gjyqësor privat. Në mes konturohet shqiponja dykrenore dhe poshtë saj, në formë harkore në të kundërt të emrit dhe mbiemrit të përmbaruesit janë shkruar me shkronja kapitale, por në të njëjtën madhësi me ato të emrit, fjalët “PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT”.

8. Ministria e Drejtësisë i paraqet kërkesën për përgatitjen e vulave subjekteve shtetërore të specializuara dhe kur kjo nuk është e mundur subjekteve private shqiptare ose të huaja, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e përgatitjes së vulave me leje të nxjerrë nga organet kompetente. Emrat e tyre miratohen paraprakisht nga ministri i Drejtësisë. Përmbaruesi gjyqësor privat paguan paraprakisht tarifën të subjekti që përgatit vulën.

9. Vulat dorëzohen në Ministrinë e Drejtësisë nga subjekti përgatitës i tyre. Vulat merren në dorëzim me procesverbal, të nënshkruara nga përfaqësuesi/t e përmendur më sipër dhe depozitohen për ruajtje pranë Ministrisë së Drejtësisë. Struktura e Ministrisë së Drejtësisë njofton përmbaruesin që të paraqitet për marrjen në dorëzim të vulës. Për pajisjen me vulë mbahet një procesverbal, i cili nënshkruhet nga personi i autorizuar nga ministri i Drejtësisë dhe nga përmbaruesi gjyqësor privat. Në procesverbal shënohet koha, vendi, emrat e pjesëmarrësve, si dhe fakti i marrjes së vulës në dorëzim nga përmbaruesi privat. Procesverbali hartohet në dy kopje dhe nënshkruhet nga personat e lartpërmendur, ku secili mban një kopje të tij.

10. Institucioneve qendrore më të rëndësishme, si dhe subjekteve të tjera që vlerësohen nga

ministri i Drejtësisë se kanë lidhje të ngushtë me veprimtarinë e përmbauesve gjyqësorë privatë u dërgohet zyrtarisht, për çdo përmbaues gjyqësor privat, një fletë e bardhë e nënshkruar dhe e vulosur me vulën e tij.

11. Në çdo rast, modeli i vulave, emri dhe firma e çdo përmbauesi gjyqësor privat i dërgohet për depozitim e model Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Bankës së Shqipërisë, si dhe bankave të nivelit të dytë, Qendrës Kombëtare të Biznesit, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, prokurorive, gjykatave, si dhe çdo institucioni tjetër publik/privat, me kërkesë të tij.

12. Vulat e përmbauesve gjyqësorë privatë, që nuk e ushtrojnë më detyrën, në përputhje me nenin 21, të ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbaues gjyqësor privat”, i ndryshuar, tërhiqen nga Ministria e Drejtësisë.

13. Përmbauesi, i cili kërkon të pezullojë veprimtarinë e tij dhe që është pajisur me vulë, duhet të dorëzojë për asgjësim në Ministrinë e Drejtësisë vulën e tij. Procesverbali dokumenton dorëzimin dhe asgjësimin, hartohet në dy kopje dhe nënshkruhet nga përfaqësuesit e strukturës së ngarkuar nga ministri i Drejtësisë dhe nga përmbauesi gjyqësor privat, ku secili mban një kopje të tij.

14. Përmbauesi, i cili kërkon të rifillojë veprimtarinë përmbauese, duhet të paraqesë kërkesë, për pajisjen me vulë të re, pranë Ministrisë së Drejtësisë. Në këtë rast, zbatohen rregullat e parashikuara në këtë urdhër për marrjen në dorëzim të vulës.

15. Në rastet e tjera, për asgjësimin e vulës, zbatohen rregullat e parashikuara në pikën 13, të këtij urdhri.

16. Në rastet e përmbauesve gjyqësorë privatë, të cilët janë organizuar si subjekte tregtare/shoqëri përmbauese dhe disponojnë vula vetëm në emër të shoqërisë përmbauese, të marrin masat e nevojshme për dorëzimin e vulave të lëshuara në emrin e shoqërive/subjekte përmbauese dhe të pajisen me vulat personale të lëshuara nga Ministria e Drejtësisë brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri. Me mbarimin e këtij afati, vulat e vjetra deklarohen të pavlefshme. Për asgjësimin e këtyre vulave zbatohen rregullat e parashikuara në pikën 13, të këtij urdhri.

17. Për vulat e deklaruara të pavlefshme dhe të asgjësuara, Ministria e Drejtësisë vë në dijeni institucionet e përcaktuara në pikën 11, të këtij urdhri, se personi nuk e ushtron më veprimtarinë, se ato vula nuk janë më në përdorim dhe se dokumentacioni i paraqitur me vula sipas modelit të treguar, pas datës kur janë asgjësuar vulat, duhet konsideruar i pavërtetë.

18. Kur përmbauesi, i cili është çregjistruar nga regjistri në Ministrinë e Drejtësisë, nuk dorëzon vulën, Ministria e Drejtësisë vë në dijeni institucionet, të cilave u është dërguar modeli i vulës së përmbauesit dhe firma e tij, se personi nuk e ushtron më veprimtarinë, se ato vula nuk janë më në përdorim dhe dokumentacioni i paraqitur me vula sipas modelit të treguar, pas datës kur janë asgjësuar vulat, duhet konsideruar i pavërtetë.

19. Përdorimi i vulave të deklaruara të pavlefshme e bën dokumentacionin përkatës të pavlefshëm dhe përbën shkak për procedim sipas legjislacionit në fuqi.

20. Urdhri nr. 4846/18, datë 20.9.2010, i ministrit të Drejtësisë, “Për formën, përmbajtjen dhe rregullat e pajisjes e administrimit të vulave të përmbauesve gjyqësor privatë”, shfuqizohet.

21. Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë të orientojë përmbauesit gjyqësorë privatë dhe subjektet tregtare/shoqëritë përmbauese të marrin masat e nevojshme për zbatimin e këtij urdhri.

22. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Ministria e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë dhe përmbauesit gjyqësorë privatë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Ylli Manjani

URDHËR

Nr. 4321/4, datë 18.7.2017

**PËR MIRATIMIN E MODELIT TË KONTRATËS QË LIDHET MIDIS
SHOQËRISË PËRMBARIMORE/PËRMBARUESIT GJYQËSOR PRIVAT
DHE PALËS SË INTERESUAR PËRPARA FILLIMIT TË PROCEDURAVE
TË EKZEKUTIMIT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, shkronjës “dh)” të nenit 10, shkronjës “d)” të nenit 25 dhe nenit 40, 47 e 48 të ligjit nr. 10 031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat”, të ndryshuar, udhëzimit të përbashkët nr. 385/6, datë 26.6.2017, të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave “Për përcaktimin e nivelit minimal dhe maksimal të zbatimit të vlerës së tarifës së suksesit për veprimet përbarimore të ofruara nga shërbimi përbarimor gjyqësor privat”, udhëzimit të përbashkët nr. 385/7, datë 28.6.2017, të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përbarimor gjyqësor privat”, si dhe në vijim të propozimit të përcjellë me shkresën me nr. 406 Prot., datë 4.7.2017, të Dhomës Kombëtare të Përbaruesve Gjyqësorë Privatë,

URDHËROJ:

1. Miratimin e modelit të kontratës që lidhet midis shoqërisë përbarimore/ përbaruesit gjyqësor privat dhe palës së interesuar, përpara fillimit të procedurës së ekzekutimit, sipas tekstit të aneksit nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Miratimin e formatit “tip” të marrëveshjes për aplikimin e tarifës së suksesit, që lidhet midis kreditorit dhe shoqërisë përbarimore/ përbaruesit gjyqësor privat, sipas tekstit të aneksit nr. 2, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.

3. Marrëveshja për aplikimin e tarifës së suksesit, pas nënshkrimit nga kreditori dhe subjekti përbarimor, përfshihet si aneks i kontratës së shërbimit për veprimet përbarimore.

4. Marrëdhëniet kontraktore ndërmjet shoqërisë përbarimore/përbaruesit gjyqësor privat dhe palës kreditore rregullohen sipas legjislacionit në fuqi dhe përcaktimeve të të drejtave dhe detyrimeve të parashikuara në kontratën e shërbimit.

5. Urdhri nr. 219, datë 12.1.2016, i ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kontratave “tip” që lidhen midis shoqërive përbarimore/ përbaruesve gjyqësorë privatë dhe palëve të interesuara, përpara fillimit të procedurave të ekzekutimit përbarimor”, shfuqizohet.

6. Ngarkohet Drejtoria e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira, shoqëritë përbarimore/përbaruesit gjyqësorë privatë dhe Dhoma Kombëtare e Përbaruesve Gjyqësorë Privatë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

7. Ngarkohet Sektori i Redaktimit Gjuhësor dhe Arkiv Protokollit për njoftimin e këtij urdhri. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I DREJTËSISË
Gazment Bardhi**

ANEKSI NR. 1

**“MODEL KONTRATE QË LIDHET MIDIS SHOQËRISË PËRMBARIMORE/
PËRMBARUESIT GJYQËSOR PRIVAT DHE PALËS SË INTERESUAR, PËRPARA
FILLIMIT TË PROCEDURËS SË EKZEKUTIMIT”**

KONTRATË SHËRBIMI

Sot, më datë __. __. __, në zyrën e shoqërisë përbarimore/përbaruesit gjyqësor privat_ (emri i shoqërisë përbarimore/përbaruesi gjyqësor privat), pasi kreditori paraqiti kërkesën për vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv:
(sipas nenit 510 të

Kodit të Procedurës Civile, ku përshkruhen të gjitha elementet e titullit ekzekutiv, duke përfshirë llojin e aktit, numrin dhe datën), lidhet kjo kontratë shërbimi midis:

A. Shoqërisë përmbarimore/përmbaruesit gjyqësor privat _____ (emri i shoqërisë përmbarimore/përmbaruesi gjyqësor privat) me certifikatë nr. __, datë __. __. __, me NIPT __ dhe adresë ; adresë elektronike, nr. llogarie

bankare, nr. tel./fax./mob. dhe

B. Kreditorit (për subjektin fizik jepen: emri, atësia, mbiemri, adresa dhe numri i pasaportës/letërnjoftimit, adresë elektronike, nr. llogarie bankare, nr. tel./fax./mob.; ndërsa për personin juridik jepen: emri, NIPT-i, adresa elektronike, nr. i llogarisë bankare; selia, si dhe emri, atësia, mbiemri dhe numri i pasaportës/letërnjoftimit të përfaqësuesit të tij). _____.

BAZA LIGJORE: Lidhja dhe zbatimi i kësaj kontrate bazohet në dispozitat e Kodit Civil, në ligjin nr. 10 031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, i ndryshuar, si dhe në legjislacionin në fuqi në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate. Për përcaktimin e tarifave zbatohet udhëzimi i përbashkët nr. 385/7, datë 28.6.2017, i ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave, “Për përcaktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor gjyqësor privat”.

Palët e mësipërme bien dakord të lidhin midis tyre kontratën si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i kontratës

Kryerja e shërbimit përmbarimor për ekzekutimin e titullit ekzekutiv “_”.

Neni 2

Përkufizime

Fjalët e përdorura në këtë kontratë kanë kuptimin e mëposhtëm:

1. Kreditor është personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate, në cilësinë e kërkuesit të shërbimit përmbarimor gjyqësor privat.

2. Debitor është personi fizik ose juridik që ngarkohet nga titulli ekzekutiv për të kryer një veprim të caktuar në favor të kreditorit.

3. Shërbim përmbarimor nënkupton veprimet procedurale të caktuara nga ligji, që do të kryhen nga shoqëria përmbarimore/përmbaruesi gjyqësor privat për ekzekutimin e titullit ekzekutiv.

4. Tarifat përmbarimore janë tarifatat e përcaktuara nga udhëzimet e përbashkëta të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave. Tarifatat përmbarimore përbëhen nga tarifa fikse të shërbimit përmbarimor gjyqësor privat dhe, sipas rastit, tarifa e suksesit e dakordësuar me marrëveshje të posaçme.

5. Tarifa fikse e shërbimit përmbarimor gjyqësor privat është pagesa që arkëtohet në llogarinë e shoqërisë përmbarimore/përmbaruesit gjyqësor privat për fillimin e procedurave të ekzekutimit dhe kryerjen e veprimeve procedurale të parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile. Ajo paguhet në momentin e nënshkrimit të kontratës nga kërkuesi/kreditori për kryerjen e të gjitha veprimeve procedurale të parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile, deri në ekzekutimin përfundimtar të titullit ekzekutiv.

6. Tarifa e suksesit është pagesa në formën e një shume të caktuar, një përqindje të caktuar mbi vlerën e detyrimit të vjelë ose titullit të ekzekutuar, ose nëpërmjet kombinimit të të dyjave mbi vlerën e detyrimit të ekzekutuar. Ajo arkëtohet në llogarinë e shoqërisë përmbarimore/përmbaruesit gjyqësor privat kur kërkuesi/kreditori ka shprehur vullnetin e tij, që bazuar në shumën totale të detyrimit, kohën e ekzekutimit, shpejtësinë e kryerjes së veprimeve përmbarimore dhe/ose rezultateve alternative të konsideruara si ekzekutim i suksesshëm, dhe llogaritet në momentin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv dhe vetëm për atë pjesë të vlerave të arkëtuara nga përmbaruesi gjyqësor privat apo rezultatit alternativ të konsideruar si sukses. Kjo tarifë paguhet bazuar në kushtet dhe afatet e përcaktuara në një marrëveshje të nënshkruar me

subjektin përmbarues. Tarifa e suksesit paguhet nga kreditori dhe i ngarkohet vetëm atij. Marrëveshja për aplikimin e tarifës së suksesit, e nënshkruar ndërmjet kreditorit dhe subjektit përmbarues sipas formatit “tip”, të miratuar me urdhër të ministrit të Drejtësisë, bëhet pjesë e kësaj kontrate pas nënshkrimit.

7. Shpenzime përmbarimore janë kostot financiare që shërbejnë për të kryer veprime të caktuara përmbarimore dhe përmbajnë shpenzime të nevojshme për kryerjen e veprimeve procedurale për ekzekutimin e titujve ekzekutivë në bazë të nenit 525 të Kodit të Procedurës Civile, të cilat paguhen nga pala që i ka shkaktuar ato, por në veprimtarinë e përditshme paguhet nga kreditori dhe/ose subjekti përmbarues dhe që në fund të ekzekutimit vilen së bashku me detyrimin nga debitori ose personi i barazuar me të.

8. Afatet kohore të ekzekutimit janë tërësia e afateve kohore të parashikuara nga ligji për kryerjen e veprimeve përmbarimore në ekzekutimin e titujve ekzekutivë, të cilat duhet të respektohen nga kreditori dhe subjekti përmbarues.

9. Ekzekutim i pjesshëm nënkupton rastin kur shoqëria përmbarimore/përmbaruesi gjyqësor privat ka arritur të kryejë një pjesë të ekzekutimit të titullit ekzekutiv.

10. Dosja përmbarimore është tërësia e akteve të administruaranga shoqëria përmbarimore/përmbaruesi gjyqësor privat gjatë kryerjes së ekzekutimit të titullit ekzekutiv.

11. Forcë madhore konsiderohet çdo rrethanë me natyrë të përgjithshme dhe të jashtëzakonshme, përtej kontrollit të palëve kontraktuese dhe e pavarur nga vullneti i tyre, e cila nuk mund të parandalohet ose të eliminohet dhe që pengon plotësisht ose pjesërisht zbatimin e detyrimeve kontraktuale.

12. Rast fator konsiderohet çdo rrethanë me karakter individual dhe e jashtëzakonshme, përtej kontrollit të palëve kontraktuese dhe e pavarur nga vullneti i tyre, e cila nuk mund të parandalohet ose të eliminohet dhe që pengon plotësisht ose pjesërisht zbatimin e detyrimeve kontraktuale.

13. Kreditor i përjashtuar nga pagimi është personi që është caktuar si kreditor në titullin ekzekutiv dhe që nuk është i detyruar të paguajë tarifat dhe shpenzimet përmbarimore sipas përkufizimeve të pikave 5, 6 dhe 7 të këtij neni, kur me akt ligjor apo nënligjor është vendosur përjashtimi i tij nga ky detyrim.

Neni 3

Të drejtat e kreditorit

Kreditori ka të drejtë:

1. Të kërkojë informacion në çdo kohë kundrejt kërkesës për informim, lidhur me ecurinë e ekzekutimit të titullit ekzekutiv.

2. Të kërkojë pranë shoqërisë përmbarimore/përmbaruesit gjyqësor privat, në çdo kohë që e vlerëson si të arsyeshme, pezullimin, moskryerjen e një veprimi të caktuar, ose heqjen dorë nga ekzekutimi i titullit ekzekutiv.

3. Të kërkojë kthimin e shumave të parapaguara në llogarinë e shoqërisë përmbarimor /përmbaruesit gjyqësor privat në përputhje me nenin 38, paragrafin e parë të nenit 41, dhe nenin 43 të ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, të ndryshuar.

4. Të kërkojë lidhjen e marrëveshjes “tip” për aplikimin e tarifave të suksesit.

5. Të kërkojë kthimin e dokumentacionit në përputhje me nenin 38, paragrafin e parë të nenit 41 dhe nenin 43 të ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, të ndryshuar.

6. Të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit sipas nenit 45, të ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, të ndryshuar, në rast të kryerjes nga ana e përmbaruesit gjyqësor të veprimtarisë në kundërshtim me ligjin.

Neni 4

Detyrimet e kreditorit

Kreditori merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

1. Të paguajë tarifën fikse të shërbimit përbarimor gjyqësor privat në llogarinë e shoqërisë së përbarimit/përbaruesit gjyqësor privat, brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i kësaj kontrate.
2. Të paguajë tarifat dhe shpenzimet që janë parashikuar për kryerjen e veprimeve përbarimore për ekzekutimin e titujve ekzekutivë, brenda 5 ditëve nga dërgimi i kërkesës me shkrim të subjektit përbarues, të shoqëruar me dokumentet e pagesës së lëshuar nga të tretët apo procesverbalit që dokumenton shpenzimet.
3. Të japë të gjithë informacionin që ka për debitorin ose persona të tretë, për t'i ardhur në ndihmë përbaruesit gjyqësor privat në momentin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv.
4. Të paraqitet pranë përbaruesit gjyqësor privat dhe/ose të deklarojë me shkrim në adresë të shoqërisë përbarimore/përbaruesit gjyqësor privat kërkesën për mosvijimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv para se të ketë kaluar afati i ekzekutimit vullnetar të detyrimit, sipas nenit 517 të Kodit të Procedurës Civile, dhe në çdo rast, jo më vonë se 3 ditë nga momenti kur është njoftuar me vendimin për fillimin e menjëhershëm të ekzekutimit të detyrueshëm nga përbaruesi gjyqësor privat sipas nenit 519 të Kodit të Procedurës Civile.
5. Të paraqitet pranë organeve gjyqësore dhe institucioneve publike/private sa herë që kërkohet prezenca e tij nga shoqëria përbarimore/përbaruesi gjyqësor privat.
6. Të paraqitet në afatin e duhur ose të marrë përsipër kryerjen e një veprimi të caktuar, në rast se i kërkohet nga ana e shoqërisë përbarimore/përbaruesit gjyqësor privat.
7. Të nënshkruajnë procesverbalet që dokumentojnë veprimet përbarimore nga shoqëria përbarimore/përbaruesi gjyqësor privat të cilat pasqyrojnë realitetin dhe janë hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke pasur të drejtë të shënojnë në të edhe vërejtjet/kundërshtimet që ai ka.
8. Të mbajë marrëdhënie të mira dhe korrekte me shoqërinë përbarimore/përbaruesin gjyqësor privat.

Neni 5

Të drejtat e shoqërisë përbarimore/përbaruesit gjyqësor privat

Shoqëria përbarimore/përbaruesi gjyqësor privat ka të drejtë:

1. Të verifikojë të gjithë dokumentacionin e paraqitur nga kreditori ose përfaqësuesi i tij në momentin paraprak ose dhe gjatë ekzekutimit, kur ai ka dyshime për vërtetësinë e tij.
2. Të kërkojë parapagimin nga kreditori të tarifës fikse për shërbimin përbarimor, e përlllogaritur në këtë kontratë në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe të kërkojë pagimin e shpenzimeve përbarimore.
3. Të pranojë lidhjen e marrëveshjes “tip” për aplikimin e tarifave të suksesit, sipas kërkesës dhe me marrëveshje me kreditorin.
4. Të kërkojë nga kreditori dhënien e informacionit të nevojshëm për debitorin dhe për personin e tretë në proces ekzekutimi.
5. Të mos fillojë apo të ndërpresë menjëherë kryerjen e veprimeve përbarimore në çdo fazë të ekzekutimit, kur kreditori nuk respekton afatet e kryerjes së pagesave ose shpenzimeve të parashikuara sipas akteve ligjore në fuqi dhe të zgjidhë në mënyrë të njëanshme kontratën me kreditorin në rast se ai refuzon të paguajë tarifat fikse sipas afateve të parashikuara në këtë kontratë.
6. Të mbajë tarifën e shërbimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në rastin e ndërprerjes ose zgjidhjes së kontratës.

Neni 6

Detyrimet e shoqërisë përmbarimore/përmbaruesit gjyqësor privat

Shoqëria përmbarimore/përmbaruesi gjyqësor privat merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

1. Të kryejë në favor të kreditorit të gjitha veprimet e duhura ligjore për ekzekutimin e titullit ekzekutiv.
2. Të informojë kreditorin për të gjitha veprimet e kryera dhe, në rast se i kërkohet, të japë informacion me shkrim lidhur me statusin aktual të ekzekutimit të titullit ekzekutiv.
3. Të mos pranojë ose të ndërpresë kryerjen e veprimeve përmbarimore në çdo fazë të ekzekutimit, kur konstaton ekzistencën e konfliktit të interesit.
4. Të njoftojë kreditorin kur konstaton ekzistencën e konfliktit të interesit dhe deri në momentin e zgjidhjes së kontratës, të mos kryejë veprime që rëndojnë interesin e saj.
5. Të kthejë në masën e parashikuar nga ligji, në favor të kreditorit, shumat e parapaguara, në rast se shoqëria përmbarimore/përmbaruesi gjyqësor privat zgjidh në mënyrë të njëanshme kontratën e shërbimit, me përjashtim të rastit kur zgjidhja e kontratës është bërë për mospëmbushje të një detyrimi nga ana e kreditorit, në përputhje me nenin 38, paragrafin 2 të nenit 41, nenin 43 dhe nenin 49 të ligjit nr. 10 031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, të ndryshuar.
6. Të kthejë dokumentacionin e dosjes përmbarimore kreditorit, në rastin e zgjidhjes së kontratës nga shoqëria përmbarimore/përmbaruesi gjyqësor privat.
7. Të kthejë dokumentacionin e dosjes përmbarimore kreditorit edhe në rastin e zgjidhjes së kontratës për mospëmbushje të një detyrimi ligjor/kontraktual, nga ana e kreditorit, me kushtin që ky i fundit të përmbushë detyrimin për pagimin e çdo shpenzimi përmbarimor të kryer deri në atë çast.
8. Të mos publikojë të dhëna personale të kreditorit pa pëlqimin paraprak të tij, si dhe të ruajë konfidencialitetin e informacionit të siguruar gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 36, i ligjit nr. 10 031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, të ndryshuar.
9. Të pasqyrojë me korrektësi realitetin në hartimin e procesverbaleve dokumentuese të veprimeve përmbarimore në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke pasqyruar në të edhe vërejtjet/kundërshtimet eventuale të të pranishmëve.
10. Të ruajë sipas afateve ligjore dosjen përmbarimore, të krijuar që nga momenti i nënshkrimit të kontratës deri në përfundim të ekzekutimit.
11. Të mbajë marrëdhënie të mira dhe korrekte me kreditorin, si dhe të respektojë Kodin e Etikës në marrëdhënie me të tretët gjatë ushtrimit të detyrës.
12. Të mbajë përgjegjësi sipas nenit 45 të ligjit 10 031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, të ndryshuar, në rast të ushtrimit të veprimtarisë së tij në kundërshtim me ligjin ndaj palëve në proces ekzekutimi dhe të tretëve.
13. Të kryejë me përpikëri detyrat ligjore dhe të shmangë praktikatat e ndaluara sipas parashikimeve të neneve 32 dhe 33, të ligjit 10 031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, të ndryshuar.

Neni 7

Kryerja e pagesave të shërbimit

1. Tarifa fikse dhe shpenzimet përmbarimore do të paguhet nëpërmjet derdhjes së tyre në llogarinë bankare të shoqërisë përmbarimore/përmbaruesit gjyqësor privat që është pranë “(bankës)_____”, në numri e llogarisë_____dhe me numër IBAN.
2. Vlera e tarifës fikse të shërbimit për fillimin e procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm dhe kryerja e të gjitha veprimeve procedurale sipas Kodit të Procedurës Civile është në masën (_____) lekë dhe do të paguhet nga kreditori në momentin e nënshkrimit të kontratës së shërbimit, përveç rastit kur kreditori është i përjashtuar me akt ligjor apo nënligjor nga pagimi i tarifës fikse. Në këtë rast, kreditori është/nuk është i përjashtuar me akt ligjor apo nënligjor nga

pagimi i tarifës (të zgjidhet njëra nga opsionet sipas rastit konkret).

3. Nëse është rënë dakord për pagimin e tarifës së suksesit nga kreditori, vlera e saj do të paguhet nga kreditori në shumën dhe mënyrën e parashikuar në aneksmarrëveshjen bashkëngjitur kësaj kontrate (në lekë plus TVSH).

4. Vlera e shpenzimeve përbarimore të kryera sipas rastit do të paguhet nga pala që i ka shkaktuar ato në momentin kur të lindin (në lekë plus TVSH).

5. Kreditori do të vërtetojë kryerjen e pagesës, tarifave apo shpenzimeve përbarimore nëpërmjet paraqitjes së mandatpagesës pranë shoqërisë përbarimore/përbaruesi gjyqësor privat.

Neni 8

Moskryerja e pagesave të shërbimit dhe/ose shpenzimeve

1. Në rast se kreditori nuk kryen pagesën për tarifën e shërbimit, shoqëria përbarimore/përbaruesi gjyqësor privat zgjidh në mënyrë të njëanshme kontratën.

2. Në rast se kreditori nuk kryen pagesën e shpenzimeve përbarimore dhe nuk i paraqet mandatpagesën shoqërisë përbarimore/përbaruesit gjyqësor privat, ajo ndërpret ekzekutimin dhe njofton kreditorin për përmbushjen e këtij detyrimi, duke i përcaktuar edhe afatin e fundit për kryerjen e saj. Në rast se edhe pas kalimit të këtij afati kreditori nuk i paguan shpenzimet, atëherë përbaruesi gjyqësor zgjidh në mënyrë të njëanshme kontratën, në përputhje me nenet 698 dhe 700 të Kodit Civil.

3. Ky detyrim nuk mund t'u kundrejtohet kreditorëve të përjashtuar nga parapagimi i tarifave përbarimore sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në rastin konkret, ky rregull **vepron/nuk vepron** (të zgjidhet njëra nga opsionet sipas rastit konkret).

Neni 9

Veprimet në rastin e konfliktit të interesit

1. Në rast se zbulohet një situatë që përbën konflikt interesi, sipas nenit 9 të ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008, "Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat", të ndryshuar, shoqëria përbarimore /përbaruesi gjyqësor privat njofton me shkrim kreditorin brenda dy ditësh nga zbulimi i saj dhe merr masa për zgjidhjen e situatës së konfliktit të interesit.

2. Në rast se situata e konfliktit të interesit është e pashmangshme, shoqëria përbarimore /përbaruesi gjyqësor privat heq dorë nga vazhdimi i veprimeve procedurale dhe njofton 15 ditë përpara kreditorin. Gjatë kësaj periudhe, përbaruesi gjyqësor privat është i detyruar që të kryejë veprimet procedurale eventuale. Pas kalimit të afatit të sipërpërmendur, përbaruesi gjyqësor privat i kthen kreditorit dosjen e plotë përbarimore, si dhe, kur është rasti, tarifën e parapaguar për procedurën e ekzekutimit.

Neni 10

Përgjegjësia profesionale

1. Përbaruesi gjyqësor privat mban përgjegjësi për dëmin që u shkakton palëve në proces ekzekutimi, si dhe për dëmin ndaj të tretëve, kur e zhvillon veprimtarinë e tij në kundërshtim me ligjin.

2. Shoqëria përbarimore/përbaruesi gjyqësor privat mban përgjegjësi sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithësi për profesionin, për dëmin që mund t'i shkaktojë kreditorit si pasojë e veprimtarisë së saj/tij gjatë procesit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv.

3. Me qëllim përmbushjen e detyrimit të mësipërm, shoqëria përbarimore/përbaruesi gjyqësor privat ka siguruar veprimtarinë e saj/tij profesionale në përputhje me paragrafin "e)" të nenit 32, të ligjit nr. 10 031, datë 11.12.2008, "Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat", të ndryshuar, në shoqërinë e sigurimeve, nëpërmjet kontratës së sigurimit .

4. Në rast se vërtetohet me vendim gjyqësor të formës së prerë, se shoqëria

përmbarimore/përmbaruesi gjyqësor privat ka përgjegjësi profesionale, atëherë zhdëmtimi i kreditorit bëhet nëpërmjet shoqërisë së sigurimit.

5. Kur me vendimin gjyqësor të formës së prerë është vendosur se dëmi që i është shkaktuar kreditorit nga veprimtaria profesionale del jashtë kushteve të parashikuara në kontratën me shoqërinë e sigurimit, apo kur kjo e fundit nuk përmbush detyrimin brenda afateve të përcaktuara me ligj, ky detyrim përmbushet nga shoqëria përmbarimore/përmbaruesi gjyqësor privat.

Neni 11

Pezullimi i kontratës në rast veprimi të forcës madhore

1. Shoqëria përmbarimore/përmbaruesi gjyqësor privat nuk mban përgjegjësi për humbjet, dëmet e pësuar, moskryerjen e ekzekutimit apo ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të saj/tij sipas kontratës, për arsye të forcës madhore apo rastit faktor.

2. Gjatë periudhës së forcës madhore apo rastit faktor, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo kontratë pezullohen.

3. Nëse përmbushja e detyrimeve kontraktuale vonohet për shkak të forcës madhore apo rastit faktor për më shumë se 6 muaj, palët kontraktuese me marrëveshje me shkrim mund të vendosin:

a) kushte të reja për përmbushjen e kësaj kontrate; ose b) zgjidhjen me pëlqim të dyanshëm të kontratës.

Neni 12

Rastet e zgjidhjes së kontratës

1. Kontrata quhet e zgjidhur kur:

a) vërtetohet shfuqizimi i titullit ekzekutiv;

b) përmbaruesi gjyqësor privat e ka të pamundur të kryejë detyrën për arsye shëndetësore për një periudhë më shumë se 90 ditë pa ndërprerje;

c) përmbaruesi gjyqësor privat, për arsye studimore, e ka të pamundur të kryejë detyrën e tij për një periudhë mungese më shumë se 90 ditë pa ndërprerje;

ç) përmbaruesit gjyqësor privat i hiqet ose pezullohet certifikata e ushtrimit të profesionit me urdhër të ministrit të Drejtësisë;

d) palët kontraktuese me vullnet të lirë deklarojnë zgjidhjen e kësaj kontrate;

dh) për mospërmbushje të detyrimeve, me njoftim të palës.

2. Në rastin e zgjidhjes së kontratës sipas pikës 1, germet “b)”, “c)”, “ç)”, “d)” dhe “dh)” të këtij neni, shoqëria përmbarimore/përmbaruesi gjyqësor privat i kthen kreditorit dokumentacionin ligjor të administruar prej tij si pjesë të dosjes përmbarimore për fillimin e procesit bashkë me pagesat e shërbimit, duke zbritur shpenzimet e kryera deri në atë çast dhe/ose transferon dosjen përmbarimore me kërkesën e kreditorit në një subjekt tjetër përmbarues.

Neni 13

Zgjidhja e kontratës për shkak të falimentimit

1. Në rast të falimentimit të shoqërisë përmbarimore/përmbaruesit gjyqësor privat, ky është i detyruar që të njoftojë me shkrim palën kreditore për zgjidhjen e kontratës dhe e fton atë të tërheqë dosjen e plotë përmbarimore, duke e transferuar në një subjekt tjetër përmbarues.

2. Në rastin e zgjidhjes së kontratës për shkak të falimentimit, kreditori ka të drejtën të kërkojë edhe transferimin e pagesave të shërbimit te subjekti i ri përmbarues, me përjashtim të shpenzimeve të kryera deri në atë çast sipas legjislacionit në fuqi për procedurat e falimentimit.

Neni 14

Mosparaqitja e palës kreditore

Në rast se pala kreditore nuk paraqitet pranë shoqërisë përmbarimore/përmbaruesit gjyqësor privat pas kalimit të afati 10-ditor, për të kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm ose nuk paraqitet kur është thirrur me shkrim, atëherë shoqëria përmbarimore/përmbaruesi gjyqësor privat ka të

drejtë të pezullojë ekzekutimin.

Neni 15

Njoftimi midis palëve

1. Çdo njoftim i bërë mes palëve sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e mëposhtme:

a) Kreditori

Adresa: Adresë: mail/tel./fax:

Përfaqësuar z.

b) Shoqëria përmbarimore/përmbaruesi gjyqësor privat

Adresa: Adresë: mail/tel./fax:

Përfaqësuar z.

2. Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 16

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë realizimit të kësaj kontrate, palët janë të detyruara t'i zgjidhin ato me mirëkuptim.

2. Nëse nuk arrihet zgjidhja me mirëkuptim dhe marrëveshje mes palëve, ato mund t'i drejtohen gjykatës së rrethit gjyqësor ku shoqëria përmbarimore/përmbaruesi gjyqësor privat ka selinë.

Neni 17

Marrëveshja e “tarifës së suksesit”

Palët lidhin marrëveshjen “tip” për aplikimin e tarifave të suksesit në përputhje me legjislacionin në fuqi, sipas aneksit bashkëngjitur kësaj kontrate, dhe pjesë përbërëse e saj.

Neni 18

Dokumentacioni bashkëlidhur kontratës

Kësaj kontrate si pjesë përbërëse e saj i bashkëlidhen edhe dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesa e palës që kërkon vënien në ekzekutim;
2. Titulli ekzekutiv nr. , datë . . (origjinal ose i noterizuar);
3. Urdhri i ekzekutimit nr. , datë . . (origjinal). *(Shënim: kur nuk lëshohet urdhër ekzekutimi nga gjykata, nuk citohet ky dokument në përmbajtjen e kontratës);*
4. Mandatpagesën e tarifës fikse;
5. Sipas rastit, prokurën e personit që përfaqëson kreditorin.

Neni 19

Parashikime të fundit

1. Kontrata hartohet në 3 (tre) kopje me të njëjtën vlerë ligjore, ku njëra përfshihet në dosjen përmbarimore, njëra mbahet në arkivën e shoqërisë përmbarimore/përmbaruesit gjyqësor privat dhe tjetra mbahet nga kreditori. Kopjes origjinale të kontratës që mban kreditori, i bashkëlidhet fotokopja e akteve të parashikuara në nenin 18 të kësaj kontrate.

2. Kontrata nënshkruhet në çdo fletë nga të dyja palët kontraktore.

Neni 20

Efektet, hyrja në fuqi dhe përfundimi

1. Kjo kontratë është e vlefshme për sa është parashikuar në të, deri në ekzekutimin e plotë të titullit ekzekutiv dhe/ose pushimit të procesit përmbartimor të filluar në zbatim të saj.

2. Pasoja e ardhura si rezultat i zbatimit të kësaj kontrate, si dhe ato pasoja që rrjedhin nga zbatimi i ligjit kanë efekt deri në ekzekutimin e plotë të titullit ekzekutiv, si për palët nënshkruese dhe që kanë interes për sa i përket titullit ekzekutiv objekt ekzekutimi, ashtu dhe për subjekte të tjera përmbartuese sipas vullnetit të shprehur prej tyre apo nga ligji, kur është rasti i transferimit të dosjes përmbartimore.

3. Kjo kontratë hyn në fuqi menjëherë me nënshkrimin nga palët kontraktuale.

4. Kontrata konsiderohet e përfunduar kur titulli ekzekutiv është ekzekutuar tërësisht dhe/ose procesi i ekzekutimit është pushuar për një nga shkaqet e parashikuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

Kjo kontratë, pasi u lexua me zë të lartë dhe kuptua, u nënshkrua rregullisht, nga palët si më poshtë:

KREDITORI

(emër, mbiemër, firmë)

SHOQËRIA PËRMBARTIMORE/PËRMBARTUESI GJYQËSOR PRIVAT

(vula)

(emër, mbiemër, firmë)

Vendi dhe data e nënshkrimit: . . .

ANEKSI NR. 2

FORMAT “TIP” I MARRËVESHJES PËR APLIKIMIN E TARIFËS SË SUKSESIT, QË LIDHET MIDIS KREDITORIT DHE SHOQËRISË PËRMBARTIMORE/ PËRMBARTUESIT GJYQËSOR PRIVAT

ANEKS

MARRËVESHJE PËR APLIKIMIN E TARIFAVE TË SUKSESIT MBI VLERËN E DETYRIMIT TË EKZEKUTUAR NGA PËRMBARTUESI GJYQËSOR PRIVAT

Sot, më datë __. __. __, në zyrën e shoqërisë përmbartimore/përmbartuesit gjyqësor privat (emri i shoqërisë përmbartimore/përmbartuesit gjyqësor privat), pasi kreditori paraqiti kërkesën për vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv: __ (sipas nenit 510 të K. Pr. Civile, ku përsëriten të gjitha elementet e titullit ekzekutiv, duke përfshirë llojin e aktit, numrin dhe datën), si dhe kërkesën për aplikimin e tarifës së suksesit, lidhet kjo marrëveshje midis:

A. Kreditorit (subjekt fizik): emri, atësia, mbiemri, adresa dhe numri i pasaportës/letërnjoftimit, adresë elektronike, nr. llogarie bankare, nr. tel./fax./mob. ose **(person juridik):** emri, NIPT-i, adresa elektronike, nr. i llogarisë bankare; selia si dhe emri, atësia, mbiemri dhe numri i pasaportës/letërnjoftimit të përfaqësuesit të tij.

dhe

B. Shoqërisë përmbartimore/përmbartuesit gjyqësor privat (emri i shoqërisë përmbartimore/përmbartuesit gjyqësor privat) me certifikatë nr. __, datë __. __. __, me NIPT dhe adresë ____; adresë elektronike, nr. llogarie bankare, nr. tel./fax./mob.

BAZA LIGJORE: Lidhja dhe zbatimi i kësaj marrëveshjeje bazohet në dispozitat e Kodit Civil, në ligjin nr. 10031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”, të ndryshuar, udhëzimit të përbashkët nr. 385/6, datë 26.6.2017, të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave, “Për përcaktimin e nivelit minimal dhe maksimal të zbatimit të vlerës së tarifës së suksesit për veprimet përmbartimore të ofruara nga shërbimi përmbartimor gjyqësor privat”, si dhe në legjislacionin në fuqi në momentin e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.

Objekti i kontratës

Me vullnet të lirë, sipas kërkesës së kreditorit, palët janë dakord që në referim të kontratës së shërbimit të nënshkruar rregullisht ndërmjet palëve të sipërpërmendura në datë ____, për ekzekutimin e titullit ekzekutiv “_”, të caktojnë tarifën e suksesit, të cilat do të paguheshin sipas parashikimeve të treguara në nenin 2 të kësaj marrëveshjeje.

Opsioni 1

Neni 2

Tarifë suksesi sipas shumës së ekzekutuar

1. Titulli ekzekutiv përmban një detyrim monetar në total në vlerën ____.
2. Kreditori merr përsipër të paguajë tarifën e suksesit në llogarinë e shoqërisë përmbarimore /përmbaruesit gjyqësor privat në masën si më poshtë:
 - a) _ % ose lekë, kur titulli ekzekutiv në vlerën ekzekutohet tërësisht dhe arkëtohet në llogarinë e kreditorit brenda afateve ligjore të treguara në Kodin e Procedurës Civile, por jo më shumë se **365 ditë** të pandërprera nga kërkesat e kreditorit për pezullimin ose moskryerjen e një veprimi të caktuar për ekzekutimin e titullit ekzekutiv.
 - b) _ % ose lekë, kur titulli ekzekutiv në vlerën ____ ekzekutohet tërësisht dhe arkëtohet në llogarinë e kreditorit brenda afateve ligjore të treguara në Kodin e Procedurës Civile, por jo më shumë se **180 ditë** të pandërprera nga kërkesat e kreditorit për pezullimin ose moskryerjen e një veprimi të caktuar për ekzekutimin e titullit ekzekutiv.
 - c) _ % ose _ lekë, kur titulli ekzekutiv në vlerën __, ekzekutohet tërësisht dhe arkëtohet në llogarinë e kreditorit brenda afateve ligjore të treguara në Kodin e Procedurës Civile, por jo më shumë se **120 ditë** të pandërprera nga kërkesat e kreditorit për pezullimin ose moskryerjen e një veprimi të caktuar për ekzekutimin e titullit ekzekutiv;
 - d) % ose __ lekë, kur titulli ekzekutiv në vlerën _ ekzekutohet tërësisht dhe arkëtohet në llogarinë e kreditorit brenda afateve ligjore të treguara në Kodin e Procedurës Civile, por jo më shumë se **90 ditë** të pandërprera nga kërkesat e kreditorit për pezullimin ose moskryerjen e një veprimi të caktuar për ekzekutimin e titullit ekzekutiv.
 - e) % ose __ lekë, kur titulli ekzekutiv në vlerën __ ekzekutohet tërësisht dhe arkëtohet në llogarinë e kreditorit brenda afateve ligjore të treguara në Kodin e Procedurës Civile, por jo më shumë se **60 ditë** të pandërprera nga kërkesat e kreditorit për pezullimin, moskryerjen e një veprimi të caktuar për ekzekutimin e titullit ekzekutiv.
3. Masa e tarifës së suksesit sipas këtij neni do të përfitohet proporcionalisht sipas nivelit të detyrimit të ekzekutuar dhe arkëtuar në llogarinë e kreditorit nga ana e përmbaruesit gjyqësor privat, sipas përcaktimeve të njëjta kohore dhe vlerës së ekzekutuar të shumës së titullit ekzekutiv.
4. Vlera e tarifës së suksesit, e cila do të paguhet bazuar në sekuestrimin dhe ekzekutimin mbi pasuritë e tjera të debitorit, të ndryshme nga pasuritë e hipotekuara dhe/ose barrët siguroese të vendosura si mjete për të siguruar ekzekutimin e detyrimit, kur sendi kalon në pronësi të kreditorit, duke mbuluar plotësisht detyrimin, do të jetë sa vlera e barazuar e detyrimit të ekzekutuar tërësisht sipas vlerave dhe masës së tarifave të treguara në pikën 2 të këtij neni, konkretisht vlera.
5. Vlera e tarifës së suksesit, e cila do të paguhet bazuar në sekuestrimin dhe ekzekutimin mbi pasuritë e hipotekuara dhe/ose barrët siguroese të debitorit apo dorëzanësve të tij, të vendosura si mjete për të siguruar ekzekutimin e detyrimit, kur sendi kalon në pronësi të kreditorit, duke mbuluar plotësisht detyrimin, do të jetë sa vlera e barazuar 50% të detyrimit të ekzekutuar tërësisht sipas vlerave dhe masës së tarifave të treguara në pikën 2 të këtij neni, konkretisht vlera ____.

Opsioni 2

Neni 2

Tarifë suksesi sipas veprimeve përmbarimore të kryera

Titulli ekzekutiv përmban një detyrim jomonetar dhe të pavlerësueshëm, dhe kreditori merr përsipër të paguajë vlerën e tarifës së suksesit të shërbimit përmbarimor në varësi të objektit të ekzekutimit, si më poshtë:

a) _____ lekë për lirimin dhe vënien në posedim të një sendi të paluajtshëm, kur sendi i paluajtshëm ndodhet në vendin/qarkun/bashkinë ku kryen aktivitetin përmbaruesi gjyqësor privat.

b) __ lekë për lirimin dhe vënien në posedim të një sendi të paluajtshëm, i cili ndodhet në një vend/qark/njësi administrative të ndryshme nga ajo ku kryen aktivitetin përmbaruesi gjyqësor privat.

c) _____lekë për lirimin dhe vënien në posedim të një sendi të paluajtshëm, i cili shërben si ambient banimi për debitorin apo palët e lidhura me të dhe është funksional (me banorë) në momentin e kryerjes së ekzekutimit të detyrueshëm.

d) __ lekë për lirimin dhe vënien në posedim të një sendi të paluajtshëm, i cili shërben si ambient biznesi, ambient rekreativ apo lokal, i cili është funksional në momentin e kryerjes së ekzekutimit të detyrueshëm.

e) __ lekë për lirimin dhe vënien në posedim të një sendi të paluajtshëm, i cili shërben si ambient banimi për debitorin apo palët e lidhura me të dhe është bosh në momentin e kryerjes së ekzekutimit të detyrueshëm.

f) _lekë për lirimin dhe vënien në posedim të një sendi të paluajtshëm, i cili shërben si ambient biznesi, ambient rekreativ apo lokal, i cili është bosh në momentin e kryerjes së ekzekutimit të detyrueshëm.

g) __ lekë për lirimin dhe vënien në posedim të një sendi të paluajtshëm, i cili është një fabrikë, magazinë, punishte ose ambient biznesi, ku gjenden linja prodhimi funksionale, të cilat së bashku me sendin e paluajtshëm, objekt ekzekutimi, kanë një vlerë të treguar në dokumentacionin e regjistruar, mbi 90 000 000 lekë.

h) __ lekë për lirimin dhe vënien në posedim të një sendi të paluajtshëm, i cili është një truall, tokë bujqësore, arë me objekte dhe/ose sende të paluajtshme që nevojitet të shemben, prishen dhe/ose pastrohen nga objekti i ekzekutimit të detyruar nga përmbaruesi gjyqësor privat.

i) _lekë për lirimin dhe vënien në posedim të një sendi të paluajtshëm, i cili është një truall, tokë bujqësore, arë bosh.

j) __ lekë për të gjitha rastet e treguara në pikat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i”, kur koha e kryerjes së veprimit përmbarimor për lirimin dhe vënien në posedim të sendit të paluajtshëm kalon një sasi kohe prej 72 orësh punë jashtë orarit zyrtar dhe/ose përsëritjes së veprimit përmbarimor për lirimin dhe vënien në posedim të sendit të paluajtshëm më shumë se 1 herë për të njëjtin objekt.

Opsioni 3

Neni 2

Tarifa alternative e suksesit

1. Aplikimi i tarifës së kombinuar të suksesit mbi vlerën e detyrimit __, e cila do të ekzekutohet nga përmbaruesi gjyqësor privat në formë të kombinuar, e treguar si metodë e ekzekutimit të detyruar sipas kësaj marrëveshjeje, do të përmbledhë një shumë përfitimi, e cila nuk do t'i kalojë lekë dhe/ose __ lekë. Përmbaruesi dokumenton në procesverbal që i bashkëlidhet kësaj marrëveshjeje se kjo shumë nuk tejkalon shumën që do të rezultonte në secilën nga metodat e tjera të tarifimit.

2. Vlera e ekzekutimit të detyruar nga përmbaruesi gjyqësor privat, sipas metodës alternative të suksesit, referuar kësaj marrëveshjeje, do të tregohet dhe administrohet në një dokument të detajuar, që do të shërbejë si informacion dhe provë e suksesit të arritur nga përmbaruesi gjyqësor privat në ekzekutimin e titullit ekzekutiv sipas metodës alternative të suksesit.

Neni 3

Pagimi dhe llogaritja e tarifës së suksesit

1. Pala kreditore ka detyrimin që të informojë brenda 10 ditësh nga momenti i realizimit të arkëtimit të detyrimit monetar të mbledhur për interes të saj, përmbaruesin gjyqësor privat për shumat e ekzekutuara në llogari të saj. Tarifa e suksesit paguhet nëpërmjet derdhjes në llogarinë bankare të shoqërisë përmbarimore/përmbaruesit gjyqësor privat që është pranë “(bankës)”, në numrin e llogarisë IBAN_ dhe me numër

2. Pagesa sipas faturimit të tarifës së suksesit do të bëhet në llogarinë e shoqërisë përmbarimore/përmbaruesit gjyqësor privat jo më vonë se 5 ditë nga momenti i lëshimit të faturës dhe dërgimit të njoftimit të përmbaruesit gjyqësor privat për tarifën e aplikuar mbi shumat e ekzekutuara.

3. Të gjitha tarifat e suksesit ngarkohen me TVSH, e cila llogaritet në momentin e faturimit dhe pagesës vetëm për atë pjesë të tarifës së suksesit, e cila faturohet dhe duhet të arkëtohet nga përmbaruesi gjyqësor privat, bazuar në kushtet dhe afatet e përcaktuara në këtë marrëveshje.

Kjo marrëveshje nënshkruhet rregullisht nga palët dhe bazuar në nenin 48 të ligjit nr. 10 031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, të ndryshuar, bëhet pjesë integrale e kontratës së shërbimit përmbarimor datë __/__/__.

Kjo marrëveshje, pasi u lexua me zë të lartë dhe u kuptua, u nënshkrua rregullisht nga palët, si më poshtë:

KREDITORI

(emër, mbiemër, firmë)

SHOQËRIA PËRMBARIMORE/PËRMBARUESI GJYQËSOR PRIVAT

(vula)
(emër, mbiemër, firmë)

Vendi dhe data e nënshkrimit: ,

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Qendra e Botimeve Zyrtare

Përmbledhje për përmbarimin/ **Qendra e Botimeve
Zyrtare. - Tiranë : QBZ, 2018**

... f. ; ... cm.

ISBN 978-9928-01-095-7

1. Të drejtat civile	2. Përmbarues dhe administratorë
3. Ligje	4. Shqipëri

347.964.3(496.5) (094.4)